

Botuar në italisht me titullin “L'avventura editoriale della letteratura albanese in Italia: il caso di Ismail Kadare” në periodikun: Marija Bradaš, Tiziana D'Amico, Cristiano Diddi (eds), *Diacritici in copertina. Le letterature dell'Europa centro- e sud-orientale tra strategie editoriali e traduzione*, Collana della Rivista “Europa Orientalis”, Dipartimento DIPSUM - Università di Salerno, Salerno, 2022, f. 225-235. Përkthimi i prof. Gëzim Gurga.

Aventura editoriale e letërsisë shqipe në Itali: RASTI I KADARESË

Nga Matteo Mandalà

Poezia e Asdrenit Mërzi Vjeshte

**HISTORIA E NJË
POEZIE QË U DËNUA
ME VDEKJE**

Nga Rudolf Marku

(fq. 10)

SHËNIME MBI LIBRAT

Rreth librit “Paradigma e Parajsës”

**THJESHTËSIA DHE
MADHËSHTIA E FIGURACIONIT
TË NDJENJAVE NË POEZINË E
GJEKË MARINAJT**

Nga Shpendi Topollaj

(fq. 7)

“Koha në mes” e Raimonda Belli - Gjençajt

**NJË ROMAN - SAGË QË
RIKTHEN REALIZMIN**

Nga Prof. Dr. Klara Kodra

(fq. 8)

Romani “Goja e Botës” nga Zija Çela

**LIBRAT E MËDHENJ
SHPËRFillin TREGUN E DITËS**

Nga Mehmet Elezi

(fq. 9)

**Ese. Parathënie e Antologjisë me poezi dashurie
PËR NJË PUTHJE U SHEMB TROJA**

Nga Mark Simoni

(fq. 12)

Anton Nikë Berisha, *Dy kryevepra lirike të Fishtës*

**LIRIKA E FISHTËS NË DRITËN E
DY STUDIMEVE TË VEÇANTA**

Nga Ajete Zogaj

(fq. 13)



Skicë nga Bujar Kapllani

(fq. 5)

Kur lexoj skicat, etydet poetike të Alda Taçes
alias Esmeralda Shpata

**ZBULIMI I VETES SI FAVOR
APO SI ANDRALLË?**

Nga Fatbardh Amursi (Rustemi)

(fq. 14)

**MAGUI VERIUT –
ARTI I SIGURJÓ BIRGIR
SIGURÔSSON (SJÓN)**

Nga A. S. Byatt

(fq. 22)

Herë pas here një shkrimtar ma ndryshon gjithë hartën e letërsisë që unë mbaj në kokë. Më i fundit ka qenë islandezi Sjón, vepra e të cilit është tërësisht e ndryshme nga çdo letërsi tjetër që kisha lexuar dhe ndërkohë, mjaft emocionuese.



Sapo ka dalë në Kinë poezia e shkrimtarit tonë Visar Zhiti, një përmbledhje e gjerë, e titulluar “Duke mbledhur dritë”, botim i shtëpisë botuese kineze

“RRUGA E MËNDAFSHIT” PËR POEZINË...

Visar Zhiti në bisedë
me Andreas Dushin

BIBLIOTEKË

— Arben Dedja

(fq. 18)

Italian Job

— Michael Palmer

(fq. 20)

Premtimet e Qelqit

(Përktheu nga anglishtja Gëzim Basha)

— Esmeralda Shpata

(fq. 15)

Kuartet tregimesh

— Xhevair Lleshi

(fq. 16)

Çorobojka

— Giovanni Pascoli

(fq. 11)

Natë

— Antonio Çikollari

(fq. 11)

Bufi dhe heroit

— Shpresa Qeriqi

(fq. 19)

Gogol

— Bajram Sefaj

(fq. 18)

Kolonët e mi

— Rei Hodo

(fq. 17)

Rregulli i jetës kur ti nuk je

1. Ky studim është zgjerimi i kumtesës sime në konferencën kushtuar letërsive minore në kontekstin editorial dhe kulturor italian në të cilën më është propozuar të flisja për letërsinë shqipe dhe receptimin e saj në gjuhë të tjera, veçanërisht në italisht, si edhe t'i kushtoja vëmendje rastit të Kadaresë, shkrimtarit më të madh të sotëm shqiptar, vepra e të cilit është përkthyer në më se 40 gjuhë, më saktë, sipas të dhënave të Bashkim Kuçukut, në plot 45 gjuhë¹. Kjo shifër shënon një rekord në letërsinë shqipe dhe na jep një çelës leximi për të kuptuar arsyet e përmasave ndërkombëtare të suksesit të kësaj dukurie letrare, sukses që konfirmohet nga lajmi i përhapur këto ditë në Shqipëri nga Ambasada e SHBA-së se Kadaresë iu akordua çmimi prestigjioz *Neustadt për letërsinë*, promovuar nga revista *World Literature Today* dhe organizuar nga Universiteti i Oklahomës². Prej shumë vitesh tashmë emri i shkrimtarit shqiptar përfshihet rregullisht në listën e kandidatëve për çmimin Nobel për Letërsinë, çka dëshmon se qarkullimi i veprave të tij ka qenë vërtet i gjerë dhe kapilar. Në këto faqe do të rrekemi të rindërtojmë rrugën e narrativës kadareane nga fillimi i viteve '70 të shekullit të shkuar deri në ditët tona, duke e përqendruar vëmendjen mbi disa çështje ende të hapura që e vështirësojnë kalimin, a më mirë të themi kalimet, nga një gjuhë në tjetrën, aspekt ky që për shkak të një paradoksi të historisë përbën një nga karakteristikat kryesore të letërsisë botërore, por edhe një problem, nga njëra anë, për studiuesit dhe kritikët, nga ana tjetër për vetë përkthyesit. Nuk është e thjeshtë të rindërtohet në pak rreshta një histori kaq komplekse, por le të fillojmë duke e përshkuar rrugën në kah të kundërt.

2. Në fakt letërsia shqipe, përveçse pak e njohur në botë, është pa dyshim edhe një letërsi e re. Dokumenti i parë i shkruar, *Formula e pagëzimit*, i përket fundit të shekullit XV; libri i parë i shtypur, *Meshari* i Gjon Buzuku, datohet konvencionalisht në vitin 1555, ndërsa libri i dytë, *Embsuame e krështerë* i arbëreshit Lekë Matranga u botua në vitin 1592. Këto tri dokumente bartin të njëjtat tipare strukturore që do të shoqërojnë për një kohë të gjatë historinë e qytetërimit letrar shqiptar. Së pari, ato përfaqësojnë tri areale dialektore të gjuhës shqipe: përkatësisht, gegërishten qendrore, gegërishten veriore dhe toskërishten në variantin arbëresh; së dyti, kemi të bëjmë me tekste të gjetura ose të shtypura në Itali, pra jashtë trojeve “natyrore” shqipfolëse ballkanike; së fundi dhe çka është më kryesorja, janë të gjitha përkthime shqip nga tekste origjinale latinisht ose italisht.

1 Shih Bashkim Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botës: në dyzet e pesë gjuhë*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë 2015.

2 Shih Ani Kokobobo, “Ismail Kadare and the Worldliness of Albanian Literature” në *World Literature Today* (Winter 2021), në faqen internet <https://www.worldliteraturetoday.org/2021/winter/ismail-kadare-and-worldliness-albanian-literature-ani-kokobobo>.



Botuar në italisht me titullin “L'avventura editoriale della letteratura albanese in Italia: il caso di Ismail Kadare” në periodikun: Marija Bradaš, Tiziana D'Amico, Cristiano Diddi (edts), *Diacritici in copertina. Le letterature dell'Europa centro- e sud-orientale tra strategie editoriali e traduzione*, Collana della Rivista “Europa Orientalis”, Dipartimento DIPSUM - Università di Salerno, Salerno, 2022, f. 225-235. Përkthimi i prof. Gëzim Gurga.

Aventura editoriale e letërsisë shqipe në Itali: RASTI I KADARESË

Nga Matteo Mandalà,

Mirëpo nëse këto tri tekste të para përfshijnë tiparet kryesore diakronike të letërsisë shqipe dhe që hasen rregullisht në veprat e mëvonshme, s'ka dyshim se ndër të përkthimi është karakteristika më e rëndësishme e praktikës së shkrimit që ka shoqëruar kulturën shqiptare ndër shekuj.



Në traditën letrare arbëreshe përkthimi ka qenë një praktikë e ushtruar rregullisht nga vetë autorët e veprave, të cilët ishin të gjithë folës të lindur dygjuhësh dhe e konsideronin përkthimin një mjet të domosdoshëm për t'u siguruar një përhapje të përshtatshme veprave të tyre. Me këtë dukuri të veçantë “vetëpërkthimi” është marrë Francesco Altimari, i cili, duke iu referuar veprave letrare arbërisht të Jeronim De Radës, ka analizuar «zgjedhjen strategjike për t'i vënë arbërishtes përkrah edhe italishten, çka rezultoi e suksesshme jo vetëm për De Radën, vepra e të cilit krijoi një traditë gjuhësore dhe letrare që tërhoqi vëmendjen dhe admirimin e publikut edhe jashtë Italisë [...] falë ndërmjetësimit gjuhësor dhe kulturor të vetëpërkthimit italisht të veprës»³. Analizat empirike mbi tekstet kanë vërtetuar hamendjen teorike të Altimarit, duke na lejuar të vijmë në disa përfundime të rëndësishme. Së pari, konstatojmë se bëhet fjalë për konvergencë dhe divergencë mes dy versioneve, arbërisht dhe italisht, çka tregon se dygjuhësia letrare shfaqet në kërkimin nga ana e autorit të një identiteti tekstor «të dyanshëm dhe të njësishtëm». De Rada, sikurse një pjesë e mirë e ithtarëve të tij, përfshirë bashkëkohësit tanë, duke modifikuar vazhdimisht herë versionin “original” arbërisht, herë atë “të përkthyer” italisht, në të vërtetë synonte të arrinte një «identitet tekstor (dhe kontekstor) të njësishtëm, formalisht të dyfishtë e të dallueshëm, por semantikisht qarkor»⁴. Me fjalë të tjera, autori dygjuhësh arbëresh nuk sillej (dhe nuk sillet) aspak si një përkthyes “normal”, por merrte (dhe merr) në të dyja rastet rolin e “krijuesit” të dy versioneve të cilat nga ana formale mbeten “të dallueshme” dhe “të njësishtëm”, ndërsa nga ana semantike kontribuojnë në krijimin e një teksti të vetëm, që shkon përtej dallimeve gjuhësore dhe që mëton të kënaqë pritshmëri estetiko-letrare të ngjashme dhe ekuivalente. Kjo sjellje ngjan

3 Francesco Altimari, “L'autotraduzione nelle opere letterarie italo-albanesi: il caso di Girolamo De Rada”, në *Traduzione, tradizione. La traduzione dalle varianti linguistiche alle varianti culturali*, a cura di A. Brettoni, Scutari, 5-6 giugno, 2008, Bulzoni, Roma 2009, f. 77-78. Shih edhe Francesco Altimari, “Vetëpërkthimi në veprat letrare arbëreshe” në *Urat e Arbërit. Studime filologjike dhe kritiko-letrare midis botës arbëreshe dhe botës shqiptare*, “Naimi” - Shtëpi botuese dhe studio letrare, Tiranë 2015, f. 275.

4 Po aty, f. 277.

me atë që përshtati një tjetër autor shqiptar, Pjetër Bogdani, vepra e të cilit (*Cuneus Prophetarum*), ribotuar tash së fundi përmes një pune filologjike rigorozë nga Anila Omari⁵, paraqet të njëjtin identitet tekstor qarkor mes dy versioneve shqip dhe italisht që vuri re Altimari për veprat e De Radës. Madje Anila Omari, bazuar në të dhënat tekstore që dëshmojnë ndikime të shumta nga italishtja, shkon deri atje sa të parashtrijë hipotezën se teksti shqip do të ketë ndjekur tekstin italisht dhe jo e kundërta, sikurse është menduar deri më sot⁶.

Të dhënat historike janë vërtet domethënëse për të kuptuar rrjedhën e zhvillimit letrar të shqiptarëve, të cilët, duke 5 Shih Pjetër Bogdani, *Çeta e profetëve*, botim kritik me një studim hyrës, faksimile të origjinalit, transkriptim e shënime nga përgatitur nga Anila Omari, botim i dytë i përmirësuar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2015. Shih Anila Omari, “Influenze latino-italiane nel *Cuneus Prophetarum* di Pietro Bogdani”, në *Cinque secoli di cultura albanese in Sicilia*, Atti del XXVIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi. Palermo – Piana degli Albanesi – Mezzojuso – Contessa Entellina. 16-19 maggio 2002, a cura di Matteo Mandalà, Palermo 2003, f. 475- 481. 6 «Përkthimi i tekstit në italisht dhe nevoja për të barazuar paragrafët në dy shtyllat paralele solli në shumë raste edhe ndikimin e strukturës italiane në tekstin shqip»: Anila Omari, “Tipare arkaike në gjuhën e Bogdanit: përkime me të folmet e Jugut”, në *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*, Albanische Forschungen 29, Hgg. von Bardhyl Demiraj, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden 2010, f. 358.



qenë një popull numerikisht i vogël, e kanë pasur të nevojshëm përkthimin, fillimisht nga gjuhët e huaja në shqipe, me qëllim që të ngrinin nivelin e përgjithshëm kulturor të popullsisë, pastaj edhe nga shqipja në gjuhë të tjera, kur u ndie nevoja për t'ua bërë të njohur të tjerëve letërsinë shqipe. Nga kjo nevojë e dyfishtë lindi kulti i përkthimit, i konsideruar një art i vërtetë, që në rrjedhë të kohës ka njohur pena të shquara, mes të cilëve po mjaftohemi të përmendim Fan S. Nolin (1882-1965), i cili solli në shqipe veprat e Shekspir, Servantesit, Ibsenit, Eskilit, Vërlenit, Bodëlerit, Haines etj. duke u dhënë kështu mundësinë brezave të ardhshëm të shkrimtarëve shqiptarë, mes të cilëve edhe Kadaresë, për të hyrë në kontakt me kryeveprat më të mëdha të letërsisë botërore. Pikërisht në shembullin paradigmatic të Nolit përkthimi u bë një veprimtari mjaft e frytshme që nuk është ndërprerë kurrë. Kjo traditë nuk u fashit as në vitet më të errëta të izolimit komunist, përkundrazi, për ironi të fatit u forcua nga regjimi që ishte i interesuar “të përhapte” ideologjinë e vet. Për këtë arsye pranë shtëpisë botuese *8 Nëntori* u ngrit një qendër ku, sikurse na dëshmon Edmond Tupja, «përkthehej nga shqipja në tetë gjuhë: anglishte, frëngjishte, gjermanishte, italishte, spanjishte, rusishte, greqishte dhe arabishte, por dihej nga të gjithë se përkthimet tona linin për të dëshiruar edhe si nivel përkthimi, me përjashtim të atyre në gjuhën frënge që mbanin firmën e Jusuf Vronit si përkthyes e si redaktor dhe që, sipas shprehjes së një të huaji, ishin ‘surprisingly good’»⁷. Pikërisht Jusuf Vroni do të bëhet protagonist i fazës së parë të përkthimit frëngjisht të prozës së Kadaresë, një fazë vendimtare për njohjen dhe konsakrimin ndërkombëtar të këtij autori. Mjafton të kujtohet se falë ndërmjetësimit të versioneve frënge, vepra kadareane u përkthye në shumë gjuhë të tjera, nga ato më të përhapurat, si kinezishtja, spanjishtja, anglishtja, arabishtja deri te gjuhët e Lindjes së Largët, si koreanishtja, malezishtja dhe singalishtja.

3. Përkthimi i veprës së Kadaresë, sidomos i asaj në prozë, zuri fill aty nga fundi i viteve '60 të shekullit të shkuar dhe qysh prej asaj kohe për gjashtëdhjetë vjet me radhë ka njohur qasje të ndryshme me rezultate po aq të ndryshme që më poshtë po i shqyrtojmë shkurtimisht. Për të pasur një ide të plotë dhe shtruese të përhapjes së veprave të Kadaresë në gjuhë të ndryshme nga shqipja kemi shfrytëzuar botimin trigjuhësh shqip-frëngjisht-anglisht të veprës së madhe *Enciklopedi Kadareane*, realizuar nga Bashkim Kuçuku në bashkëpunim me studiuesen e re Jorina Kryeziu⁸. Kjo enciklopedi është një

7 Edmond Tupja, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë 2000, f. 25.

8 Shih Bashkim Kuçuku – Jorina Kryeziu, *Enciklopedi kadareane – L'encyclopédie kadareenne - The kadarean encyclopedia*, vëll./vol. I, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë 2020. Jorina Kryeziu është autore e një bibliografie kadareane në dy vëllime: shih Jorina Kryeziu (Shkreta), *Kadare bibliografi*, Vëll. I: Vepra (1948-2010); vëll. II: Studime (1953-2010), Botime Pegi, Tiranë 2014.

mjet shumë i dobishëm që përmbledh në mënyrë analitike të dhënat mbi përkthimet e shumta të veprave në poezi dhe në prozë, duke filluar nga ato të kryera në Shqipëri kur autori sapo kishte filluar të bëhej i njohur. Është fjala për të dhëna me interes për albanologët dhe studiuesit e letërsive të krahasuara, sepse përmbajnë aspekte që shtrajnë një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me cilësinë e përkthimeve, me receptimin e veprës kadareane jashtë Shqipërisë për më se gjysmë shekulli dhe, së fundi, me politikat e veçanta editoriale që, sidomos në rastin e përkthimeve italisht, kanë përcaktuar zgjedhjen e veprave që do t’u jepeshin lexuesit.

Në hullinë e kërkimeve të mia kritike mbi veprën e Kadaresë, paraprakisht mora në shqyrtim rezultatet e studimeve të kryera gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit në Itali. Mes tyre duhen përmendur tubimet shkencore kushtuar Ismail Kadaresë të organizuara në Universitetin e Venecias “Ca’ Foscari” në vitet 2006 dhe 2009 nga studiuesit Alessandro Scarsella⁹ dhe Giuseppina Turano¹⁰, nismëtarë të një projekti kërkimor mbi prodhimin letrar të Kadaresë, rezultatet e të cilit u përmblodhën në një vëllim që u botua në vitin 2012¹¹. Merita kryesore e këtyre nismave qëndron në faktin se ato i dhanë hapësirën e duhur debatit kritik mbi disa tema me të cilat po merrem prej kohësh dhe sidomos mbi marrëdhëniet jo gjithmonë të qarta mes gjuhës së nisjes dhe gjuhës së mbërritjes, marrëdhënie që në rastin tonë, siç do ta shohim më poshtë, paraqesin disa probleme, sepse përkthimet italisht janë kryer jo nga origjinalet shqip, por nga përkthimet frëngjisht. Përmend këtu sa për ilustrim vërejtjet kritike që botoi i ndjeri Gianni Belluscio¹², i cili, duke analizuar përkthimet e veprave të Kadaresë¹³ në tubimet e Venecias, vuri në pah një mori gabimesh përkthimi që rezultuan nga ballafaqimi i versioneve origjinale shqip me përkthimet përkatëse italisht të kryera me ndërmjetësimin e frëngjishtes. Vërejtjeve të Belluscio-s u shtuan më pas ato të Giovanna Nanci-t, të parashtruara në tezën e saj të doktoratës¹⁴. Nanci, edhe mbi bazën e përvojës vetjake si përkthyesë me përvojë nga shqipja në italishte, analizoi përkthimet e ndryshme italisht të romanit *Kështjella*, duke ballafaquar versionet e para që u botuan në Tiranë nga fundi i viteve ’60 nga përkthyesit shqiptarë me botimet në Itali në vitet ’70 të kryera nga përkthyes italianë mbi bazën e botimeve franceze.

Anomalitë që vuri në dukje Nanci hasen rregullisht thuajse në të gjitha përkthimet e tjera në italishte, prandaj ato na ndihmojnë të rindërtojmë historinë e përkthimeve italisht të prozës kadareane, në të cilën histori dallojmë qartë tri faza që po i përshkruajmë në vijim.

a) Faza e parë zuri fill në vitet ’60 të shekullit të shkuar me nismën e shtëpisë botuese *8 Nëntori*, e cila ishte përfshirë në një veprimtari të dendur propagande politike me përkthimin në gjuhët e huaja kryesore të veprave të Enver Hoxhës. Grupit të përkthyesve shqiptarë që punonin pranë kësaj shtëpie botuese iu ngarkua edhe përkthimi i veprave të autorëve më të njohur shqiptarë, mes të cilëve edhe të Kadaresë, prej të cilit duke



nisur nga viti 1968 u përkthyen italisht disa romane dhe një përmbledhje poetike¹⁵. Pa përmendur mospërkimet e shumta të nivelit mikrotekstor, të cilat me gjasa i detyrohen mosnjohjes së mirë të italishtes nga ana e përkthyesve shqiptarë emrat e të cilëve mbetën anonimë, këtu po mjaftohem të shqyrtoj vetëm titujt e dy romanëve të parë të Kadaresë, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dhe *Kështjella*, që në vetvete shfaqin kufizimet e kësaj faze.

Gjenerali i ushtrisë së vdekur, romani që i siguroi Kadaresë njohjen ndërkombëtare, u përkthye dhe u botua në vitin 1974 me titullin *Il generale dell’armata sepolta*¹⁶, pra me një dallim të theksuar kuptimor që nuk haset në përkthimin frëngjisht të së njëjtës shtëpi botuese që do ta shohim më poshtë. Vendimi për të përkthyer si *sepolta* [së varrosur] mbiemrin shqip *së vdekur*, që kuptimisht i përgjigjet italishtes *morta*, nuk duhet konsideruar si gabim përkthimi, por duhet parë në optikën e realizmit socialist që orientonte edhe veprimtarinë përkthimore: meqenëse bëhet fjalë për një roman që praktikisht përshkruan gjetjen dhe zhvarrosjen e eshtrave të ushtarëve armiq të vrarë gjatë luftës për çlirimin e atdheut, zgjedhja e përkthyesit përputhet me orientimin ideologjik të regjimit. Në Shqipërinë e asaj kohe ishte e pamundur të analizohej romani i Kadaresë në këndvështrimin modernist, pra si një padi ndaj karakterit çnjerëzor të luftës ose si metaforë mbi jetën dhe vdekjen, temë kjo e fundit që në poetikën narrative të Kadaresë do të rishfaqet shpesh te romanët e tij të ardhshëm ku rimerret *toposi* i të vdekurit që ringjallet. Të vihet re se të njëjtën “zgjedhje” gjëmë edhe te botimi spanjisht i romanit që doli në Kubë në vitin 1976, por që në botimin e mëpasshëm të vitit 1987 u ndreq dhe iu përshtat versionit frëngjisht.

Nga ana e vet romani *Kështjella*, duke shfaqur një tjetër lloj anomalie përplotësuese me të parën, vë në pah një aspekt që do të rikthehet si problem në zgjedhjet editoriale pas vitit 1990, pra pas rënies së regjimit diktatorial në Shqipëri. Botuar italisht në vitin 1975 me titullin *La fortezza*¹⁷, përkthimi nuk mban parasysh versionin frëngjisht që kishte dalë tre vjet më parë në Paris me titullin *Les tambours de la pluie*. Dallimi mes dy titujve në këtë rast nuk i detyrohet zgjedhjes së përkthyesit, por vullnetit të autorit, që u shfaq fillimisht në versionin frëngjisht, pastaj edhe në të gjitha përkthimet në gjuhë të tjera, si edhe në ribotimet shqip të romanit (*Kasneçët e shiut* dhe *Daullet e shiut*)¹⁸. Madje edhe

15 Ismail Kadare, *Poemi e poesie scelte*, Casa editrice “8 Nëntori”, Tiranë 1968.

16 Ismail Kadare, *Il generale dell’esercito sepolto. Romanzo*, Casa editrice “Naim Frashëri”, Tirana 1974.

17 Ismail Kadare, *La fortezza. Romanzo*, Casa editrice “8 Nëntori”, Tirana 1975.

18 Ngulim këmbë në vlerën e titujve të romaneve të Kadaresë pasi, duke nisur pikërisht me rastin e romanit *Kështjella*, ata u bënë objekt diskutimesh të ashpra mes autorit, që parapëlqente zgjedhje të karakterit estetik, dhe funksionarëve politikë të shtëpisë botuese, të cilët kërkonin tituj që të pasqyronin sa më mirë vizionin ideologjik të kohës. Në rastin e romanit në fjalë, u zgjodh titulli *Kështjella* sepse



botimi anglez për të cilin përkthyesi David Bellos parapëlqeu titullin *The siege*, i duhet atribuuar Kadaresë që jo rastësisht e zgjodhi për botimin e fundit shqip (*Rrethimi*).

b) Botimi në vitin 1970 në Paris nga shtëpia botuese “Albin Michel” i versionit francez të *Gjeneralit të ushtrisë së vdekur* (*Le général de l’armée morte*) shënoi fillimin e fazës së dytë, më saktë atë që përcaktoi në kontekstin ndërkombëtar ndërmjetësimin e frëngjishtes për shumë përkthime në gjuhë

përfaqësonte një simbol ideologjik të Shqipërisë së kohës, një “kështjellë” e rrethuar nga armiq të shumtë revizionistë dhe imperialistë, sikurse kishte qenë Shqipëria e Skënderbeut e rrethuar nga turqit. Këtë interpretim bën Aleks Buda kur në paragrafin e fundit të pasthënies së botimit të parë italisht shkruan: «Lufta e madhe popullore që u zhvillua në shekullin XV në Shqipëri dhe që evokohet në librin e I. Kadaresë, qe një ngjarje me rëndësi të madhe jo vetëm për kohën, për popullin dhe për vendin që lindi heroin. Ajo do të mbetet aktuale kudo që të ngrihet lufta fisnike e popujve të shtypur për të mbrojtur ose për të fituar lirinë, pavarësinë dhe të drejtat e mohuara»: Aleks Buda, “Nota” në Ismail Kadare, *La fortezza*, cit., f. 302. Në fakt Kadare për këtë roman kishte zgjedhur titullin *Kasneçët e shiut*, që më pas në versionin francez u bë *Les tambours de la pluie*, funksioni i të cilit ishte të theksonte vlerën shëlbuese të ujit, në këtë rast të shiut, që do të ndillej nga daullet. Mbi interpretimin kritik të romanit shih Matteo Mandalà, “Kështjella e letërsisë dhe themelet e poetikës kadareane”, *parathënie* në Ismail Kadare, *Vepra*, vëll. 3, *Rrethimi*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë 2008. Matteo Mandalà, “Skanderbeg vs. Kastrioti. La letteratura albanese assediata, tra *revenant* e doppi kadareiani”, në Monica Genesin & Joachim Matzinger & Giancarlo Vallone (eds.), *The Living Skanderbeg. The Albanian Hero between Myth and History*, Verlag Dr. Kovač (Orbis - Wissenschaftliche Schriften zur Landeskunde, Band 16), Hamburg 2010, f. 19-39. Paçka se i një tjetër lloji, p aq i rëndësishëm është edhe rasti i titullit të novelës *Lulet e ftohta të marsit* që në përkthimin frëngjisht u ndryshua në *Froides fleurs d’avril*, me qëllim që të shmangej ambiguiteti që rridhte nga homofonia (por jo edhe homografia!) *mars*, që në frëngjishte, sikurse në shqipe, përveç emrit të muajit, shënon edhe emrin e planetit. Kjo zgjedhje e diskutueshme shpreh shqetësimin e tepruar të botuesit francez, që me sa duket nuk kishte besim në aftësinë e lexuesve francezë për të shquar vlerën e germës së madhe, e cila në frëngjishte përdoret për emrat e planetëve. Mirëpo më shumë të habit përkthimi italisht, i cili meqenëse u krye mbi bazën e atij frëngjisht, sjell besnikërisht versionin e titullit të këtij të fundit pa mbajtur parasysh as origjinalin shqip, as faktin se italishtja e dallon qartë emrin e muajit (marzo) nga emri i planetit (Marte). Më pak i rëndësishëm dhe vetëm pjesërisht i bazuar në vullnetin e autorit është titulli francez *Le palais des rêves*, nga i cili rrjedh titulli i botimit italian *Il palazzo dei sogni*, por që në botimet e para shqip ishte *Nëpunësi i Pallatit të ëndrrave*: edhe në këtë rast ndryshimi i titullit ka sjellë zhvendosjen e vëmendjes së kritikës nga protagonistin, në figurën e të cilit mund të identifikojmë vetë autorin, te konteksti mbytës i regjimit: shih Matteo Mandalà, “Për një botim kritik të *Nëpunësit të pallatit të ëndrrave*. Shënime paraprake” në *Kadare, leximi dhe interpretimi (ese dhe studime në tetëdhjetëvjetorin e lindjes)*. Përmbledhje e përgatitur nga Ardian Ndreca, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë, 2016, f. 13-52. Së fundi shënojmë bashkë me Alessandro Scarsella-n «varësinë nga receptimi francez në përkthimet e dorës së dytë dhe në transkriptimin e emrit të autorit: *Kadarë* – francezizëm dhe pasqyrë e një provincializmi dashamirës, sepse ia ka dhënë mjeshttrin shqiptar komunitetit të lexuesve më të fortë (që në Itali janë ata të përkthimit), por që mund të shmangej duke ndjekur të njëjtin objektiv»: Alessandro Scarsella “Ismail Kadare in Italia” në Ismail Kadare, *Anche se è aprile*, un itinerario a cura di Marina Giaveri per il Premio Lericipea 2010 all’Opera poetica, Introduzione e scelta dei testi di Marina Giaveri, Prefazione di Nullo Minissi, Sangiorgio editrice, Genova, 2010, f. 101.

të tjera. Merita e këtij rezultati të dyfishtë i takon punës së jashtëzakonshme të të ndjerit Jusuf Vrioni (1916-2001), përkthyesit të shumë romaneve frëngjisht (*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, *Daullet e shiut*, *Kronikë në gur*, *Ura me tri harqe*, *Prilli i thyer*, *Kushe solli Doruntinën*, *Muzgu i perëndive të stepës*, *Përbindëshi*, *Pallati i ëndrrave*, *Nëntori i një kryeqyteti*) që favorizuan suksesin ndërkombëtar të veprës së Kadaresë. Vrioni e njihte shumë mirë frëngjishten, që e kishte mësuar në të ri kur bashkë me familjen kishte banuar në Paris. Pas kthimit në Shqipëri kaloi thuajse dhjetë vjet në burgjet e regjimit derisa në vitin 1960, me t’u liruar, u emërua si përkthyes në shtëpinë botuese *8 Nëntori*. Romani i parë që përktheu ishte *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* që pastaj u botua në Paris. Në librin e tij autobiografik, duke iu referuar përkthimeve të Kadaresë, Vrioni e pranoi se puna e tij si përkthyes përkrahej nga vetë autori i cili kishte njëfarë njohjeje të frëngjishtes. Suksesi editorial qe i menjëhershëm, aq sa përkthimet e mëvonshme të veprave kadareane në gjuhë të tjera u mbështetën në një masë të madhe pikërisht te botimet franceze. Gjithsesi do thënë se, paralelisht me rritjen e famës së Kadaresë në nivel ndërkombëtar, zgjedhjet editoriale që u vunë re në vende të ndryshme shënuan dallime të ndjeshme. Kështu p.sh., në vendet anglishtfolëse disa shtëpi botuese për njëfarë kohe botuan përkthime të mbështetura te versionet franceze. Më vonë disa shtëpi botuese filluan të botonin përkthime nga origjinalet shqip të kryera nga përkthyes që e njihnim mirë shqipen. Kështu, ndërkohë që David Bellos, Émile Capouya, Derek Coltman, Barbara Bray, Jon Rothschild vijuan t’i përkthenin veprat e Kadaresë nga frëngjishtja, Peter Constantine dhe sidomos John Hodgson u bazuan te origjinalet shqip. Në Gjermani u zhvillua një traditë tjetër falë punës së albanologëve Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler, të cilët qysh në vitin 1973 e përkthyen nga origjinali shqip *Gjeneralin*, duke i hapur kështu rrugën njërit prej përkthyesve më të frytshëm të veprës së Kadaresë, Joachim Röhm, i cili është njëherazi edhe një nga studiuesit më të mirë të veprës së tij. Këtë qasje të re në spanjishte e nisi Ramón Sánchez Lizarralde që përktheu drejtpërdrejt nga shqipja veprat e Kadaresë dhe të shumë shkrimtarëve shqiptarë. Ndërkohë në Rumani lexuesit u njohën me veprën e Kadaresë falë përkthimeve prej origjinalit shqip të kryera nga Marius Dobrescu.

c) Kthesa e ndërmarrë në këto vende dhe në vende të tjera, ndryshe nga përpjekja e izoluar që u bë në vitin 1966 në Sofje me botimin e *Gjeneralit të ushtrisë së vdekur* bullgarisht në përkthimin e Marina Marinowa-s, karakterizoi fazën e tretë dhe të fundit të përkthimeve të veprës së Kadaresë. Jo aq e qartë shfaqet gjendja në Itali ku ende mbizotërojnë përkthimet e ndërmjetësuara nga gjuhë të dyta. Kështu, po të përjashtojmë përkthimin nga shqipja të *Komisionit të festës*, kryer në vitin 1996 nga Fernando Cezzi për shtëpinë botuese *Besa* dhe esenë e Kadaresë mbi *Hamletin* përkthyer nga poeti arbëresh Giuseppe Schirò Di Maggio, të gjitha përkthimet e tjera italisht të botuara pas vitit 1990 (*La figlia di Agamennone*, *Il successore*, *La bambola*, *L’incidente*, *La provocazione*, *Un invito a cena di troppo*, *Vita, avventure e morte di un attore* etj.) janë bërë nga përkthimet frëngjisht të Tedi Papavramit, të cilit shtëpia botuese Fayard i besoi detyrën të përkthejë veprën e Kadaresë pas vdekjes së Jusuf Vrionit në vitin 2002.

Karakterit kontradiktor i zgjedhjeve editoriale theksohet nga dy prirje të kundërta: nga njëra anë, disa shtëpi botuese të Italisë së Jugut, mes të cilave vlen të përmendim *Besa*, *Argo* dhe *Rubbettino*, kanë ngarkuar disa përkthyes italianë që e njohin mirë shqipen të përkthejnë nga origjinali veprat e shkrimtarëve më të mirë shqiptarë, si Dritëro Agolli, Mitrush Kuteli, Luan Starova, Fatos Kongoli, Visar Zhiti, Ylljet Aliçka, Bashkim Shehu, Agron Tufa etj. Nga ana tjetër, disa shtëpi botuese të tjera vijnë edhe sot e gjithë ditën t’i përkthejnë italisht veprat e Kadaresë nga versionet franceze, ose përndryshe ua besojnë

9 Alessandro Scarsella (a cura di), *Leggere Kadare. Critica ricezione bibliografia*, Biblion edizioni, Milano 2008.

10 Giuseppina Turano (a cura di), *Kadare europeo e la cultura albanese oggi*, Contesti adriatici, Bulzoni, Roma 2011.

11 Alessandro Scarsella - Giuseppina Turano (eds.), *La scrittura obliqua di Ismail Kadare (L’écriture oblique d’Ismail Kadaré)*, Balcanistica e comparatistica, Granviale editori, Venezia 2012.

12 Shih Gianni Belluscio, “Leggere Kadare in italiano tra riscrittura e mistificazioni” në Alessandro Scarsella (a cura di), *Leggere Kadare*, cit., f. 32-50.

13 Shih Gianni Belluscio, “NOBELesse oblige” në Giuseppina Turano (a cura di), *Kadare europeo*, cit., f. 45-78.

14 Giovanna Nanci, *Problematiche traduttologiche in contesto interlinguistico del romanzo Kështjella di Ismail Kadare: analisi contrastiva e nuovi approcci traduttivi*, Tesi di Dottorato - Scuola Dottorale Internazionale di Studi Umanistici, ciclo XXV, Università della Calabria. Shih Giovanna Nanci, “Romani *Kështjella* i Ismail Kadaresë në gjuhën italiane: disa vërejtje nga analiza e përkthimit” në Res Albanicae. Rivista di Albanologia, anno II, nr. 1, 2013, f. 141-156;

përkthyesve shqiptarë përkthimin italisht të disa veprave minore të Kadaresë, si p.sh. *L'occhio del tiranno* i vitit 2012 (përkthyer nga Beniamin Guraziu) ose *La bambola* (2017), *La provocazione* dhe së fundi *Aprile spezzato* (2019) (përkthyer nga Liljana Cuka Maksuti), përkthime këto të fundit që paraqesin mospërkime dhe shtrembërime të shumta të origjinalit, te të cilat është ndalur Lili Sula në një studim të posaçëm mbi përkthimin e romanit autobiografik *Kukulla (La bambola)*¹.


4. Nuk na takon neve të analizojmë a të komentojmë cilësinë e këtyre përkthimeve, që tashmë janë shqyrtuar në mënyrë kritike në studimet e lartpërmendura nga Gianni Belluscio dhe Giovanna Nanci; as të shprehim gjykime mbi punën e bërë nga përkthyes të veçantë ose mbi “gabimet” e tyre eventuale, çka do të na vinte në krahun e kundërt të qëndrimit kritiko-estetik të vetë Kadaresë:

«...përkthimi nxjerr si rrjedhim gabimin dhe interpreti ngre si hipotezë sakrilegjin. Kështu, mund të arrihet në përfundimin se të përkthesh është diçka e pamundur. Unë mendoj të kundërtën: Historia e njerëzimit është historia e përkthimit. Ne të gjithë jemi përkthyes, madje edhe gjatë një bisede të thjeshtë. Ne kushtëzohemi nga përkthimi; ne përkthejmë mendimet tona; ne përkthejmë fjalët e bashkëbiseduesve tanë; ne përkthejmë vazhdimisht duke folur dhe ky është fati ynë i përditshëm... Si përfundim, të përkthesh do të thotë të përpiqesh të zbusësh veçoritë specifike me qëllim që t'u qëndrosh atyre besnik. Nëse sentenca italiane traduttore traditore (përkthyesi është tradhtar) mund të kuptohet nganjëherë si metaforë, në Ballkan ndodh ndryshe. Në këto vise ajo ka njohur një dramatizim të thellë [...] Përkthyesi dyshohet për tradhti: të sunduarit dyshojnë se ai është bashkëfajtor me sundimtarët dhe sundimtarët dyshojnë se ai bashkëpunon fshehurazi me ata që ata sundojnë. Nga të gjitha anët përkthyesi akuzohet për mashtrim»².

Ky qëndrim i autorit pasqyron narrativën në të cilën vepronte Besnik Struga, personazhi i famshëm i romanit *Dimri i vetmisë së madhe*, përkthyesi zyrtar që u gjend në qendër të grindjes historike mes dy diktatorëve komunistë, sovjetikut të fuqishëm Nikita Hrushov dhe shqiptarit të vogël Enver Hoxha, grindje që përcaktoi prishjen e marrëdhënieve mes dy vendeve. Struga u akuzua hapur për “gabime” përkthimi që pastaj u përdorën si pretekst

1 Shih Lili Sula, “*La bambola* e Kadaresë: objekti letrar dhe përkthyeshmëria”, kumesë e mbajtur në konferencën *Botët e përkthyerat të letërsisë: nga përkthimi te krijimi*, e mbajtur në Tiranë në vitin 2020. Vëllimi është në shtyp e sipër. I jam mirënjohës koleges Lili Sula që më lejoi të lexoj dhe të citoj dorëshkrimin e studimit të saj.

2 Ismail Kadare – Denis Fernandez Récatala, *Katër përkthyesit*, përktheu nga frëngjishtja Haki Shtabli, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë 2004, f. 13-14.



për acarimin e debatit politiko-ideologjik mes dy politikanëve. Përkthyesi bëhej kështu kokë turku për paudhësitë e të tjerëve dhe i nënshtrohej denigrimit publik. Natyrisht gabimi është një përbërës i pashmangshëm në çdo lloj pune, sidomos në një veprimtari si përkthimi ku keqkuptimet mund të fshihen pas hollësive leksiko-semantike, veçanërisht në një gjuhë si shqipja që është standardizuar relativisht vonë. Kështu, në vend që të qëmtojmë gabimin si të tillë, është më e rëndësishme të përqendrojmë vëmendjen te kundërvëniet e mirëfillta që vazhdojnë të karakterizojnë përkthimet e veprave të Kadaresë dhe natyrisht të kushtëzojnë receptimin dhe analizën kritike të tyre.

5. Pas rënies së regjimit në vitin 1990, Kadare e ka rishikuar gjithë korpusin e tij letrar, duke ndërhyrë në tekste, përfshirë ato që tashmë ishin përkthyer në frëngjisht. Vepra e plotë që u botua së fundi në 20 vëllime nga shtëpia botuese Onufri është konsideruar nga vetë Kadare si testamenti i tij letrar, pra si shprehja e vullnetit të fundit të autorit. Kështu sot mund të shtrojmë pyetjen: cilat variante duhen përkthyer për lexuesin italian, ato para vitit 1990, me fjalë të tjera ato që u përkthyen nga frëngjishtja e Jusuf Vrionit, apo duhen bërë përkthime të reja mbi bazën e rishikimeve më të fundit të autorit? Në këtë rast të fundit, a duhet ndjekur rruga e dikurshme kur kishte mungesë përkthyesish nga origjinali apo duhet vepruar sipas rregullave normale që kërkojnë përkthim nga shqipja, sikurse kanë nisur të bëjnë disa shtëpi botuese angleze, gjermane, spanjolle etj.? Para se t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve është e domosdoshme të zgjidhim disa probleme të vështira, si ato që vënë në diskutim përkthimet e derisotme; që shtrojnë çështjen e besnikërisë së përkthimit, duke propozuar kështu të njëjtin diskutim që u shtrua nga Michael Orthofer³; apo që përmbajnë në vetvete çështje të mëtejshme në disa rrafse të analizës letrare: në rrafshin filologjik, në atë kritiko-letrar dhe së fundi në rrafshin traduktologjik. Bëhet fjalë për qasje metodologjike të ndryshme, por edhe të lidhura ngushtë, sepse nga kombinimi i tyre varet qëndrueshmëria e tekstit, analiza e saktë e tij dhe natyrisht përkthimet në gjuhë të tjera. Këtyre aspekteve të fundit do t'u kushtojmë vërejtjet e mëposhtme.

Është një e dhënë që merret si e mirëqenë nga studiuesit e veprës së Kadaresë që ndërhyrjet e shpeshta të autorit gjatë ribotimit të veprave kanë sjellë ndryshime të ndjeshme në tekstet e romaneve. Është fjala për ndërhyrje stilistike dhe gjuhësore,

3 Shih Michael Orthofer, “Twice Removed. The Baffling Phenomenon of the Translated and then Re-Translated Text”, në “Complete Review Quarterly”, në faqen internet <http://www.complete-review.com/quarterly/vol4/issue4/doubletd.htm>. Duke u pajtuar me vërejtjet e Orthofer, edhe përkthyesja e Kadaresë Francesca Spinelli ka shprehur të njëjtat rezerva: shih Spinelli, “A due o a quattro mani: lo strano caso dei traduttori di Ismail Kadare”, në Emma Bond – Daniele Comberiati (a cura di), *Il confine liquido. Rapporti letterari e interculturali fra Italia e Albania*, Besa, Lecce, 2013, f.72-84.

të kryera sidomos pas viteve '90, paçka se edhe më parë janë vënë re ndërhyrje pak a shumë të rëndësishme. Jusuf Vrioni ka vënë në dukje se disa ndryshime te tekstit shqip Kadare i ka bërë mbi bazën e versioneve frëngjisht dhe se nga ky lloj përkthimi së prapthi varen shumë rishikime, si ato që vuri në dukje Gianni Belluscio për romanin *Kështjella*, që kanë krijuar dallime të shumta në përkthimin e veprave të para kadareane. Shumë më rrënjësore kanë qenë ndërhyrjet e autorit pas përmbysjes së regjimit, periudhë gjatë së cilës Kadare mundi t'i rishikonte lirisht veprat e tij në tërësinë e tyre, përfshirë edhe veprat e ndaluara nga censura, si *Përbindëshi*, ose edhe disa vepra që u shkruan gjatë viteve '80, por u botuan së pari në Francë pas dhjetë vjetësh, si *Pasardhësi*, *Vajza e Agamemnonit* dhe *Hija*. Një operacion i tillë “rishkrimi” ka prekur në radhë të parë rrafshin gjuhësor përmes një sërë risish që Kadare shtiu në punë pikërisht në kohën kur niste të kristalizohet gjuha letrare shqipe fill pas kodifikimit të saj në Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972⁴.

Zakoni i Karadesë për të vënë dorë mbi librat e tij konfirmohet edhe për periudhën gjatë regjimit. Bëhet fjalë për ndërhyrje të lehta me karakter estetik-stilistik që nuk preknin strukturën e veprave. Përfshatim bëri rasti i ribotimit të romanit *Dimri i vetmisë së madhe*, botimin kritik të dorëshkrimit origjinal të të cilit pata nderin ta përgatitja për shtyp⁵. Botimi i parë i këtij romani në vitin 1973 u prit me një fushatë të ashpër kritikash të organizuara nga strukturat e partisë në pushtet dhe, sipas disa burimeve të besueshme, nga vetë Nexhmije Hoxha, gruaja e diktatorit⁶. Kritikën e detyruan Kadarenë ta rishikonte romanin strukturalisht, madje edhe të fuste disa pjesë që i sugjeroheshin nga një grup ekspertësh të ngarkuar nga censura dhe sidomos nga Nexhmije Hoxha, e cila vuri dorë drejtpërdrejt në disa pjesë që sipas saj duheshin ndrequr⁷. Në lidhje me këtë gjyq

4 Për këto aspekte të shihen dy studimet e Giuseppina Turano-s: “L'arte magica del creare. Neologismi nell'opera di Ismail Kadare, në *La scrittura obliqua*, cit., f. 89-114 dhe “L'incrocio fecondo tra la lingua e il dialetto nella scrittura di Ismail Kadare” në *Letteratura e Dialetti*, Anno 2014 – Annata: VII - N. 7 (2014), f. 47-58. Me interes gjuhësor është edhe fjalori “kadarean” i hartuar nga Natasha Sotiri, *Fjalori i gjuhës së Ismail Kadaresë. Ndihmesë për një fjalor historik të shqipes*, vëll. I: A-J, prathënie nga Shaban Sinani, Shtëpia botuese “Medaur”, Tiranë, 2007.

5 Shih Matteo Mandalà, *Në studion Kadare. Botim kritik i dorëshkrimeve të romanit Dimri i vetmisë së madhe*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë 2016.

6 Për një vështrim historiko-kritik të veprimtarisë së Ismail Kadaresë, shih Peter Morgan, *Ismail Kadare. The Writer and the Dictatorship 1957-1990*, Legenda – Modern Humanities Association and Maney Publishing, Oxford, 2010, f. 115-160 dhe Matteo Mandalà, *Ismail Kadare tra la verità dell'arte e l'inganno della realtà*, në *Studia Albanica*, (pjesa e parë) nr. 1(2016), f. 3-25; (pjesa e dytë) nr. 2(2016), f. 3-46, që u botua shqip me titullin *Ismail Kadare mes së vërtetës së artit dhe mashtrimit të realitetit*, Përktheu dhe redaktoi Gëzim Gurga, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë, 2018.

7 Historia e kësaj faze të shkrimit të romanit mbetet ende për t'u sqaruar. Të shihet libri i Shaban Sinanit, *Letërsia në totalitarizëm dhe Dosja K: studim monografik*




publik që iu bë një romani artistik, është e qartë se *Dimri i madh* (1977) që doli si rezultat i redaktimit shumëduarsh, paçka se meriton njëfarë vëmendjeje kritike, nuk mund të konsiderohet *sic et simpliciter* si tekst referimi për poetikën kadareane. Gjithsesi, po të vendosim ta analizojmë në atë vështrim, duhet më parë të përmbushen dy kushte paraprake: duhet të sigurohemi se ai tekst shpreh vërtet vullnetin e autorit dhe për këtë qëllim duhet ta ballafaqojmë me botimin e fundit të romanit, për të cilin autori jo më kot ka vendosur të rimarrë titullin origjinal *Dimri i vetmisë së madhe*. Prandaj nga pikëpamja filologjike përkthimi dhe botimi eventual në italishtë duhet të mbështetet tek i vetmi version shqip për të cilin jemi të sigurt se shpreh vullnetin e autorit, domethënë te botimi i parë i vitit 1973. Bazuar në këtë domosdoshmëri Laboratori i Albanologjisë i Universitetit të Palermos ka vendosur t'ia hyjë një projekti filologjik që synon të ballafaqojë tekstet e varianteve origjinale të të gjitha veprave të Kadaresë me variantet e mëvonshme të botuara në Tiranë dhe në Prishtinë me qëllim që të verifikojë sasinë dhe cilësinë e ndryshimeve dhe të hartojë një kuadër sinoptik në të cilin të gjitha variantet filologjikisht të rëndësishme t'i nënshtrohen vlerësimit kritik.

Të dhënat që kanë dalë në dritë deri tani kanë një vlerë të dyfishtë: nga njëra anë konfirmohet plotësisht ajo çka është thënë empirikisht mbi rishikimet e autorit, pra duke qenë se bëhet fjalë për ndërhyrje të shumta dhe shpesh të rëndësishme tekstore, duhen bërë përkthime krejt të reja; nga ana tjetër, në dritën e këtyre të dhënave është e pashmangshme që të ndërmerret një rrugë krejt e ndryshme nga ajo që ka karakterizuar përkthimet e deritanishme të veprave kadareane, pra të aktivizohen përkthyes të cilët, duke e njohur mirë shqipen, të jenë në gjendje të respektojnë parimin Übersetzung ist eine Form (*përkthimi është formë*), në emër të të cilit Walter Benjamin kërkonte kthimin tek origjinali, një kthim që në rastin e prozës së Kadaresë bëhet i domosdoshëm edhe për arsye estetike dhe stilistike. Sot mendojmë se është konkretisht e realizueshme shpresa e David Bellos për të parë një ditë të përkthyer veprën e Kadaresë në gjuhët e botës nga përkthyes që t'i kenë ato gjuhë të nënës dhe që njëherazi ta njohim shumë mirë gjuhën shqipe⁸. Në Itali ka shumë përkthyes italianë që kanë dëshmuar se e njohin shumë mirë shqipen. Përveç përkthimeve të kryera nga kolegë të shquar, profesorë universitarë dhe intelektualë arbëreshë, përmendim këtu kontributet e Fernando Cezzi-t, Giovanna Nanci-t dhe Valentina Notaro-s. Po të mbahet parasysh se studentët e shumtë të albanologjisë pranë katedrave të gjuhës dhe të letërsisë shqipe të universiteteve të Kalabrisë, të Palermos, të Salentos, të Napolit, të Romës dhe të Venecias përbëjnë një ushtri potenciale përkthyesish të ardhshëm nga shqipja në italishtë, shtëpitë botuese italiane nuk do ta kenë vështirë të gjejnë përkthyes të vlefshëm. Me këtë rast

dhe dokumente, Naimi Shtëpi botuese dhe studio letrare, Tiranë, 2011. Kontribut të vyer për njohjen e periudhës historike, si edhe të kufizimeve të Kadaresë gjatë viteve kur ia hynte shkrimit të këtij romani përbëjnë dy vëllimet ku Dashnor Kaloçi ka mbledhur dokumente të shumta të partisë, të organeve të kontrollit dhe të sigurimit të shtetit: shih Dashnor Kaloçi, *Kadare i denoncuar (32 dokumente arkivore “Tepër Sekret”, të papublikuara më parë, nga Fondi i ish-Komitetit Qendror të PPSH-së*, parathënie nga Henri Çili, Shtëpia botuese UET Press, Tiranë, 2015; Dashnor Kaloçi, *Kadare dhe regjimi komunist: 101 dokumente nga aparati diktatorial shtetëror 1959-1991*, Shtëpia botuese UET Press, Tiranë, 2018. Është fjala për materiale arkivore të dorës së parë, të domosdoshme për filologët dhe studiuesit e letërsisë, prandaj të habit fakti që këta i injorojnë ato. Po ashtu të habitin përpjekjet pseudo-filologjike që rreken të analizojnë variantet e këtij romani duke shpërfillur (qëllimisht?) dokumentet arkivore që jo vetëm ndriçojnë kontekstin historik dhe kushtet e nënshtrimit absolut ndaj pushtetit në të cilat ishin të detyruar të punonin shkrimtarët shqiptarë gjatë regjimit enverist, por ofrojnë edhe të dhëna të vyera në funksion të interpretimit kritik të veprave.

8 «One day, I hope, a literary translator with fluent Albanian will devote a lifetime to translating the entire oeuvre over again»: David Bellos, “The englishing of Ismail Kadare. Notes of a retranslator”, *Complete Review Quarterly*, volume VI, Issue 2, May 2005, në faqen web <http://www.complete-review.com/quarterly/>.



i bëjmë thirrje shtëpive botuese italiane të përkthejnë e të botojnë edhe ato vepra të Kadaresë që lexuesi italian ende nuk i njeh dhe që janë themelore për një receptim sa më të plotë të poetikës kadareane. E kemi fjalën veçanërisht për të ashtuquajturit romanë “binjakë”, *Dimri i vetmisë së madhe* dhe *Koncert në fund të dimrit*, historitë e të cilëve gërshetohen me disa momente kyçe të historisë politike dhe civile të Shqipërisë komuniste: me prishjen e marrëdhënieve, përkatësisht, me Bashkimin Sovjetik dhe me Kinën maoiste. Përveç këtyre dy veprave madhore, lexuesi italian ende nuk njeh më se njëzet vepra të tjera të Kadaresë: romanë, novela, përmbledhje tregimesh, vëllime poetike⁹, pa lënë mënjanë një pjesë të mirë të eseistikës që me të drejtë Floresha Dado¹⁰ e konsideron si një nga mjetet me efikase për të njohur fazat e zhvillimit artistiko-intelektual të këtij autori.

Është fjala për një punë të madhe që shtrihet njëkohësisht në disa rrafshe, të cilat bashkohen të gjitha te figura e përkthyesit, ura e vërtetë e komunikimit ndërgjuhësor dhe ndërkulturor¹¹. Është e qartë që përkthyesi nuk duhet të jetë medoemos edhe studiues dhe kritik letrar, mirëpo kur kemi të bëjmë me një autor që ka jetuar në një vend të sunduar nga një vizion ideologjik dhe dogmatik i artit dhe i letërsisë, kërkohet një njohje sa më e mirë e historisë politike dhe kulturore të atij vendi, si edhe njohja e stilit vetjak të autorit në fjalë. Vepra e Kadaresë, sikurse e thamë, i është nënshtruar kritikave të ashpra, shpesh është censuruar dhe ka pësuar ndërhyrje të rënda nga ana e pushtetit, është akuzuar për “ambiguitet ideologjik”, për shprehjen e një botëkuptimi të huaj, modernist dhe dekadent, për krijimin e një bote të populluar nga fantazma që nuk përkon me vizionin optimist të pretenduar nga parimet krijuese të realizmit socialist. Për një autor të tillë përkthyesi nuk mund të mjaftohet të përkthejë tekstin nga një gjuhë në tjetrën, por duhet medoemos të përkthejë edhe një kulturë historike në një tjetër. Në këtë fushë luhet ndeshja e besueshmërisë dhe e besnikërisë së një përkthimi, sidomos e përkthimeve të ardhshme të veprës së Ismail Kadaresë.

9 Përkthimi italisht i veprës poetike të Kadaresë ka një histori sa të ndryshme aq edhe të ngjashme me atë në prozë: shih Ismail Kadare, *La nuova poesia albanese*, a cura di Maurizio Caprile, edizioni Il Gabbiano, Livorno 1976. Maurizio Caprile ka përkthyer poemën *Përse mendohen këto male*: shih Ismail Kadare, *A che pensano queste montagne*, tradotto e interpretato da Maurizio Caprile, Pier Luigi Rebellato editore, Venezia 1977. Cilësi tjetër kanë botimet italisht të antologjive të përgatitura nga Joyce Lussu (*Tre poeti dell’Albania di oggi: Migjeni, Siliqi, Kadare*, Lerici Roma 1969 dhe *La poesia degli albanesi*, a cura di Joyce Lussu, ERI – edizioni rai radiotelevisione italiana, Torino 1977), dhe nga Ennio Grassi në përkthimin e Rosangela Sportelli (*Poeti della terra d’Albania*, Associazione culturale *In forma di parole* – Città di Castello, Bologna 2002), nga Nasho Jorgaqi (*Antologia della letteratura albanese*, Pellegrini editore, Cosenza 2007) dhe nga Abedin Peza (*La poesia albanese nelle pagine di un’antologia: poesie scelte e tradotte*, Ideart, Tiranë 2006). Vle të përmendet përkthimi nga Elvira Dones: Ismail Kadaré, *Le spiagge d’inverno*, Armando Dadò editore, Locarno 1996.

10 Shih Floresha Dado, *Lexuesi në kurrth: eseistika e Kadaresë*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë 2016. Për të plotësuar të dhënat kujtojmë esetë e Kadaresë të përkthyer italisht: Ismail Kadarë, *Eschilo il gran perdente*, traduzione dall’albanese di Adriana Prizreni, presentazione di Raffaele De Giorgi, Besa, Controluce, Nardò, 2008; Ismail Kadare, *Dante, l’inevitabile*, traduzione di Francesca Spinelli, Fandango libri, Roma 2008, Ismail Kadare, *Amleto, il principe scabroso*, prefazione e traduzione di Giuseppe Schirò di Maggio, Unione dei Comuni Besa, Palermo 2009. Mbi rëndësinë e eseistikës kadareane dhe mbi ndikimet që kanë ushtruar te Kadare autorë si Eskili, Dante dhe Shekspiri shih Matteo Mandalà, “Kadare e të tjerët: shembuj leximesh autoriale” parathënieën Ismail Kadare, *Tri sprova mbi letërsinë botërore (Eskil, Dante, Shekspir)*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë 2017, f. V-XV, botuar edhe italisht në *Shëjzat*, nr. 3-4 (2017), f. 33-42.

11 Shih Giuseppina Turano, “Përkthimi ndërgjuhësor dhe ai ndërkulturor. Problemi i marrëdhënies me alteritetin: rasti i romanit *Prilli i thyer* i Ismail Kadaresë” në *Shëjzat*, nr. 1-2, 2019, f. 170-182.

Sapo ka dalë në Kinë poezia e shkrimtarit tonë Visar Zhiti, një përmbledhje e gjerë, e titulluar “Duke mbledhur dritë”, botim i shtëpisë botuese kineze, “The Earth Culture Press”, 2023.

Libri është në dy gjuhë, në anglisht dhe në atë kineze, përmlledh poezi që përfshijnë tre kohë të jetës së autorit.

Poezi nga koha e parë, që u bënë shkak që Visar Zhiti në moshë të re të arrestohej me akuzën për ekuivoke dhe metafora të papranueshme për Realizmin Socialsit, trishtim dhe hermetizëm, prandaj dhe e dënuan me 10 vjet burg; koha e dytë përmbledh poezi të shkruara fshehurazi në atë burg...

Poezitë e këtyre dy kohëve janë përkthyer nga shqipja në anglisht prej albanalogut të shquar, kanadezit Robert Elsie, ndërsa nga anglishtja në gjuhën kineze i përktheu Cheng Yanjun.

Koha e tretë përmbledh disa nga krijimet e tij më të vona, të shkruara, kur vendi nuk ishte më nën diktaturë, por i hapur dhe ato janë vazhdim i lirisë së brendshme të autorit, të asaj lirie që të jep poezia.

Poezitë e kohës së tretë i përktheu nga shqipja në anglisht poetja dhe përkthyesja Ani Gjika, me banim në SHBA, ndërsa nga anglishtja në gjuhën kineze i ka përkthyer Guo Xiaolian.

Sipas poetit poezia ngjan me dritën, prandaj dhe libri ka atë titull si biblik, të mbledhësh dritë.

Permbledhja bën pjesë në “Serinë e Librit të Poetëve Botërorë” (Book Series of the World Poets), të drejtuar nga Editori Arthur Zhang dhe është pritur mjaft lart.

Në kopertinën e pasme të librit shkruhet: RRETH AUTORIT

Visar Zhiti është një nga poetët më popullorë të Shqipërisë së sotme. Lindi në Durrës, në Shqipëri, u rrit në Lushnjë, ku mbaroi shkollën në vitin 1970. Pasi kreu studimet për mësuesi në Institutin e Lartë të Shkodrës, ai nisi karrierën në profesionin e tij në Veri, në qytetin malor të Kukësit.

Zhiti tregoi që herët interes për vargjet dhe botoi disa nga poezitë e veta në periodikët kulturorë. Në 1973 ai përgatiti për botim

përmbledhjen “Rapsodia e jetës së trendafileve”, kur shpërtheu në Tiranë i ashtuquajturi “Spastrimi I liberalëve” në Plenumin e Katërt të Partisë Komuniste...

Visar Zhitit arrestohet në 8 nëntor 1979 në Kukës, kur ishte ende mësues. Dënohen me një gjyq surrogato në prill të 1980 me 13 vjet heqje lirie. Pas burgut të Tiranës, shpërngulet në kampet famëkeqe të përqendrimit në Veri, të rrethuar nga malet, të ngjashëm me Gulaget Sovjetike dhe përveç kësaj përjetoi ferrin e minierave të bakrit në Spaç dhe burgun e akullt në malet e Qafë-Barit. Visar Zhiti lirohet në 28 janar të 1987 dhe pastaj “lejohet” nga Partia të punojë në një fabrikë tullash në Lushnje, ku mbajti një profil të ulët deri në fundin e diktaturës.

Në vjeshtën e vitit 1991, kur Shqipëria ishte në gjendje kaosi, Visar Zhiti arrin të shkojë në Itali dhe punon në Milano. Ai viziton Gjermaninë për disa muaj në 1993 me një bursë të ofruar nga Fondacioni Heinrich Böll dhe shkon në Shtetet e Bashkuara në 1994. Kthehet në Shqipëri dhe punon si gazetar dhe emërohet drejtor i Shtëpisë Botuese “Naim Frashëri”.

Në 1996 Visar Zhiti zgjidhet deputet në parlament, por i tronditur nga realitetet e zymta të partive politike shqiptare, ai i largohet jetës politike. Në 1997 ai i bashkohet shërbimit të jashtëm shqiptar dhe emërohet dy herë si ministër këshilltar në ambasadën e Shqipërisë në Romë, Itali dhe në 2015 titullar i ambasadës së Shqipërisë në Selinë e Shenjtë.

PAS POEZIVE NË PASTHËNIE

Në fund të përmbledhjes “Duke mbledhur dritë në tre kohë”, botuesi bën një jetëshkrim të poetit Visar Zhiti, që kaloi “nën shpatën e Demokleut në kohën e Partisë” dhe informon për veprën e tij duke nisur me vlerësimin e lartë, të bërë nga albanologu Robert Elsie në **botimin e poezisë** së tij në SHBA.

“Visar Zhiti është një shkrimtar shqiptar, jeta dhe vepra e të cilit mbase janë pasqyra më e mirë e kombit të tij.

Ai është njëri nga ata që vuajti persekutimin e tmerrshëm pa ndonjë arsye të dukshme. Visar Zhiti mbijetoi, - fizikisht, intelektualisht dhe emocionalisht...” dhe pastaj vendosen të gjitha ato që janë të shkruara në kopertinën e pasme të librit. Dhe vazhdohet:

Librat e Visar Zhitit janë botuar dhe në vende të tjera dhe poezitë e tij janë përkthyer në shumë gjuhë si anglisht, frengjisht, gjermanisht, polonisht, holandisht, greqisht, hebraisht, flamine, arabisht, serbe, malazeze, boshnjake, kroate, kinezçe, etj.

Ai ka përkthyer në shqip lutje të Shenjtes Nënë Tereza, poezi nga Federico Garcia Lorca, Mario Luzi, Isikava Takuboku, Sebastiano Grasso, Adonis, etj.

* * *

Visar Zhiti ka marrë shumë çmime letrare në vendin e tij, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Itali, Rumania dhe gjithashtu shumë mirënjohje ndërkombëtare:

- Leopardi d’oro, Milano, 1991
- Racconta il tuo Dio, Milano, 1992
- Çmimi Kombëtar - për veprën më të mirë në poezi, Tiranë, 1994
- Velija - Çmimi mbarëkombëtar për letërsi, Tiranë, 1995
- Gaetano Salveti, Romë, 1997
- Ada Negri, Lodi Vecchio, 1998
- La cultura del mare, San Felice Circeo, 1999
- Premio alla carriera, Romë, 2000
- Naim Frashëri, Tetovë, Maqedoni, 2001
- Kalimerja, Ulqin, Mali i Zi, 2002
- Çmimi i parë i poezisë, Gjakovë, Kosovë, 2003
- Penda e argjendtë, për romanin më të mirë të vitit, 2003
- Asdreni, Korçë, 2005
- Libri më i mirë i Panairit të Shkupit, 2007
- Premio Internazionale “Mario Luzi”, Romë, 2007
- Shkrimtari i vitit, Tiranë, 2008
- Çmimi letrar “Beqir Musliu”, Gjilan, Kosovë, 2009
- Mirënjohje, Rozhajë, Mali i Zi, 2012.
- Çmimi i Madh i Letërsisë, Tiranë, 2012
- Çmimi “Kurora e poezisë”, Korçë, 2014
- Çmimi “Azem Shkreli”, Pejë, Kosovë, 2015
- Çmimi “Ali Podrimja”, Gjakovë, Kosovë, 2015
- Linguaggio dell’anima, Roma, 2016
- Çmimin e Karrierës në poezi, Como, Itali, 2019
- Çmimi “Dega e Ullirit”, Panairi i Librit në Ulqin, Mali i Zi, 2019
- Çmimi i Madh “Mihai Eminescu”, Festivali Botëror, Craiova, Rumania, 2022

Është anëtar i Akademisë Internacionale të Arteve të Bukura, të Letërsisë dhe Shkencës “Alfonso Grassi” në Itali dhe anëtar i Akademisë Europiane të Arteve, në Maqedoni e Veriut, po kështu është anëtar i PEN Klubit në Itali.

Si shkrimtar i njohur në vendin e tij ka marrë pjesë në shumë festivale botërore, në Itali, Greqi, Slloveni, Austri, Rumania, SHBA, etj.

Ai është dekoruar brenda dhe jashtë vendit, Ka titullin “Mjeshtër i Madh”, dhënë nga Presidenca e Republikës së Shqipërisë Emri i Visar Zhitit është i përfshirë në enciklopedi dhe në Fjalorë Enciklopedikë në Shqipëri, në Enciklopedinë e njohur *Piccolo Treccani* - Itali, në Mbretërinë e Bashkuar, SHBA, etj.

Tani jeton si shkrimtar i lirë.”

Libri mbyllet me shënimin:

RRETH PËRKTHYESVE

Cheng Yanjun, lindur në Zhengzhou, Provinca Henan në Kinë, ka mbaruar studimet bachelor në Arte dhe në përkthim në Universitetin Nankai, Master në shkallën e Studimeve të përkthimit në programin e Gjuhës dhe të Letërsisë Angleze në Nankai në mbikqyrjen e Profesor Zhang Zhizhong, Ai ka publikuar dy kërkime shkencore në përkthimin e poezisë në *Minority Translators Journal* dhe *Austrian Chinese Magazine*. Ka gjithashtu mbi 60 artikuj dhe poema të botuara në revistat *Rendition of International Poetry* dhe *Poetry Hall*. Ka fituar 7 çmime kombëtare në konkurset e përkthimit, etj.

Guo Xiaolian, vendase e Handanit, Provinca Hebei, me studimet pasuniversitare në Gjuhën dhe Letërsinë Angleze në Universitetin e Hobeit. Ajo ka përkthyer Përmbledhjen e Haikut Kinez të *Zhu Kunling*, gjithashtu është bashkëpërkthyesë poemash të përmbledjeve të Zhang Zhongai bashkë me poetin kinez Bei Ta dhe është autore e shumë artikujve.



A.D.: *Libri i sapobotuar në kinezisht përfshin thuajse gjithë vitet e krijimtarisë tënde. Një gjuhë aq e madhe, me të cilën na ka lidhur dikur miqësia e famshme por jetëshkurtër, miqësi mall kinez. Por më bën shumë përshtypje një fakt për të cilin e dua mendimin tënd. Si është e mundur që në këtë libër ka edhe poezi për Kosovën, për aq kohë sa Kina nuk e njeh si shtet? Ka qenë përzgjedhja jote t'i paraqiten këto poezi lexuesit kinez apo e përkthyesve?*

V.Zh.: Është një arritje e përbashkët, do të thosha, e autorit, e përkthyesve, e botuesit, duke patur si fillesë dërguesin e librit në Kinë, pra, si të thuash e korrierit poetik, që është një poet nga Kosova, Jeton Kelmendi. Të mos njohësh një shtet është tjetër gjë, punë e përkohëshme shtetesh, që nuk do të thotë se nuk e njeh atë popull, fatin e tij dhe poezinë.

Përkthyesi i parë i poezive të mia në anglisht, albanologu Robert Elsie zgjodhi dhe temën e Kosovës, dramacitetin e saj për librin tim, që botoi në SHBA, që në vitin 2005 dhe dy përkthyesit kinezë, që punuan mbi këtë libër, duke i parë si poezi të dhimbjes njerëzore të vuajtjes së një populli, nuk i kanë shmangur, po kështu dhe botuesi kinez, madje ka lënë dhe shënimet përkatëse, edhe në pasthënien pa emër, duke i bërë të qarta për lexuesin pushtimin dhe shtypjen, duke shpjeguar deri edhe burgun e poetes dhe mjekes Flora Brovina në njërin nga poezitë e mia.

Janë qendrime emocionale, ndjesi të njëjta kudo ku ka njerëz. Përdorimet politike janë të ndryshme. Shoqata e shkrimtarëve kinezë dhe shtëpia e tyre botuese, kjo që sapo nxori librin tim, është e njohur dhe universitare, me mendje të hapura dhe me politika kulturore, që Shfrytëzojnë çdo mundësi në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Edhe me poezi.

Siç duket realiteti letrar jo vetëm që është tjetër dhe më sipëran, por dhe paraprin. Gjithsesi janë akte shpirtërore, që i ngajnë mjekimeve të plagëve, ku mënjanimi nuk ka kuptim. Realitetet e tjera, të përditëshme dhe të pafundme, po veçoj nga ato të marrëdhënieve mes vendeve dhe popujve, tregtinë, udhëtimet, etj., dhe nga ato më të sofistikuarat, si diplomacia dhe politika, deri tek më e egra e saj, lufta, që është katastrofale, kalojmë te paqja, ringritjet, etj., s'bëjnë gjë tjetër, por, sado e pabesueshme të duket, ndjekin... poezinë. Kumtet e saj profetike. Frojdi thoshte diçka shumë të lartë, kudo ku kam shkuar, kam gjetur një poet para meje. Rruga e Mëndafshit, e lashtë dhe e famshme, që lidhte në krye të herës Mesdheun me Azinë Lindore, nuk shërbente vetëm për mallrat, por dhe për idetë dhe religjionet, pse jo dhe për kontrabandën e poezisë.

A.D.: *Po për poezitë e burgut që përbëjnë një pjesë të mirë të këtij botimi, ç'mendon? Kina, me disa nobelistë e shkrimtarë me famë ndërkombëtare, i mirëpret këto poezi të shkruara edhe kundër asaj fryme që u nxit prej 'Revolucionit Kulturor Kinez'?*

V.Zh.: Libri im, i sapo dalë në Kinë, është një lloj antologjie, e larmishme në tema, por mbase si qendër të rëndësës, a njërin nga ato siç janë dashuria apo kthimet, megjithëse e gjithë poezia e botës është dashuri dhe kthim tek vetja për tek tjetri, pra si tematikë në poezinë time është, po aq sa liria, e fortë dhe mungesa e saj, në rastin ekstrem burgu.

Që të shkruaja për burgun, nuk ishte zgjedhja ime ashtu siç nuk kisha zgjedhur si vend për të shkruar burgun. Është punë e të tjerëve, meritë e djallit, e atyre që më dënuan, ku të fundit ishin gjykatësit, se e para ishte ideologjia që sundonte, diktatura e saj, pastaj ishin ata që e prinin, e zbatonin dhe e mbështesnin, jo vetëm komisarët, policët dhe operativët e Sigurimit të Shtetit, në rastin tim, që më vunë prangat ndër duar, por dhe provokatorët, denoncuesit, akt-ekspertizuesit, që ishin dhe shkrimtarë, edhe poetë.

Të shkruarit në burg nuk ishte dëshira ime, por nevoja për mbijetesë, ishte formë e qendresës ndaj vuajtjeve të skajshme deri në torture dhe poshtërim të përditshëm, ishte dhe një mbrojtje e vetë poezisë për të cilën më dënuan, së pari atë dënuan, poezinë

Visar Zhiti bisedon me Andreas Dushin për librin me poezi “Duke mbledhur dritë”, botuar në Kinë

“RRUGA E MËNDAFSHIT” PËR POEZINË...



time dhe unë nuk duhej ta braktisja, siç braktisinin gruan, burrin, prindin, vëllanë, mikun, shokun, fqinjin, kur i futnin nëpër burgje.

Edhe në pasthënien e librit, “Duke mbledhur dritë”, për të cilin po flasim, shkruhet se ai: *“mbijetoi, - fizikisht, intelektualisht dhe emocionalisht...”*, pra dhe në Kinën e lashtë dhe të përvuajtur, me poetë të mëdhenj, s'kishte si të mos e pranoinin këtë emocion të shndërruar në poezi.

Mbase ngjan prapë me befasi tjetër, çudia e dytë e librit, por Kina e ka lënë shumë pas revolucionin absurd, të ashtuquajtur kulturor, antikulturor në fakt, se ishte një masakër ndaj kulturës. Kina e madhe sa një kontinent ka marrë një zhvillim të paparë ekonomik e teknologjik, me ndryshime sociale në lidhje me kapitalin, etj., duke konkuruar si superfuqi tjetër e botës, por nuk është as kompetenca ime dhe fusha ime ta shpjegoj këtë.

Çudia e vërtetë imja është që vendi im ka ende mbetje nga *Revolucioni Kulturor Kinez*, që duke e përdorur poezinë ende si fletë-rrufetë e atëhershme, me atë mllef dhe smirë, nuk pranojnë tjetër veç narcizimit të tyre dhe i hakërrohen apo duan ta harrojnë atë poezi që erdhi nga burgjet dhe internimet duke e parë jo si dëshmi dhe pasurim, por sfidë inatçore ndaj tyre, duke arritur në *kinezërrira* kësisoj, që të çmojnë më shumë poezinë që s'u bë nga ajo që u bë, fjala është për në burg, duke mos thënë asgjë kundër burgut dhe atyre që fushnin nëpër burgje. Ndërkaq deri në Kinë arrijnë vlerësimet ndaj asaj që në Shqipëri ka bashkatdhetarë që duan ta zhbëjnë.

“Çdo letërsi është një akt rezistence”, kam lexuar. Sigurisht botuesi kinez i ka lënë në libër poezitë e burgut tim dhe si një akt nderimi ndaj vuajtjes njerëzore, sakrifices supreme dhe si kujtesë për ata shkrimtarë dhe intelektualë të dënuar në Kinë.

PEN Clubi Italian, anëtar i të cilit jam, citonte një raport të PEN-it Amerikan të para 2-3 vjetëve, që 73 shkrimtarë ishin në burgjet kineze, 17 poetë, ou, Shqipëria e vogël me Enverin ia kalonte, po them disa nga emrat e cituar: Xu Lin, Wang Yi... pastor kristian..... Zhu Yufu, dënuar për një

poezi: *Kina na përket të gjithëve*, shkruante ai, është koha të zgjedhim të ardhmen... Nobelisti për Paqen Liu Xiaobo vdiq në burg para 5 vjetësh. Yang Lian, poeti modern, që pas revolucionit kulturor e kishin flakur në kampet e punës, shkruante: *Më jepni vetëm një frymëmarrje dhe unë do të hedh rrënjë...*

Në Shqipërinë tonë duket se nuk duan rrënjë të njeriut, por gjethe lavdie dafinash artificiale për ballet e ngushta...

Poezia, e kujdo goftë, është një frymëmarrje më shumë për të gjithë.

A.D.: *Visar, nuk mendoj se poezia e shkruar në burg kërkon shpjegim nga ti; përkundrazi: ajo kërkon e meriton nderim, vlerësim jo nga poetët sa nga vetë Poezia. As ata që s'shkruan në burg s'kanë pse shpjegohen, por po, ke të drejtë, më duket vërtetë abursde qasja si vlerësim për asnjë varg të shkruar për vitet e burgut, për një poezi që s'u shkrua... Por gjithsesi, duhet thënë se ky nderim, vlerësim nga vetë Poezia s'i ka munguar poezisë tënde... Nuk e di e sata gjuhë është kinezisthja si mikpritëse e saj, nga ato më pranë nesh (italisht, anglisht, frëngjisht, gjermanisht etj.), deri te ato më të largëtat (hebraisht, rusisht e tani edhe pikërisht kinezishtja). Poezi e dhembjes, e jetës dhe e forcës, shpresës se nga ferri prej padrejtësisë arrihet parajsa e së drejtës... Këto janë disa nga mendimet e lexuesve të huaj. Pra, kemi të bëjmë me një poezi, e cila, ndonëse u shkrua edhe në burg, i flet botës. Ndoshta s'është pyetje që mund t'i bëhet autorit, por gjithsesi, si e sheh këtë triumf unik?*

V.Zh.: As unë nuk e di në sa gjuhë kanë arritur të përkthehen poezitë tona të dhimbjes së madhe, të poetëve miq e shokë e bashkëvuajtës, ku janë dhe ato të miat... Vendet e tjera, botues, kritikë, lexues, aq sa arrijmë të lidhemi, na mirëpresin, është një formë e njohjes, e mbështetjes njerëzore, një qortim ndaj ndarjeve dhe kufijve, i politikave të mbrapshta dhe revanshit të tyre, me shqetësimin se mos përsëritet e keqja. Në fund të fundit në mes është poezia, që i flet botës si vetes, emocioni që përftohet prej saj, por kur ajo ka fatin të ketë ardhur nga ferri, si ajo jona, merr vlerën dhe të zogut Feniks, që në mitologjinë kineze ringjallet nga zjarri dhe hiri. Rëndësi ka përkthimi

vetëm në një gjuhë, në atë të dashurisë njerëzore.

A.D.: *Të rikthehemi sërish te botimi në fjalë i cili sikurse the, është dy gjuhësh, varianti anglisht dhe ai kinezisht. Është ky një përkujtim për përkthyesin e tyre nga shqipja, Robert Elsie si dhe një shenjë mirënjohjeje për përkthyesin e poezive të shkruara së fundmi, Ani Gjika?*

V.Zh.: Absolutisht që mbart dhe këtë nderim. Mirënjohjen natyrshëm ndaj tyre dhe unë u kujdesa që kjo të shihej, ndërsa botuesi vuri emrat e tyre në ballinën e librit, Robert Elsie dhe Ani Gjika, që përkthyen poezitë nga shqipja në anglisht, ndërsa Cheng Yanjun dhe Guo Xiaolian nga anglishtja në kinezisht.

Dr. Robert Elsie, kanadezo-gjermani, mbetet albanologu më i madh i kohës sonë, ai u shqua në njohjen e gjuhës shqipe, e lëvronte atë bukur, dinte historinë e Shqipërisë si një shkencëtar, botoi mjaft studime jashtë në gjuhën angleze, për Kanunin e Maleve, duke e përkthyer atë, për fiset, për Kosovën, para se të fillonte lufta për pavarësinë e saj, për Çamërinë, libra më vete, etj. Ai ishte studiues serioz i letrave tona dhe nxori Historinë e Letërisë Shqipe në anglisht dhe shqip, përktheu folklor, përralla shqiptare, eposin e At' Gjergj Fishtës, “Lahutën e Malcis”, autorë të tjerë në prozë dhe poezi, nga Kosova më shumë, i botoi në Mbretërinë e Bashkuar, SHBA. Ai ishte Qytetar Nderi në Kosovë dhe la si amanet që të prehej përjetë në malet e Shqipërisë, ku dhe është, pranë Kishës në Theth. Është bir shpirtëror i Shqipërisë.

Botimi im në Kinë u pasurua dhe me emocione poetike më të vona, me përkthimet në anglisht të disa poezive nga poetja dhe përkthyesja e re Ani Gjika. Ajo ka lindur në Tiranë, jeton në SHBA, është diplomuar për gjuhë dhe letërsi angleze, është specializuar në kurse, ku ka marrë mësim dhe leksione nga nobelistja amerikane, poetja Louise Glück. Ani është pedagoge e gjuhës angleze dhe letërsisë së krahasuar në shkollat e larta në Boston. Përkthen nga poezia shqipe duke bërë të njohur poetë në gjuhën angleze, ka në botim një roman, të shkruar në anglisht dhe në proces përkthimi romanin “Funerali i pafundmë”.

Përkthyesi kinez Cheng Yanjun dhe përkthyesja kineze Guo Xiaolian, janë vetë autorë, të specializuar në përkthimin e poezisë nga anglishtja në gjuhën e tyre.

Kanë mirënjohjen e thellë. Përkthyesit sakrifikojnë nga koha e tyre krijuese dhe i bën bashkautorë dashuria për fjalën dhe librin.

A.D.: *“Mbledhja e dritës”, libri që porsa doli në Kinë... vitin e shkuar u botua në Itali romani “Rrugët e ferrit”, përkthyer nga prof. Mandala... para pak kohësh në Rumanë, “Flatra e mundur” dhe “Funerali i pafundmë”, të përkthyer nga prof. Topçiu... në Serbi “Shiu i fytyrës time”, përkthyer nga Dr. Smaka. Letërsia jote mund të jetë shkruar në të shkuarën, por ka një veçanti: i flet së ardhmes! Dhe e mëson kohën si të mospërsërisë vetveten. Visar, ke frikë mos ndoshta edhe me këto dëshmi, koha prap rrezikon ta bëjë këtë, të rilindë copa-copa spazmazh nga periudha e saj më e palavdishme?*

V.Zh.: Mbase pikërisht nga ajo që kemi frikë, nga ai shkak shkruhet poezia dhe bëhet letërsi, do të thosha. Unë nuk kam frikë për çfarë shkruaj, unë kam frikë nga ajo se si shkruaj, e kam thënë. Letërsia sipas meje ka gjithmonë kohë të tashme, që është ajo e leximit dhe s'ka rëndësi se kur është shkruar dhe ku. Lavdia dhe moslavdia e periudhave, por dhe e librave, janë dukuri jashtletrare dhe unë dua të pohoj atë që ti e the aq dhimbshëm, se letërsia vërtet duhet “të rilindë copa-copa spazmazh”, duhet të ketë atë fuqi, madje edhe atë mision, të të shqetësojë, spazma nervash, qendrimesh, ëndrrash dhe dëshirash, etj., por duke qenë së pari dhe së fundmi letërsi.

Nuk kam ç'shtoj tjetër për atë që e sintetizove qartë dhe bukur, veçse duke e përgjithësuar se letërsia e mëson kohën të mos përsërisë vetveten dhe i flet së ardhmes. Kur një letërsi ia del ta bëjë këtë, ajo është me fat.

Me një përmbledhje poetike me titull të goditur, “Paradigma e Parajsës”, botim i Sh.B. Faik Konica, vjen kësaj radhe fituesi i disa çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtar, Gjekë Marinaj para lexuesve. Mirëfilli, fjala paradigmë ka kuptimin e të gjithë trajtave gramatikore që merr një pjesë e ligjeratës gjatë lakimit ose zgjedhimit, çka kujdeset ta sqarojë edhe vetë autori. Por në kapriçiot e këndshme të letërsisë në përgjithësi dhe të poezisë në veçanti, zgjedhja e saj si emër për Parajsën që krijon Dashuria me infinitshmërinë e asaj, për të cilën Johann Friedrich Schiller thosh se “... është e vetmja gjë në natyrë ku dhe fuqia e imagjinatës nuk gjen fund dhe nuk sheh kufi”, është më se e përligjur. Ashtu sikurse janë të përligjura edhe faqet ku shtrihen ato “Dy fjalë nga autori”, të cilat zakonisht shkruhen nga dikush tjetër, por që në rastin tonë edhe pse ngajnë për dikë si shprehje dashurie e besnikërie ndaj gruas së tij të mirë Dusitës dhe për dikë tjetër si deklaratë pafajsie për sa shkruan kur u drejtohet bukurive anonime, por që në të vërtetë kemi të bëjmë me një esse, nga ato mbi të kuptuarit njerëzor të filozofit empirik të Oksfordit, Xhon Lok (John Locke). Ja si shprehet nga ana e tij ky autor: “Poezia për dashurinë ka në vetvete magji të mjaftueshme poetike që kur hyn në bashkëjetesë me mendësitë tona shpirtërore, na nxit të veprojmë drejt dhe të përpigemi të gjejmë një gjuhë të përbashkët midis vetes dhe të tjerëve, midis vetë dashurisë dhe poezisë”. Poezitë këtu janë grupuar në pesë kapituj apo cikle, por që nuk ka asgjë që t’i ndajë nga njëri - tjetri. Tema është po ajo; e lumturisë së vërtetë që vjen kur dashuron, sipas Konfucit. Dhe askush nuk mund ta kundërshtojë faktin se aq e hyjnore është dashuria, sa edhe pse me përkufizimin apo shpjegimin e saj janë marrë mendjet më të ndritura, qysh nga kohë që s’mbahen mend, në mijra e mijra versione, përsëri kjo temë mbetet e paezauruar, e freskët dhe po njësoj e virgjër. Ndaj i japim të drejtë K.G. Paustovskit kur vërente që “Të mos flasim për dashurinë, se ende nuk e dimë se çfarë është ajo”. Dhe ndofta, pikërisht te kjo mosdije, pra te misteri që e mbulon atë, qëndron edhe bukuria e pazëvendësueshme e saj. Edhe poeti Gjekë Marinaj, patjetër e di fare mirë këtë sekret, por përsëri ai guxon dhe i hyn aventurës së zbulimit: duke gërmuar labirinte të reja, në artin e të pamundurës, do filtroj gjithë tingujt e mallit mbytur nëpër dete, për të qenë pranë saj, do jetë ndriçuesi në fokusin e çekiçit të Mikelanxhelos kur godet daltën, do hyj dhe do t’i shfletoj ëndrrat e tua, kur të harroni të llogarisni shumë e dashurisë time, do të bëhem simfonia që Moxarti për ty nuk e kompozoi, magjinë që ripërcakton esencën e bukurisë do pasuroj, do shtoj fjalën tonë klasipesë në fjalorin e fjalëve misterioze, do t’i ringjall shpresat e të vdekurve, madje edhe varrit të Shekspirin do ja ndryshoj emrin në Romeo e Xhuljetë. (Nga “Klasipesë”). Po kjo shejtan dashurie nuk do t’ja dijë për këto sakrifica.



Rreth librit “Paradigma e Parajsës”



Thjeshtësia dhe madhështia e figuracionit të ndjenjave në poezinë e Gjekë Marinajt

Nga Shpendi Topollaj

Çfarëdo të bësh e çfarëdo të jesh, do mbetesh rob i dashurisë, pa e ditur se ku qëndron forca e saj dhe pa mundur t’i shmangesh asaj. Dhe kjo sipas poetit, pasi “magjia femërore futi në unazë magjistarin”. Atëherë? “Dashuritë, (në mënyrë lasgushiane), i lëmë të dashurojnë”. Konti Leon Tolstoi kishte bindjen se çdo arsytim rreth saj e shkatërron dashurinë. Pra, dashuria nuk pranon arsye, por edhe e gjeneron paprerë atë. Nga ana e saj, ajo, sikurse shkruan Paulo Coelho “...është e vetmja gjë që mpreh mendjen, zgjon imagjinatën krijuese, që na pasturon dhe çliron”. Pra dashuria dhe arsyeja qenkan të pandara dhe ndikojnë reciprokisht fuqishëm te njëra - tjetra. Ndaj edhe poeti nuk zbrapset; pasi si mund të mbetesh indiferent kur sheh atë që “Venusi romak e Afërdita greke, / Ngjethen nga zilia / Këtë perëndeshë të re duke parë!” (“Ajo e bën horizontin të skuqet”). Njësoj si te Shekspiri që thosh: Po ecën qielli mbi dhe! Pastaj poetin e mundon pyetja pa përgjigje: “Pse ligjet e natyrës / Lejojnë mrekulli të tilla natyrore, / Që kanë kaq pushtet, / Në vrasjen dhe ngjalljen e ndjenjave njerëzore...” (Po

aty). Dhe në këtë luftë ndjenjash, shpesh “zhurmat e mia të brendshme / po u shpallin luftë heshtjeve të tua të jashtme”. (“Realitet virtual”). Dhe kur heshtja shkon gjatë, ai zë e shkruan, si për t’u dhënë shkrim ndjenjave: “Poezitë e mia nën lëkurën tënde vajzërore / Japin e marrin metafora melankolike” (“Në inkubatorin e Grabutës”). Ai nuk mund të mos shkruaj, pasi “Sytë e tu / I bëjnë foljet e mia të flasin me vete;... / Sforcojnë ëndrra surrealistë, / Kthehen në asonanca poetike / Brenda kllapave të himnit njerëzor (“Sytë e tu”). Për ata sy, figurat i gjen te hijeshia që merr dritë nga hëna, fytyra e vizatuar në rërë, zëri i ylbërës, buzëqeshja e ajrit, pilotimi qiejve të bukurisë, shkrirja si dy copa akulli, bërja dashuri në natyrë, natyrisht, te flokët e natës që ia fshimë gjoksit të mëngjesit, dallgët që fshehin thinjat, faqet si dy qiej të përflakur, fytyra, mirazh që ndjek i etur, gjoksi si dy kambana të arta të kthyera përmbys etj. Por tërheqja nga këta sy, dhe që ai i quan dy pranvera, është aq e madhe sa në përditshmërinë e tij, poeti nuk gjen diçka të plotë për të krahasuar, prandaj i drejtohet hapësirës, universit, diellit, planetëve, hënës, erës,

vjeshtës, dimrit, pra gjithësisë. Ja sesi e paraqet këtë gjendje ai, teksa kujton përvjetorin e martesës apo 24 Orë dashurie e më tej: I gjithë universi bëhet kor pas meje, Mërkuri u shpëput nga vendi dhe u zhyt në det, Dielli vuri duart në bel e u lartësua plot ëndje, Që asohere, gjithësia rreth nesh digjet si një vullkan, Planetët në qafën tënde ngajnë si rrufa, Buqeta yjesh të ndezur çelën në gjoksin e saj, Vështrimi i saj, hapësirën e bën të dremisë e kështu me radhë. Hermann Hesse ka shkruar diku se “Kush dashuron vërtetë, bëhet hero dhe poet për një buzëqeshje, për një fjalë, për një shenjë të njeriut që dashuron”. Dhe Gjekë Marinaj e konfirmon këtë, por me besimin se kjo u ngjet të gjithëve. Ja si thotë ai: “Kur kaloj pranë saj fshehurazi bëj kryq... / Helena dhe Çirçia janë të shkrira brenda saj... / Zotit, këtej e tutje, nuk i kërkoj parajsë tjetër” (Te “Do më falin të gjitha gjykatat e botës”). Ai edhe te “Realiteti virtual”, pra, kur ndodhet në avion duke fluturuar, atje e ka mendjen; “ndonëse gjendem kaq i shpëputur nga toka; / sa sateliti i ndjenjave të mia / s’ përcjell dot sinjale të kthjellta te bota jote, / prapë e kam të pamundur me dashurinë. / Ndoshta aq të pamundur sa ç’ e ka vetë dashuria me ty”. Nuk janë lojra fjalësh këto, por më shumë janë vetë lojrat hipnotike të dashurisë që flasin e këndojnë duke depërtuar drejt e në shpirtin e njeriut. Poeti në këto caste ka dëshirë të mbyllë sytë për të parë matanë, dhe të dehet me bukurinë e saj. Ai përjeton edhe vetë ëndrrën. I gëzohet dhe e shijon ëmbëlsisht atë. Qëndresa prej burri e ka humbur kuptimin dhe është dorëzuar bri hijes së saj (Tek “E të duhemi aty”). Për të dashuruarin nuk ka fare rëndësi distanca. Për më tepër, ajo duke e pasur prushin brenda, “Sa më larg t’i largohesh, Aq më fort të djeg...” (“Përkundrazi”). Dhe në fund e kupton se edhe fjalët e zgjedhura nuk mjaftojnë për ta përshkruar bukurinë femërore. Ndofta duhet peneli dhe fantazia e Sandro Botticellit për vajzën që del nga deti (Lindja e Venusit), ku ai vendos fytyrën e të dashurës Simonetta Vespucci, por ai ka vdekur qysh në vitin 1510, ndaj poeti kërkon një gjuhë të panjohur; detishten, por për fat të keq, përkthyesit që pritët ta dinë, heshtin. Dhe nga kjo heshtje, nga e cila nuk zbrazet i gjithë shpirti, edhe vetë poezia “Ka rënë nga pesha / Duke vrapuar / Pas nocioneve erotike” (“Ka kohë”). Se, ah! Sikur t’i dinte ajo, ato që nuk janë thënë... Poeti, vërtetë është në kërkim të nocioneve erotike, por ruhet nga rënia në emfazë, pasi ajo do të bëhej e pabesueshme dhe jo e natyrshme. Prandaj i zgjedh fjalët, se e di që ato nuk i drejtohen vetëm vajzës që e ka magjepsur, por edhe lexuesit gjakftohtë e gjykues. Atij lexuesi që dua të besoj se do ta lexojë me ëndje krijimtarinë e tij poetike, do ta vlerësojë për mençurinë e mendimit, për sinqeritetin e ndjenjave dhe do t’i gëzohet faktit se kemi të bëjmë me një poet i cili pa frikë, jo vetëm e meriton cilësimin e Isaac D’ Israelit si piktor i shpirtit, por edhe i bën nder letrave shqipe nëpër botë.



Studiuesi Zhan Starobinski thotë me Smprehtësi që “vepra e plotë e një autori mund të kundrohet, qoftë në evolucionin e vet, qoftë si peisazhi simultan... njëri ndërton një sonet si mikrokozmos autonom; për tjetrin një konstelacion romanesh mezi mjafton për të shprehur një synim krijues unik. Projekti i autorit ...brenda shkruan një botë të ngushtë a të gjerë, në brendësi të së cilës sundon një ligj homogjen...”¹.

Në romanet e Raimonda Belli Gjençajt ndihet një shqetësim për fatin e individit në përgjithësi në plan ekzistencial dhe shoqëror dhe të gruas në veçanti.

Romani i saj i katërt shënon një hap krijues, duke qenë megjithatë në vazhdimësi me tre romanet e tjerë “Epitafi i fundit”, “Butonat prej platini”, “Shtatë shpirtërat e Terezës”. Ky roman është një sagë.

Një sagë e re në letërsinë bashkëkohëse shqiptare pranë sagës së fshatarësisë të realizuar me mjeshtëri nga Jakov Xoxa; një sagë e borgjezisë, po jo e borgjezisë triumfuese, po e borgjezisë së shpronësuar e po të përdorim një term të zakonshëm në gjysëm shekullin e diktaturës komuniste, të *dekluar*, e borgjezisë shqiptare në një kohë që s’është më e saj. Është fjala për një roman social-psikologjik me shtrirje të gjerë që ndërthur tematikën sociale me tematikën ekzistenciale dhe ka titullin sugjestiv “Koha në mes”.

Nuk është një roman modernist apo pasmodernist dhe në këtë dallohet nga shumë vepra të sotme, është një roman që i rikthehet prirjes realiste, dëshmon për vitalitetin e realizmit në prozën e gjatë bashkëkohore shqiptare. Ky roman e rikthen personazhin, jo më të copëzuar si në modernizëm e pasmodernizëm, po të plotë, me thelbin e vet social dhe psikologjik, një personazh me botë shpirtërore të pasur e të ndërlikuar me të cilin lexuesi mund të identifikohet.

Ky roman spikat për thellësi tematike dhe problematike në krahasim me tri romanet e mëparshëm, ka fituar, si në thjeshtësi (nuk u drejtohet gjetjeve befusuese si “Epitafi i fundit”), ashtu edhe në përmasën e *thellësisë*; rrok disa *bresa*, pra, disa *kohë*, po edhe gërmon në fund të vetëdijes dhe nënvetëdijes së personazheve (këtë tipar të fundit e ka të përbashkët me romanin modernist), ka parasysh thelbin *social* të personazheve, po edhe përmasën *ekzistenciale*, pra, zbulon *njerëzoren* dhe të *papërsëritshmen* tek ata. Kjo vepër nuk shfrytëzon mjetet formale të veprave moderniste dhe pasmoderniste, *monologun e brendshëm*, “përroin e ndërgjegjes”, relativizimin e kronotoposit; ndjek vijimësinë kronologjike, përdor dialogët, veprimi, ligjëratën e zhdrejtë të lirë; alternon vetën e tretë me vetën e parë gjatë rrëfimit; megjithatë në një pjesë të veprës fokusohet në optikën e ndonjë personazhi, veçanërisht të Stela Floqi, një prej protagonistëve të veprës, një personazh i ndërlikuar që ndërthur origjinën borgjeze me një lloj mentaliteti komunist idealist që e bën të pësojë një zhgënjim të hidhur që përbën dramën e saj.

Në fakt, personazhet të vizatuar më me kujdes dhe më të goditur që shihen si *nga jashtë* (përmes veprimeve, dialogëve, portretit fizik), ashtu edhe nga *brenda* (përmes shënimeve, ditarit, identifikimit të rrëfimtars autore me ta), janë Stela dhe i shoqi Davidi.

Personazhi i Leonit, djali i tyre, vjen i dyti me penelatat me të cilat vizatohet, ndërsa personazhi po aq i rëndësishëm i Ninës, së shoqes së Leonit, lihet si në një gjysëm hije, ka diçka enigmatike; ndriçohet, herë pas here, papritur me disa vetëtima drite që ia zbulojnë lexuesit.

Mandej vjen personazhi i Ludovikut, përfaqësuesit të brezit të parë që spikat për aftësi në punë, mençuri, maturi, urtësi, dashuri për familjen; përqendron në vetvete vetitë më pozitive të shtresës së vet borgjeze, ato veti që borgjezia shqiptare i zotëronte në formë potenciale dhe, herë pas here, arriti të zhvillonte, po që në atmosferën e re rrezikojnë të asfiksohen dhe që personazhi arrin t’i ruajë në saje të një force shpirtërore të brendshme meqenëse tashmë ato bien në kundërshtim me luftën për mbijetesë.

1 Jean Starobianski, *Leo Spitzer et la lecture stylistique* te: Leo Spitzer, *Études de style*, Éditions Gallimard 1970.

“Koha në mes” e Raimonda Belli - Gjençajt NJË ROMAN - SAGË QË RIKTHEN REALIZMIN

Nga Prof. Dr. Klara Kodra

Ludoviku nuk jepet si një hero, po si një njeri që u mbetet besnik disa vlerave morale dhe e ruan respektin për vetveten.

Përkundrazi është kuptimplotë brishtësia e brezit të tretë, Leonit dhe Ninës që pësojnë që të dy trauma; të shtypur siç janë midis dy kohëve, kohës që nuk arritën të jetojnë dhe kohës me të cilën nuk identifikohen dot. Ata nuk identifikohen dot as me kohën kaotike, anarkike që pason shtypjen diktatoriale, bien në kompromise të cilat ndërgjegja s’ua pranon, synojnë një *katarsis* që s’e arrijnë dot. Vetëm nga fundi i romanit duket se mund të gjejnë një shteg shpëtimi përmes dashurisë *gjithënjëzore*, jo më dashurisë së dikurshme romantike-erotike që pësoi krisje tepër shpejt, po një *agape*-je që zëvendëson Erosin.

Stela, personazhi më i qartë dhe më i plotë, zbulohet në disa aspekte, si veprimtare (komandante), dashnore, nënë dhe gjyshe, nga pak si studiuese krijuese.

Aspektet e personalitetit të saj që ndriçohen më qartë janë në fillim aspektet e veprimtares që shfaq mundësitë më të mira të një gruaje të emancipuar, të aftë për luftë dhe për drejtim, gruas së dashuruar që sfidon tabutë e kohës, dallimet klasore (tashmë të përmbysura) dhe ato tabu që ia ndalonin gruas iniciativën në dashuri. Më vonë, ajo zbulohet në ato veti më ngushtësisht femërore, si nënë dhe si gjyshe, veçanërisht si gjyshe -

nënë. Dashuria e saj për bijtë dhe nipat kalon përmes një flijimi të dhimbshëm, flijimit të realizimit të vetvetes si studiuese.

Megjithatë është fjala për një dashuri, jo thjesht instiktive, as sentimentale, për një dashuri aktive që lidhet me transmetimin e disa vlerave shpirtërore.

Dashuria bashkëshortore që lidh Davidin me Stelën është një dashuri erotike që shkrin *fiziken* me *shpirtëroren*, tërheqjen e natyrshme fizike me një afrim idesh, një dashuri që kalon përmes konfliktesh dhe ngrihet më lart se ato dhe *rilind* përmes bijve dhe nipave, një dashuri që mposht dhe vdekjen. Nuk është një dashuri e idealizuar në rrafsh romantik, është një dashuri që kalon nëpër ndeshje dhe vështirësi dhe i kapërcen, madje bëhet më e fortë prej tyre.

Stela, siç thamë më lart, e flijon punën krijuese për familjen. A është ky një hap prapa i kryer prej saj? Në fillim ajo nuk kishte ngurruar të flijonte familjen e origjinës, të atin, për hir të idealeve të saj patriotike dhe sociale. Më vonë kryen një flijim të dhimbshëm për familjen e vet të re, po e bën këtë zgjedhje me dinjitet, duke ia kushtuar veten edukimit të brezave pasardhës, djalit, mbesave, nipit dhe trasmetimit të vlerave shpirtërore atyre.

Stela është një personazh kompleks dhe origjinal që i mungonte letërsisë bashkëkohore.



Te përfaqësuesit e brezit të fundit, Alina, Mirjeta dhe Kristi, vihet re çorientimi që e dallon rininë e sotme, mungesën e idealeve të qarta, megjithatë dashuria për gjyshërit, respekti për vlerat që ata u transmetojnë është një spirancë pas së cilës ata kapen. Personazhi më i ri, Kristi, është i ndarë midis mllëfit për nënën që e braktisi dhe dëshirës instiktive për ta dashur e për ta falur që më në fund triumfon.

Ky personazh ka më tepër aspirata drejt së mirës se sa veti të brumosura për t’u qëndruar vështirësive, për të realizuar vetveten dhe për të komunikuar me të tjerët. Vlerat e transmetuara nga gjyshërit dhe pjesërisht nga i jati janë farëra të mira që kanë gjetur një terren të favorshëm në shpirtin e tij në formim e sipër, po djali i ri përjeton lëkundje dhe pikëpyetje që nuk di t’i zgjidhë dhe që autorja i zbulon përmes rrëfimit në vetë të parë që e karakterizon atë (ai është i vetmi që vizatohet përmes këtij procedimi dhe kjo është kuptimplotë se ai i takon së ardhmes, perspektivës).

Rrëfimtaria është në dukje objektive dhe e paanshme, po qëndrimi i saj ideomocional është një dashuri e thellë për “fëmijët e saj prej letrë”, një identifikim me ta që arrin kulmin me krijimin e personazhit të Stelës që është, po e përsërisim, një personazh gruaje nga më tërheqëset e romaneve të viteve të fundit dhe me tërheqësja nga tërë figurat e romaneve të shkruara prej saj. Stela shkrin në vetvete më të mirën e shtresës së saj të origjinës, formimin ditor, dhe të shtresave popullore me të cilat është lidhur, energjinë, vitalitetin, iniciativën.

Në vepër ka një personazh negativ që shpreh përçudnimin e personalitetit nga diktatura. Sybi Zaimi që autorja e emërton me një aluzion ndërtekstual, “Uriah Hip”. Ai është një Uriah Hip i diktaturës komuniste me veset tipike, grabitja, spiunllëku, me vese të trashëguara nga koha e patriarkalizmit si egërsia në familje; që të tëra vishen me një maskë hipokrizie dhe mbulohen nga përkatësia formale në partinë komuniste.

Kjo është një figurë e vizatuar përmes patosit satirik që nuk analizohet nga “brenda”. Komplexiteti dallon edhe ndonjë personazh episodik si Valentina dhe Mersin Sinori; e para, më tepër e dobët se e ligë, është një vajzë koketë, së cilës i pëlqen të luajë me dashurinë, po që e lejon veten të përdoret nga i ati dhe vëllai; i dyti, ndonëse ka pranuar t’i shërbejë Sigurimit, ruan guximin dhe ndjenjat njerëzore; dashuria e tij ndaj Ninës, ndonëse fajtoje, ka diçka të çiltër. Është kuptimplotë që këto personazhe episodike, të sapovizatuara, luajnë një rol të caktuar në fatin e personazheve kryesore; kështu ndjenja prej adoleshenti e Leonit ndaj Valentinës e rrezikon seriozisht fatin e tij, ndërsa ndjenja e Ninës për Mersinin ndikon në krizën e martesës së saj, po jo edhe aq sa ta shkatërrojë.

Në roman gjejmë edhe figura personazhesh reale historike si Musine Kokalari, Vehbi Skënderi, Natasha Lako, intelektualë të ngritur dhe martirë a viktime të kohës së vet. Ato janë të porsaskicuara dhe ndodhen në sfond.

Mendojmë se autorja nuk është thelluar në vizatimin e tyre që ata të mos ua marrin dritën personazheve kryesore.

Tërë veprën e përshkon besimi te vlera të tilla si dashuria në kuptimin e gjerë dhe në kuptimin e ngushtë të fjalës, dituria, etja për liri individuale e shoqërore.

Kjo bën që, ndonëse vepra ka në bazë të vet një patos dramatik që kalon edhe në patos



tragjik, madje mund të thuhet se ky roman është një roman-tragjedi, në të mungojnë ai pesimizëm i zymtë që dallon shumë vepra bashkëkohore; në fund të tunelit të errët të përshkruar nga personazhet ka rreze drite.

Tepër kuptimplotë është ndarja në makrokapituj: *Koha e gjyshërve*, *Koha e prindërve*, *Koha e motrave*, *Koha ime* që kanë si intermexo *Kohën e ndërmjeme*, *Kohën e turbullirave*, *kohën pa kohë*.

Romani, si veprat tipike realiste, ka *prolog* dhe *epilog*.

Fabula dhe subjekti i romanit nuk dallohen nga veçori të pazakonshme, madje autorja ka ditur ta gërshetojë dramatikën me të zakonshmen. Tragjedia e Leonit dhe Ninës ka qenë ndër më të zakonshmet në diktaturë, me gjithë tiparet në thelb çnjerëzore. Subjekti ka një rrjedhë dinamike, karakterizohet nga të papritura, po nga të papritura të besueshme dhe bindëse.

Në vepër mungon rrëfimtari i gjithëdijshëm që di më shumë se personazhet: rrëfimtari (rrëfimtarja) nuk di më shumë se krijesat e veta, prandaj i zbulon ngjarjet dhe veprimet, hap pas hapi me lexuesit.

Autores i është dashur të mbraujë një lëndë shumë të gjerë, të harmonizojë fatet e personazheve me rrjedhën e kohës, pa e tepruar në përshkrime, po njëkohësisht pa rënë në fragmentarizëm, duke ruajtur ngjyrën historike dhe atmosferën.

Mund të vihet re një paralelizëm midis atmosferës kaotike të pasluftës dhe atmosferës, po ashtu kaotike të pasdiktaturës, shkëndijave të dobëta të shpresës për liri që shuhen shpejt në të dyja kohët. Hans Mangus Enzensbergeri thoshte me të drejtë se “letërsia është historiografia e vërtetë e njerëzimit dhe e vetmja së cilës populli i jep besimin e vet”.

“Koha në mes” është romani i një historie bashkëkohore, të afërt në kohë, pra, më e vështira për t’u pasqyruar.

Autorja simpatizon klasën e përmbysur për traditat e saj diturore dhe për dramën e përjetuar prej saj; po edhe protagonisten Stela që në emër të një ideali ka tradhëtuar klasën e vet dhe ka përjetuar një zhgënjim të dhimbshëm.

Autorja ndjen empati edhe për brezin e indoktrinuor që ka edhe ai dramën e vet, i përfaqësuar nga Nina, bijë komunistësh që gjendet papritur “armike e klasës”, për shkak të arratisjes së të vëllezërve.

Këtu vihet re se lufta e klasës është një përbindësh që gllabëron edhe fëmijët e vet.

Autorja përpiket që të jetë sa më e drejtë në konceptimin e historisë. Është kuptimplotë që, në një moment të caktuar Stela, ndonëse e zhgënjyer nga ideali komunist, do të tregohet e paanshme për disa vlera objektive të krijuara nga pushteti i ri si arsimi dhe mjekësia falas, lufta për emancipimin e gruas dhe përpiket t’ia thotë këtë nuses, po kjo e fundit është plagosur tepër rëndë që të jetë e paanshme dhe Stela e di këtë gjë, prandaj nuk ngulmon në pohimet e saj. Po ky është një çast në të cilin protagonistja bëhet zëdhënëse e autores, ndonëse pa thyerje karakteri.

Në roman ka një motiv që rikthehet, motivi *i luleve* që simbolizojnë bukurinë dhe jetën dhe sjellin një rrymë të nëndheshme optimizmi.

Në disa vende të romanit ka përpjekje për t’i individualizuar personazhet përmes gjuhës, nëndialekteve të ndryshëm (si, bie fjala, disa të folme të gegërishtes dhe të toskërishtes), përpjekje karakteristike për realizmin që plotësojnë portretizimin a skicimin e figurave të ndryshme.

“Koha në mes” është një nga ato romane disashtresore që mund të lexohen në disa nivele dhe nga lloje të ndryshme publiku: nga publiku i gjerë, për intrigën tërheqëse që të befason dhe të mban në ankth; nga një publik më i ngritur, për analizën e botës shpirtërore dhe realizimin psikologjik të personazheve; gjithashtu, do të thoshim, për rikthimin e statusit të *personazhit*, të mishërimit nga ana e tij, jo të njeriut “valë”, jo të një ndërgjegjeje të copëzuar, po si dikur, në romanet më të mira realiste, të “dialektikës së shpirtit njerëzor”, të një individualiteti të papërsëritshëm që mund t’i kundërvihet mjedisit e të lartësohet mbi të; nga lexuesit e nivelit edhe më të lartë, për filozofinë e historisë që shpreh dhe problemet filozofike ekzistenciale që shtrën.

Romani “Goja e Botës”, Botimet Toena, 2010

Librat e mëdhenj shpërfillin tregun e ditës

Nga Mehmet Elezi

Titulli paksa i çuditshëm, ç’është kjo “gojë bote”? Mendja të shkon fill te bota në kuptimin të tjerët, hallku. Por jo. Zija Çela është romancier i një rrafshi tjetër. Në romanin “Goja e Botës” (Botimet Toena, 2010), ka guxuar shumë.

Dhe ka mbërri çka ka guxuar.

1.

Për kah kompozimi, të kujton romanin e Orhan Pamukut “Unë jam e kuqja”.

Për kah universi që krijon, të kujton Markezin. Fifara është një lloj Makonde, me prerje të caktuar. Një botë paralele, fiction. Penelë të realizmit magjik, ngjyra të jetës së përditshme.

Ardhja e një bujtësi jo të zakonit për bibliotekat e dashnorëve të letrave ndihet qysh në faqet e para. Jeta e Fifarës shpalohej në një teatër veror, ku prej vitesh është vënë në skenë e luhet pa pushim një tragjedi e madhe, “Hamleti”. Aktorët janë shikues dhe shikuesit janë aktorë.

Metafora që lidh romanin, të rrëqeth, të shkund.

Secili duket sadopak shekspirian. Edhe kotësat nuk janë bjerraditës baresh e motelesh. Në mos tjetër, fantazitë i kanë madhështore. Janë të bindur se në Fifarë kanë ndodhur 127 ngjarje të mëdha për njerëzimin. Pohim i tepruar, por e mbrojnë duke përfshirë ngjarje që mund të kishin ndodhur. “Nëse NASA do të ishte në Fifarë, a nuk do të ngriheshin anijet kozmike nga trojet tona?”.

Asnjëri nuk ëndërron pare të madhe, pushtet aq më pak. “To be or not to be sot është baras me Time is Money”, thotë dikush, por ky zë mbetet në surdinë. Endërronjë vetëm skenën. Bëjnë prova fshehtas para pasqyrës, me luejtë një ditë Princin. Në rrugë përshëndeten me gjuhën e Globusit. “Mirëmbërma Imzot. Ç’të reja kemi nga Elsinori?”. “Mirëmbetsh Imzot, tani më duhet t’ju lë shëndenë, kam një pikëpjekje me mbretin, se këtë muaj ma ka rrasur keq me faturat e mishit”. Me 4680 banorë Fifara ka 989 Hamletë. Tragjikë apo komikë?

Ndiejnë se potencialisht janë në lartësitë e Botës. Kanë ide, energji. Një mallkim i kushedikurshëm (shalli i Eridrivës - kjo botë është edhe fat!) ka lëshuar ndërmjet tyre dhe botës tjetër malin e pakalueshëm, ata kanë mbetur në hijetinë, të shmanjur. Gjilpëra e fushës së tyre magnetike dridhet në një kah: bota e matanshme, Fifara 2. Vetëdija dhe nënvetëdija rrahin për andej. Me gojën e botës, me veshin e botës, me zhbirime të paqarta tunelesh.

Gjithçka të botës së madhe e ndërtojnë virtualisht në qytetin e tyre sa grima. Kënaqen duke kujtuar se “Yllin polar s’e ka Arusha e Madhe, e ka Arusha e Vogël. Kështu mund të ndodhë edhe me Fifarën e vogël”.

Përplasja ndërmjet thirrjes së brendshme deri në ulurimë me mbërri Botën dhe pamundësisë për shkak të ndarjes, i bën groteskë. Një ironi e butë, dashamirëse ndihet si shije erze përgjatë romanit (a nuk thotë Konica? “Ironia, kjo bimë me aromë të këndshme e të lehtë”). “Qëndrova tri ditë me ta, m’u bënë dyzet e shtatë pyetje për Uollt Uitmanin dhe njëzet e gjashtë për librat e mi, madje mua më pyetën nëse shkruaja përralla, por kurrkush

nuk më pyeti nëse jam apo s’jam i martuar, kam apo s’kam fëmijë, ku punoj dhe sa paguhem”. Kështu i thotë së shoqes një poet amerikan, sapo kthehet në Nju Jork.

Veçimi ua ka brejtur karakterin në brendësi. Madhështhinë që ngin ajrin e ushqen e kundërta e saj, dobësia. Komplexet e fshehta i bëjnë të varur prej një Hamleti të rremë, tek i cili shohin sharm metropoli. E shndërrojnë në idhull, ani pse s’është aq i fismë. Me sjelljen cipëplatur e cinik si Votren, me “tiraninë” e njeriut publik, i poshtëron. Ata vazhdojnë me e dashtë me një mazohizëm heroik.

Romani nuk e vret shijen e të jetuarit, la joie de vivre. Banorët e Fifarës gjejnë gjithnjë motiv me e gëzue jetën. Tekefundit “janë mësuar të kënaqen me merita që vetë ia njohin vetes”.

Tipikë shqiptarë, do të thotë dikush. Ballkanas, mund të ngulë këmbë tjetri, duke huazuar këtë cilësor nga fjalori i modës politike.

Janë thjesht fifaras. Dhe Fifara mund të gjindet ose mund të zhvendoset edhe në gjysmën tjetër të rruzullit. Mali i saj rrotullohet. Mund të ngulet e të peshojë kudo me hijen frymëzënëse. Kreshta (e malit ndarës) është në kurriz, thotë dikush. I ktheve shpinën dikujt, mali i pakalueshëm u ngrit.

Bota e “Gojës...” është shqiptare sa edhe gjithnjëzore.

2.

“Goja e Botës” nuk është galeri që mund të vizitohet si turist.

Romani ka dendësi të frikshme. Mund të lexohet veçse ngadalë, duke u përqëndruar dhe duke pushuar. Në të mungojnë pikat e vdekura, kur bateritë e krijuesit crijatin, lypin me u ngarkue. Mungojnë faqet e venitura dhe paragrafët e sforcuar, s’ka terina a gropa nëpër të. Me një frymëzim dhe energji krijuese të pazakontë, në të 434 faqet autori ruan të njëjtin ritm të lartë kallëzimi - ose, siç quhet, narrative - të kontrolluar mjeshtërisht. I ngjeshur në mendim, në kulturë, në gjuhë. “Analfabetizmi më i rrezikshëm është ai i të shkolluarve. Këtu injoranca kthehet në institucion, një institucion më i mbrojtur se i dijes, sepse ai mbrohet me diploma dhe tituj të pamerituar”. “Tri gjëra mbaji mend prej meje, profecitë e tepërta, katarsisi i tepruar dhe lavdia me tepricë mund ta mbysin njeriun”. “Çdo ditë plagos, por njëra të vret”. Sentencat e shumta e bëjnë më të thekshme përmasën filozofike të veprës. Nëse do t’u binte në mend, hulumtuesit e fjalëve të urta do të gjenin punë te “Goja e Botës”.

Fjalor i buruar, fjalë të rralla shqip (me u letue në mend, mëlmesë, bythambrapsht...). Aty-këtu trajta gramatikore të gegnishtes, të punësuar “në të zezë”, se janë “të palegalizuara”. Mjaftojnë dy tri fjali për me kuptue sa e pazëvendësueshme është për gjuhën shqipe mënyra paskajore e foljes. “Ah, sa mirë dinë të qajnë njerëzit që dinë me dashtë!”. Mënyra përcjellore me pjesëzën kah, me përhapje të gjerë në gegnisht, shërben, ndër të tjera, si kohë e tashme dhe si kohë e ardhme. “Zot, rri me ne se është kah erret”. “Inventari i emrave” të 160 personazheve është krejt shqiptar. Jo për kah lënda gjuhësore e ngjizjes, por sepse janë copëza të natyrshme realiteti.



3.

Duke bërë dallimin midis burrit të shtetit dhe politikanit, Çerçilli pati thënë se burri i shtetit mendon për të ardhmen, ndërsa politikanin mendon për zgjedhjet e ardhshme.

Librat e mëdhenj janë burrështetas të artit. Shpërfillin tregun e ditës, nuk kuptojnë konjunkturën e kompromiseve me shikuesit e palodhur të telenovelave.

Edhe për Zija Çelën kjo ka një çmim.

Është çmimi i të qenit elitë, për elitën.



1.

Në një bisedë me poetin dhe studiuesin Sadik Bejko rreth *Antologjisë së Poezisë Moderne Shqipe*, me të cilën sapo kisha filluar të merresha, ai më sugjeroi që të mos harroja poezinë e Asdrenit *Mërzi Vjeshte*. Është një poezi aq e bukur, më paralajmëroi ai, jo krejtësisht me të qeshur, sa e pat kritikuar dhe Koço Bihiku, shefi i dikurshëm i kritikës së soc-realizmit tonë. Asdreni është një poet që, si shumë poetë të kësaj Bote, ka një lidhje intime dhe shpirtërore me stinën e Vjeshtës. Ka tre-katër poezi që ia kushton kësaj Stine, e cila në anglishten e amerikanëve thërretet Fall, rënje, rënia e gjetheve, rënia e gjëndjes shpirtërore, rënia e gëzimit të Veres që sapo shkoj. Thashë se Mërzi Vjeshte mund të jetë ndonjëra nga këto poezi të lexuara herët, të cilat i kujtoja se i kisha lexuar shumë vite më parë, dhe që nuk më kishin lënë ndonjë përshtypje të veçantë. I rilexova edhe një herë të gjitha poezitë për Vjeshtën, të shkruara nga Asdreni. Nuk bindesha se poezia për të cilën më kishte folur Bejko ishte njëra prej tyre. I shkrojtja edhe njëherë mikut tim, i cili më tha se dhe ai vetë e kishte me të dëgjuar se Asdreni kishte një poezi shumë të bukur, tronditëse bodleriane, me këtë titull, por ai vetë nuk kishte arritur ta gjente gjëkund që ta lexonte.

Bleva të gjitha vëllimet poetike të Asdrenit, që munda të gjejë, nëpër Librari dhe tek shitësit ambulantë të rrugëve. Asnjëra prej tyre nuk e kishte poezinë me titull *Mërzi Vjeshte*.

Historia e poezisë së Asdrenit pak nga pak po merrte natyrën e një triller të romaneve të Agatha Christ-it dhe të Arthur Conan Doyle! Në Biblioteken Kombëtare porosita të gjithë përmbledhjet poetike të botuara në Tiranë dhe në Prishtinë. Qenë ndoca mbi tridhjetë a dyzet botime, nëpër vite, por në asnjëra prej tyre nuk gjëndeja një poezi me titull *Mërzi Vjeshte*. U kujtova për Biblioteken e Françeskanëve të Shkodrës. Dija se Asdreni, së bashku me Lasgush Poradecin, në Shkurtin e vitit 1938, u patën ftuar në Shkodër, nga At Gjergj Fishta dhe Ernest Koliqiviziti e përjetësuar në një fotografi brilante të Marubit. M'u kujtua se Asdreni i pat dhuruar bibliotekës Françeskane të Shkodrës tre vëllimet e veta poetike "Rreze dielli"- botim i vitit 1904, Bukuresht, "Ëndrra dhe lotë"- Bukuresht, në 1912 si dhe librin poetik "Psalmë Murgu", po në kryeqytetin rumun, në vitin 1930. Mërzi Vjeshte duhej të qe botuar në librin "Psalmë Murgu"- njëri nga dy a tre librat më të mirë dhe më të rëndësishëm poetikë të letërsisë Shqipe, i konsideruar që herët nga Eq'rem Çabej si libri i parë që shënon hyrjen e frymës moderniste në gjithë letërsinë Shqipe (një parantezë-kjo konsideratë e Eq'rem Çabej shpesh herë, prej studjuesve retard të letërsisë tonë, kam parë në dy vende t'i atribohet gabimisht amatorit dashamirës Robert Elsie-t!!!). Gjithashtu, i kujdes-shmi Çabej vë re se nuk është Migjeni ai që shkruan për herë të parë në poezinë Shqipe me varg të lirë, siç thuhet në një korale tipike të studjuesve tanë, por është Asdreni. Provë e kësaj është, krahas shumë provave të tjera, dhe

HISTORIA E NJË POEZIE QË U DËNUA ME VDEKJE

Nga Rudolf Marku



poezia *Mërzi Vjeshte*. Dhe do mjaftonte kjo konsideratë e lartë e Çabejt, se Asdreni është i pari modernist i letërsisë Shqipe, që ai të shihej me dyshim prej studjuesve të vigjilencës së pastertisë ideologjike.

I telefonova një mikut tim, professor në Universitetin e Shkodrës, të ma siguronte kopjen e *Psalmë Murgu* - që ta lexoja në Biblioteken Françeskane. Shkova atje dhe më së fundi enigma e poezisë së shumë kërkuar u zgjidh: *Mërzi Vjeshte* qe botuar vertetë, siç e mora me mend, në librin *Psalmë Murgu*.

2.

Është e tepert të them se poezia e Asdreni e sipërpërmendur është njëra ndër poezitë më të tronditëse të poezisë shqipe, dhe njëra ndër poezitë e para ekzistencialiste dhe simboliste, poezi e kerkimeve formale dhe e përsosmërisë së formës, më e afërm ndoshta nga çdo poezi tjetër Shqipe,

me poezinë më të mirë Europiane dhe atë botërore. Por po aq tronditëse është dhe fati i saj. I botuar vetëm një herë, në librin *Psalmë Murgu*- ajo u bë object qitjeje e shefit Zhdanovist të kritikës letrare. Ndonëse poezi e krijuesit të Hymnit të Flamurit, poezia e një patrioti të madh, kjo poezi e kritikuar njëherë, nuk pa asnjëherë tjetër një ribotim të dytë (gazeta ExLibris ka nderin ta botojë sot për herë të dytë, pas botimit në librin e Asdrenit në 1930, këtë poezi në këtë numër!).

Paradoksi më i madh është se Asdreni, ndryshe nga Fishta, apo Koliqi, Haxhiademi a ndonjë tjetër, nuk qe i përfshirë tek autorët e ndaluar për shkaqe ideologjike. E megjithatë poezia e tij Mërzi Vjeshte nuk u botua kurrë, edhe pse antologjitë e poezisë Shqipe e përfshinin Asdrenit si njërin ndër poetët e njohur shqiptar. Cilat ishin arsyt e kësaj ndalese kokëforte?

Mendoj se kritikët letrarë dhe studjuesit e letërsisë tek ne lavdëronin në rrjesht dhe shanin në rrjesht- në

një rrjesht të disiplinës dhe atrofizimit mendor dhe estetik militarist- një zakon dhe mentalitet që shumica e kritikëve e kanë të trashëguar sot e kësaj dite. Mjafton që poezia e Asdrenit të shahet njëherë nga Shefi i kritikës, a nga dikush tjetër, pas kuintave, mjaftonte që ajo të konsiderohej e vrarë, e asgjësuar, mos-ekzistente nga një studjues me autoritet zyrtar si një poezi e dyshimtë dekadente, dhe që nuk i bën nder emrit të Adrenit, dhe menjëherë pas këtij verdikti *death penalty*, asnjë studjues tjetër shqiptar, duke përfshirë dhe një asdrenolog si Qosja përtej kufirit shtetëror me gjemba të Tiranës zyrtare, nuk pat guxuar t'i afrohet kësaj poezie të prekur nga leproza e dënimit ideologjik!

Por krahas këtij dënimi tipologjik bihikian, kemi vlerësimin teorik të Çabejt.

Çabej, ndonëse krijon kurorën teorike të romantizmit, nuk mbetet këtu, me që tek ai nuk ka pushuar dëshira kërkimtare për të krijuar, një skicë të historisë së letërsisë shqipe. Dhe përpara i shfaqet i zbuluar "Asdreni që formon kalimin nga brezi i kaluar në poezinë moderne shqiptare. Brezi i kaluar, për Çabejn, janë: Jeronim de Rada e Naim Frashëri e brezi i ardhshëm është poezia moderne shqiptare. Asdreni është kalimi. Pra, cili është ky kalim si inicim e si rezultat? Çabej saktëson që ky kalim ka tendencën që poezia të shngarkohet nga detyrimet nacionale për t'u bërë më tepër vepër arti. Çabej këtë përpiket ta dëshmojë nëpërmjet karakterizimit të poezisë së Asdrenit që shkon kah përsosmëria formale. Përshkruhen veprat lirike të Asdrenit: Rreze djelli, Ëndrra e lotë e Psalmë murgu, që kanë strukturë formale poetike, për të perfunduar, për autorin, se "ay është mjeshtëri i formës". Por ky vlerësim i Çabejt duket se vetëm i ka prishur punë Asdrenit, duke i ngatërruar dhe xhelozuar keqas kritikët skematikë.

Duke lexuar Antologjitë poetike para-rendëse, që mbajnë si emëra hartuesish ca emëra akademikësh të sterilizuar, gjëndesh përpara një fenomeni shumë interesant : 30 e më shumë hartues Antologjish jo vetëm që zgjedhin të njëjtit autorë, por dhe të njëjtat poezi të këtyre autorëve. Si ka mundësi që tridhjetë Hartues të ndryshëm Antologjish pelqejnë të gjithë, në kor, të njëjtat poezi të 80 autorëve të ndryshëm, kur krijimtaria e këtyre autorëve mund të numërojë mbi



300 poezi të ndryshme seicili perj tyre? Po të shohësh me kujdes Antologjitë e botuara gjatë dekadave, e që nuk janë të pakta, ajo që bie në sy është se krijimtaria e zgjedhur prej autorëve është pothuajse e njënjta nga Antologjia në Antologji, edhe pse hartuesit e tyre janë të ndryshëm. Ky lloj uniformiteti në shije tregon se studjuesit tanë vazhdojnë të qëndrojnë në rrjesht, duke respektuar vijat e bardha të vendosura nga baballarët e tyre Bihikianë!

Kriteri më i injoruar dhe më i harruar nga hartuesit e mëparshëm të Antologjive tek ne- është shija estetike e atij që zgjedh nga krijimtaria e autorëve. Një studjuesve e letersisë, shijet poetike të së cilës nuk mund ta shkapërcejnë lavdërimin e poezisë së Çajupit (deri këtu nuk ka asgjë të keqe, që të pëlqesh Çajupin), nuk mund ta gjykojë poezinë Mërzi Vjeshte, e aq më tepër poezinë bashkëkohore.Por kjo studjuesve e tipit *Koço Bihik me fustan* jo vetëm që vazhdon ta gjykojë letersisë Shqipe bashkëkohore, por shpesh herë ndodhet në krye të Jurive që gjykojnë veprat bashkëkohore të letersisë duke shpallur dhe vendosur, në emërin e Ministrisë së Kulturës, hierarkinë e veprave të letersisë!

3.

Poezinë *Mërzi Vjeshte* po e botoj këtu, që lexuesit t'i gjykojnë vetë vlerat e saj. Ajo që më bëri përshtypje në këtë poezi, krahas atyre vlerësimeve të bëra më parë, duke cituar të diturin Eqrem Çabej,këtë studjues të pashkapërçyer të letersisë deri më sot, është dhe ndikimi i dukshëm i kësaj poezie te krijimtaria poetike e një mjeshtri të rrallë të lirikës Shqipe, Lasgushit.

Krahas botimit të poezisë, po publikoj edhe njëherë fotografinë e Marubit, të shkurtit të vitit 1938, Shkodër, për t'ua kujtuar lexuesve se të mëdhenjt janë përherë bashkë dhe jo gjykues, ndërsa mediokrtit janë gjyqtarë, duke vënë të gjitha energjitë e tyre në shërbim të ndarjeve!

Po japim një fragment të poezisë. Variantin e plotë do ta gjeni në *Antologjia Moderne e Poezisë Shqipe*, e cila do të dalë nga shtypi në fillimin e Marsit që vjen.

MËRZI VJESHTE...

U-mverth pylli, u-shkretua
Mvarren fletët vëthesh vargje,
Shelgjet derdhin lotesh krua
Degët epur argje, argje.
Tek liqení lahet djelli
Thyer copra nga shtërgata ;
Zallit plepat, sheh, tek qielli
Majat ngulur sí ca shpata.
Gjurmë shtërgu s'ka më sipër...
Zi mban kopshti, treten hijet
Mi stolit'e fushës, sipër
Vdekje bryma natën shtrihet.
Me plot turpit virgjëreshe
Rësh del hëna vajzë-mplakur,
Pa pik zjar si máll murgeshe
Buzë-thart'e sy-përgjakur.
Era fryn me vërshtëllime
Fletët ashpër poshtë ndiqen,
Zë muzike plot kuptime:

Sa që shduken prap më s'piqen.
Pellgjet uji prej thëllimit...

BUFI DHE HEROI
Dy tregime nga Antonio Çikollari



BUFI

Quhem Buf. Nuk e di sa vjeç jam, por di që gishtat e mi mund t'i përballojnë. Më kanë thënë që emrin ma kanë vendosur për shkak të një domethënieje të veçantë. Vendi ku jetoj është shumë i madh, thuajse gjigant. Përfshin një dhomë e kuzhinë, një banjë pa dush dhe një korridor sa hapja e krahëve të mi. Mund të vërtitem aq shumë sa nuk më del dita ta përshkoj gjithë ambientin.

Mahnitem sa bukur është këtu. Më kanë plotësuar të gjitha kushtet. Kam një tavolinë katrore ku mund të vendos një pjatë, lugën dhe gotën. Bukën e mbaj në dorë. Ndërsa karrigia nuk më nxë të tërin, por unë ndihem mjaft rahat. Ndonjëherë më mpihen të ndenjurat, por ka edhe më keq. Muret janë ngjyrë gri, por të gjithë më thonë që janë të kuq dhe jeshil. Nuk e kuptoj pse tallen me mua. Dyshemeja është bezhë, jo me pllaka qeramike. Një ditë u tregova kurioz dhe thashë ta vërtetoja ç'material ishte. Prej andej u shkapëput një copë plastmas që ngjitej. Po si ka mundësi që çdo gjë është gri?!

Gjithçka ndryshon në dhomë. Aty kam parë të verdhën, të bardhën, lejlanë. Ka shumë ngjyra. Kjo gjë vërtet më gëzon. Duket si një fushë e madhe, pavarësisht se aty gjendet vetëm një shtrat ngjitur me tavanin e katit të mëposhtëm. Unë kam frikë nga lartësitë. As në dritare nuk shoh. Kam frikë që atë natë kur në ëndërr pashë të më hidhnin nga maja e një mali. Ndoshta ka qenë dhe mur, ose ndërtesë, por pak rëndësi ka, unë rashë. Dhe po të mos isha zgjuar, nuk do të isha këtu duke folur.

Më i bukuri është korridori. I gjithi i bardhë. Por unë e vizatova. E mbusha me ngjyra dhe me të vetmen të bardhë që ngeli, bëra retë. Tashmë duket vërtet si një horizont i pakufi. Bëra disa burra që punojnë, disa gra që endin e disa vajza që sa herë më shohin skuqen e qeshin të turpëruara. Mua më pëlqen shumë t'i ngacmoj me fjalë xhentilese. Sidomos në mëngjes. Madje njërës prej tyre, asaj që më ngjeth mishin, i bëj çdo agim të njëjtën pyetje, pavarësisht përgjigjes që e di.

Babai i saj nuk më ndalon, përkundrazi, më fton të bashkohem e të punoj me ta. Të vjel pemët e zymta me fruta të shijshme. Më fton të provoj mollët, portokajtë, fiqtë. Një ditë, kur po bisedonim, më tha: “Bir, tek ne nuk ka rëndësi stina; nëse mbjell pemë, ajo do të çelë pa një, pa dy!”. Ditët kalojnë. Vajza nuk rritet, ndërsa unë jam zgjatur një gisht. Nuk e di nëse një gisht horizontalisht apo vertikalisht. Nuk e kuptoj përse çdo gjë rreth

meje mbetet e njëjtë. Pemët nuk fishken, gjethet gri nuk bien, dimri nuk vjen, por as vera nuk ikën.

Vajza u zbeh një ditë. Më duket se ndihej keq. Mbase gripi. Dhe unë u sëmura një ditë me grip dhe u zverdha u bëra dyllë. Epo nuk e di se ç'është dylli, por u sëmura. U përpoqa ta shëroja, por nuk dija si. I dhashë fruta, çajra, por asgjë. E në fund e gjeta. E ringjyrova. Jo vetëm atë, por gjithçka. Fajësova të atin për sëmundjen e saj dhe menjëherë ndërtova një shtëpi të madhe në murin e dhomës. Asgjë nuk më pëlqeu. Shumë zymtë aty. Muri ishte kaq i errët. Dukej sikur jetonim pa diell. Por unë e vizatova një të tillë e përsëri asgjë. Vendosa të ndërtoja një shtëpi tjetër në murin ngjitur. Ai ishte si i verdhë dhe me harta-harta. Jam i bindur që jo prej lagështirës. Po ta prekje, ishte si i njomë dhe nëse e fshije nga sipër, provokoje flokë bore. Më shumë më ngjanin si petale të një peme pranverore. Nuk më kujtohet emri.

Shtëpia doli mrekulli. Vajzës i pëlqente të qëndronte në ballkon. Era i ledhatonte flokët e verdhë. Tundej lehtë në karrigen e saj. E më pas errësohej. Tërhoqa krevatin pranë shtëpisë dhe fjetëm të dy duke parë në sy njëri-tjetrin.

Në mëngjes më zgjoi sanitari. Pastroi dyshtet dhe më pyeti nëse dëshiroja të pastronte muret. Sigurisht që jo! A mund të fshihet një botë si të mos ketë qenë në të shkuarën?! Janë të çmendur ata që do të mendonin kështu. Më pas më sollën për të ngrënë, e më pas më dhanë të pija disa kokrra të bardha të madhësive të ndryshme. Sigurisht që nuk i piva. Kur pyeta dikë nga të shumtët se përse ishin këto, mu përgjigj se ishin për të më shëruar. Por unë nuk jam sëmurë. Gomerët! As kaq pako gjë nuk dallojnë. Unë as nuk kam temperaturë e as ndihem keq. Kështu mendon dhe vajza. Për pak harrova. Vajzës i vura një emër sot. Një emër të bukur, si i imi. Emri i saj prej këtej e tutje është Bufe. Ajo u mrekullua kur e dëgjoi. Askush nuk i kish thirrur me emër të përveçëm deri më sot.

Ato ditë ishin ditët më të bukura. Më pas gjithçka filloi të prishej. Vajza nisi të sëmurej përsëri. Nuk po më sillnin më ilaçe ngjyuese. Bashkë me të më zuri dhe mua pikëllimi. Po ndihesha më keq se ajo. Ata zbuluan që nuk po pija as ilaçet e as po ushqehesha. Filluan të më shponin me gjëra të holla. Plagët më digjinin. Nuk lëvizja dot. Ngjarjet morën për ters në çastin kur më larguan prej Bufes të sëmurë. Ajo po lëngonte në karrigen që tundej. Iu luta burrit me të bardha të më lejonte të qëndroja pranë saj. Qeshi dhe më shtyu

tutje. U inatosa dhe shtyva. Më gjuajti me pëllëmbë dhe më plasi në murin përballë. Erdhi dhe një tjetër. U bënë dy. Dikush më shpoi. Më rrethuan pa më prekur. Papritur po gogësjia. Sytë po më mbylleshin. Kaq mbaj mend.

Burrat u zhdukën. Gjithçka u zhduk dhe papritur u gjenda tek muri, brenda tij. Nisa të ndjeja erën që frynte. Po shihja vajzën, Bufen time, që vraponte drejt meje. Më përqafoi fort e nisi të më puthte. Shtëpia ishte po ajo, veçse shumë më e madhe. Pemët kishin çelur dhe lulet e bardha binin pa i ngacmuar. Domethënë kjo duhet të ishte ajo lumturia për të cilën flisnin të gjithë. Ajo më gatoi, më ushqeu, më shëtit, më përqafoi, më puthi. Pamë bashkë ikjen e diellit, ardhjen e hënës. Shijua çaste që as i kisha menduar. E më pas më zuri gjumi në krahët e saj.

Errësirë. Nisa të dëgjoja disa zëra. Po shqiptonin fjalë që nuk i kisha dëgjuar më parë. Më pas po flisnin për ilaçet dhe kurat. E më pas për vdekjen. Në fund u tremba. Dëgjova emrin tim. Ç'lidhje kishte kjo? Përse po flisnin për mua? Zërat heshtën. Dera kërciti. Ata ishin larguar. Hapa sytë dhe bëra të çohem. Më kishin lidhur. U rrotullova në të majtë. Të ndenjurat më dogjën. Në kaq pak kohë isha shpuar sa vitet e moshës sime. Krevati gjendej larg vajzës. Më kishin zhvendosur. Gomerët! Tentova të liroj veten. Bufja ishte si mos më keq. Ajo qante prej sëmundjes e unë prej inatit. Sanitari po fshinte muret në korridor. I thirra, i bërtita, e shava, por nuk ndaloi. Kisha frikë për të. Nuk doja të zhdukej.

Përsëri gjumë. Gjithçka përjetova me vajzën time në botën e vërtetë, e rishijova. Këtë herë zgjati më shumë, por ndryshe prej së djeshmes, ajo u largua. Errësirë. Dëgjova një fërshëllimë prej dikujt. Hapa sytë dhe isha përmbys me fytyrë nga muri. Sigurisht që isha i lidhur. U përpoqa të kthehem nga vajza. Të pasmet më dogjën prapë. Këtë herë më shumë. Hedh sytë drejt saj dhe shoh një të panjohur që po ngjyroste murin me të bardhë. I thirra, por nuk më dëgjoi. I thashë të ndalonte. Muri tashmë ishte lyer. Bufja ishte zhdukur. Bashkë me të dhe shtëpia, oborri, gjithçka. Nisa të qaj nga inati. U ktheva përsëri përmbys dhe më pushtoi ngashërimi. Po më merrej fryma.

Më kishte zënë gjumi. Shihja vetëm atë të panjohur që lyente. Bufja ishte zhdukur. Nuk mu shfaq për ditë të tëra. Nisa t'i harroja dhe fytyrën. Nuk mund të bëja asgjë. Tashmë s'isha asgjë më shumë sesa një Buf i lidhur me të pasmet që i digjinin nga të shpuarat.

HEROI

Princi A., i fundit i emrit të tij, vdiq në luftë. Trupi i kthehet të afërmve krejt i padëmtuar. Në të nuk shihje asnjë plagë, asnjë vragë të mëparshme. Askush nuk pyeti si u vra, kush e vrau, apo nëse e vranë.

Nderimet ishin të mëdha. Ceremonia mortore qe e madhërishtme. Populli u mblodh në shenjë nderimi. Mes tyre ai shitej si hero, si fitues i luftës (anipse lufta ende s'kishte përfunduar). Rrëfenin se ishte bërë shoshë me plumba, disa kundërshtonin dhe e bënin vdekjen ende më tragjike. Sipas tyre plumbat s'mund ta kapnin dhe gjatë depërtimit në llogoret e kundërshtarëve, ushtarët e palës tjetër e kishin bërë shoshë me anë të bajonetave, thikave, etj. Disa të tjerë thoshin se vdiq duke shpëtuar trupat e tij luftarakë. Ndërsa këta të fundit thoshin se nuk dinin gjë prej gjëje.

Në të vërtetë ai vdiq i fshehur në llogoren aleate, pushtuar prej frikës së krismave, prej frikës së përdhosjes së imazhit se përpos fshehjes, ai edhe ishte lagur. Sigurisht që kishte frikë të vdiste, por familja duhet të ruante emrin e mirë. Rëndësi ka fundi. Ai përsëri u shit si hero. E askush kurrë nuk pyeti si u vra, kush e vrau, apo nëse e vranë.

Duke qenë se dashuria dhe fëmijëria janë dy prej realiteteve më të rëndësishme letrare të krijuesve, dy prej mundësive më fatlume që një krijues shtin në dorë për të bërë letërsi, unë po ndalem në atmosferën që krijojnë këto dy gjendje.

Shumë më përpara se të mësoja për kalin e Trojës, mllefin dhe tërbimin e Menelaut për tradhëtinë e Helenës, dhe para se të merrja vesh se “për një puthje u shemb Troja”, e kam kuptuar dhe ndjerë pothuaj porsi trojanët dhe akejtë se ç’ndodh nga një puthje e fshehtë për dikënd që nuk është e vendit tënd.

Kam qenë rreth 8 vjeç, kur një djalë i pallatit tonë puthi një vajzë të një lagjeje tjetër. Dhe sedra prej djemësh gangstera, inati dhe mllefi i tërë mëhallave të tjera, u turr e ra si një mallkim mbi të gjithë fëmijët e godinës sonë. Për shumë e shumë kohë, djemtë dhe camërdhokët e qytetit, si shpagim rrihnin e godisnin ku të zinin, fëmijë nga pallati ynë. Madje për vite e vite me radhë, deri sa unë jam rritur e kam ikur prej atje, të gjithë ne, që patëm dalë nga ai pallat quheshim “rrugaçët e katërkatëshit”, kishim apo s’kishim lidhje me puthjen. (“Katërkatëshi” quhej pallati, mbasi qe ndërtesa më e lartë e qytetit). Çdo gjë lidhej me atë natë kur kishte ndodhur puthja e fshehtë. Megjithëse unë kisha qenë fare i vogël kur pati ndodhur ai akt, nuk kisha lidhje me puthjen dhe qesh fëmijë i urtë, (që merreshe me libra dhe pulla poste), dhe për më tepër nuk qesh aspak “rrugaç”, përsëri seç kisha një dëshirë të fshehtë, një turbullim të lehtë, dhe më dukej vetja disi më krenar kur, dhe unë isha pjesë e “atyre rrugaçëve”. Mbasi e mendoja veten edhe unë të përfshirë në fshehtësinë e asaj nate, sikur pata ndihmuar në komplotin e puthjes, madje e dëshiroja vetën të isha në qendrën e asaj historie me zullume, zarare, shamatë e sherre. Se ç’kisha një krenari prej fëmije, se qemë pikërisht ne ata që, ua kishim puthur vajzën atyre të tjerëve, ne qemë trimat, kaubojisit, gangsterët.

Në atë kohë më duket se një pjesë e vajzave të bukura që këndoheshin në këngët e rrugës quheshin Neti. Nuk e di se përsë e kam përshtypjen se dhe vajza e puthur është quajtur Neti. Madje nuk kishte se si të quhej ndryshe përveç se Neti, emri më i përdorur në tërë atë atmosferë këngësh dashurie. Bash në atë kohë thuhej se një poet i quajtur Ndoc Gjetja, dhe që jetonte tri lagje përtej nesh, pati shkruar në librin e tij “... përse puthja të mbetet ilegale”.

Atëherë nëpër qytetet e vogla, dashuritë e fshehta dhe puthjet, disa i shihnin si flamë, sëmundje a dert, dhe disa të tjerë magjepseshin me vezullimin e tyre misterioze, pak të zbehta dhe të rrethuara nga thashethemet dhe hamendjet. Ngjarjet që lidheshin me dashuritë ndaheshin në dy lloje. Në “filanen e ka zënë qymyri me filanin” dhe “atë grua e kanë zënë në flagrancë”. Ndërsa e para kishte diçka poetike, ku rënia në dashuri qe një vendim i marrë në gjysmëjerm, pak në marrakatje, nga një turbullim i lehtë koke, nga një hutim, dhe kishte dhe shumë poezi në atë veprim, tek e dyta qe krejt prozaike. “Filanen e kanë zënë në flagrancë”, kishte në tërë atë thënie diçka policore, shtetërore, si një fletë gjobe, si të thojë ndryshe “je zënë me presh në duar”, e duke bërë një faj, kishte një tradhëti, shumë terr e thashetheme. Dhe fjala “flagrancë” e bënte më zyrtare dhe më të zezë se sa duhej atë situatë, që tregonte se një grua i kishte kthyer shpinën të shoqit dhe pat shkruar pas të dashurit.

Nëpër qytet, buzëmbremjeve, lulishteve, disi me zë të ultë, silleshin ca këngë sentimentale, me dashuri, herë fatzeza, ku dashuria shkonte deri në vdekje, dhe herë të tjera ku vajzat e dashuruara i zinte ndonjë sëmundje pikërisht nga dashuritë e parealizuara. Por qenë dhe një grusht këngësh që këndoheshin ose nga pijanecë mehanesh, ose nga jevgj të dëshpëruar, ose nga rrugëtarë që nuk e dinin se as nga ç’vend qenë nisur dhe as se ku do të mbërrinin. Ato këngë më duket se këndoheshin vetëm mesnatave, krejt në vetmim, mbasi duke u kënduar natën, nëpër rrugët shkret, qenë më të rënda, më të përballshme e të përvajshme. Dhe brenga, dhimbja e dashurisë, sëmundja apo vdekja e ardhur prej saj, dukeshin shumë më të thekshme. Dhe sa më shpesh këndoheshin këto këngë, aq më shumë më dukej se zbukuroheshin vajzat e qytetit tim të vogël, sa që mendoja se ato vajza silleshin nëpër qytet, të dëgjonin pikërisht ato këngë, që unë kujtoja se qenë bërë enkas për to.

Kam qenë 9 apo 10 vjeç kur, mes tërë atij muri me libra të tim ati, (zyrtar arsimi dhe pedagog letërsie), gjeta në një faqe të vjetër reviste “O ti këngëtar i vetmuar i rrugës / Që në mesnatë i bie kitarës ./ Mos m’i zgjo të lutem shumë / Ëndërrat e së dashurës...”

Qenë katër vargje që kishin brenda tyre edhe këngëtarin e vetmuar, edhe që bredh rrugëve, pikërisht në mesnatë, edhe që ka brenda tij bohemini dhe shpirtin e aventurës së njeriut të dashuruar, dhe i bie kitarës duke kënduar serenata poshtë dritareve të vajzave, të vajzave të bukura që ashtu në gjumë shikojnë ëndërra dashurie. Më kanë tronditur dashuritë e leximeve që nga Eva dhe Adami, Orfeu dhe Euridika, Fiklemoni dhe Baukida, Perikliu dhe Aspasia, Antoni dhe Kleopatra, Abelardi dhe Heloiza, Tristani dhe Izolta, Zigmundi dhe Ziglinda, Dantja dhe Beatrica, Romeo dhe Zhulietta, Markezi dhe zonja Dë Sad, Gëte dhe Kristina Vulpus, Napoleoni dhe Zhozefina, Persi B. Shelli dhe Meri Shelli, Kuazimodo dhe Esmeralda, Shumani dhe Klara Vik, Karl dhe Zheni Marks, Rikardi dhe Kozima Vagner, Roza

Ese. Parathënie e Antologjisë me poezi dashurie
“Për një puthje u shemb Troja”, Botime "MUZGU"

PËR NJË PUTHJE U SHEMB TROJA

Nga Mark Simoni

Luksemburg dhe Leo Jozhikes, Eleonora Duze dhe Gabriele D’Anuncio, Gertrudë Shtein dhe Alis Toklas, Lorens dhe Frida von Rihtofen, Martin Hajdeger dhe Hanah Arend, Virxhinia Ulf dhe Vita Sakvill, Salvatore Dali dhe Gala, Zhan Pol Sartri dhe Simonë de Bovuar, Anais Nin dhe Henri Miller, Ingrid Bergman dhe Roberto Roselini, Martin Luter King dhe Koreta Skot King, Lolita dhe Humbert Humberti, Merlin Monroe dhe Artur Miler, Uini dhe Nelson Mandela, Xhon dhe Xheki Kenedi, Elizabet Teilor dhe Riçard Barton, Xhon Lenon dhe Joko Ono, etj etj etj, por ato katër vargje dhe sot e kësaj dite, që unë kam ikur prej kohësh prej fëmijërisë dhe rinisë sime, më kujtohen si t’i kem lexuar sot. Një pjesë e vajzave të bukura të qytetit tonë qenë nga familje që shteti i pati shtyrë e degdisur nga qytetet e mëdha dhe zyrat e larta, në fund të rrugicave të ngushta të lagjeve dhe mëhallave tona. Qenë të hijshme, gjithë nur, sharm, bukuri, të heshtura, të përkora, të përvuajtura nga një vuajtje dinjitoze, pak në distancë, (qenë “me hije”, shprehja që përdorej për ata që kishin diçka në biografi, një cen, sikur nga radioskopia e tyre të ishte dalluar brenda trupit të tyre një njollë e zezë, apo hija e një sëmundje të fshehtë).

Dashuria qe një atmosferë pak misterioze, e mbajtur disi në fshehtësi, me ca pusulla letrash që shoqe mbas shoqeje mbërrinin në duart e djemve, rrahje me djemtë e tjerë për t’u dalë zot vajzave të lagjes, tatuazhet në trupat e të rinjve ku pikturoheshin zemra të përshkuara nga shigjetat, (simbole të vrasjes nga dashuria), koka të bukura femrash, apo ndonjë datë që gjithësesi kishte lidhje me ndonjë ngjarje dashurie.

Dhe si për të mos mjaftuar tërë këto dashuri, një mesnatë mbërritën në qytetin tonë, me ca makina të vjetra, ngarkuar plot tesha e njerëz, familja e Fadil Paçramit, si dhe Todi Lubonja me familjarët e tij. Thuhej e përshpëritej nga mëhalla në mëhallë se, shteti qe nervozuar me to, mbasi ato kishin kërkuar më shumë dashuri dhe puthje. E shikoja Lubonjën kur dilte darkave për të bërë xhiron e zakonshme me Lirinë. Kalonte bri pallatit tonë dhe humbte në periferi, atje ku rrugët qenë të qeta dhe pa njerëz. Ai pati lënë kryeqytetin e madh, rrugët e gjëra, shtëpitë e mobiluara, vajzat e bukura të Tiranës që shëtisnin më të çlirta dhe pa teklif, djemtë e veshur bukur që këndonin në kodrat e liqenit serenata. I pati lënë të gjitha, (për atë “liberalizmin e tij”, që njerëzit e përkthenin “që të kishte më shumë dashuri dhe puthje”), Dhe e patën sjellë e rrasur në qytetin tonë të vogël, me pak njerëz, me rrugica të ngushta e me tri lagje të vjetra. Kisha një dhimbje të turbullt e të zbehtë prej fëmije kur e shihja. Vërtetë për pak më tepër dashuri dhe pak më tepër puthje, qe shembur dhe Troja e këtij burri.



“Jemi shumë më gjallë, kur jemi të dashuruar”

Mes përmes natës dhe dimrit, udhëtoja me trenin që shkonte drejt Europës Qëndrore. Atje shëtiste nga njëri shtet në tjetrin ekspozita e piktorit të famshëm Vladimir Kush, ose i quajtur nga kritikët e artit si Salvadore Dali i Rusisë. Ekspozitë madhështore. Tablo që me dimensionet e tyre të përfshinin në situatat gjigante. Kur ja, bash në ball, në fasadën më të shikueshme nga vizitorët qenë “Buzët”. Një qiell i pafund, dhe në të një re e madhe dhe e kuqe, impresionante, në formën e një palë buzësh të bukura, gjithë epsh, ndjellëse dhe tunduese. Dhe poshtë tablosë qe e tërë bota, shumë më e vogël se buzët. Më sugjestionoi. Në çast mu kujtua patrioti i Kush-it, lirik i mrekullueshëm Sergej Esenin me “Eh ç’mi përdredh ti buzët, Nazemadhe moj, ...”. Buzët e poezisë mu dukën shumë më të vogla dhe aq lojncake, lozonjare e të hajthshme, sa s’di përse më erdhi keq për to. I kam krejt parasysh ato blloqet e vegjël, me kopertina të forta ngjyrë kafe, ku shokët e mi adoleshentë hidhnin pafund citate dashurie, shprehje të bukura filmash, thënie tunduese librash. Dashuria, puthja dhe buzët qenë fjalët më të shumta që përshkonin tej përtej ato blloqe të mjerë. Shprehjet dhe vargjet i mblidhnin një e nga një, dhe i mësonin përmendësh, që të nesërmen, kur të hasnin ndonjë vajzë, t’i citonin fjalët e librave dhe filmave, që të dukeshin interesantë dhe të zgjuar. Mbaj mend se dhe unë tundohesha herë pas’here nga mania për të patur citate dashurie. Në ato vite, se nga dreqin mbërritën në qytetin tonë një tufë e madh autobusësh me kinezë, që shpërndanin distingtivë me portretin e Maos, (portreti i tij paraqitej sikur rrezatonte dritë). Shpërndanin edhe citatet e tij. Qenë ca blloqe-libra fare të vegjël, sa një kuti shkrepe. Më pëlqente ajo madhësi. Aq të vegjël duhej të ishin edhe blloqet tanë, ku shënoheshin citatet dhe thëniet, për buzët, dashurinë dhe puthjet. Mendoja se përderisa dashuria ishte aq intime dhe e fshehtë, patjetër edhe blloqet duhet të ishin sa më të vegjël dhe t’i strukje ndokund, që të mos i shikonte njeri. Më e çuditshmja qe se, “Buzët” e Eseninit ishin në tërë ato blloqe, kopjuar nga njëri-tjetri, fshehtas, poshtë shkallëve, duke i thënë nën zë, me kujdes. Dikund Pablo Neruda thotë se, nuk ka gjë më trallitëse dhe joshëse në këtë botë, se sa shenja e buzëkuqit të një palë buzëve, mbetur në tehun e një gote vere, pas një nate dehëse. Ndërsa shkrimtari i njohur francez, autori i “Kontesha Gamiani”, Alfred de Muset tek një novelë e tij, përshkruan shenjën e buzëve në jastekun e dhomës së një hoteli në periferi, kur ajo “donte të fshihte klithjet e ekstazës”. Bota ka shumë gjëra për tu quajtur e bukur, por kurrë ajo nuk bëhet dot e plotë, e shijshme, tërë nur, e hijshme, tronditëse, vezulluese, plot shkëlqim dhe tundim njëkohësisht, nëse nuk do të kishte në të fishkëllimat çapkëne poshtë dritareve të vajzave, përshpëritjet e ëmbla të grave në vesh, (orëve të pas mesnatës), puthjen e buzëve, jehonat e brendshme të çasteve të lumtura që dalin nga buzët. Cili adoleshent i kësaj bote, i vëmendshëm dhe i amuar njëkohësisht, nuk e di vargun e famshëm të Percy Bysshe Shelly (Persi Bishi Shelli): “Soul meets soul on lovers lips – Shpirti takon shpirtin në buzët e të dashuruarve.” Po Judy Garlandin a e citojnë shumë të rinj? “It was not my lips you kissed, but my soul – Nuk ishin buzët e mia ato që puthe, por shpirtin tim.” Sepse siç thotë John Updike (Xhon Apdaik): “Jemi më shumë gjallë, kur jemi të dashuruar”. Nga studimet që janë bërë, gjëja më femërore tek gratë, më joshësja, më potente, më drithëruese, më me pushtet, i vrazhdë dhe eksitues njëkohësisht, për çudi të shumëkujt, është quajtur buzëkuqi, që i jep aq potencë buzëve. Ndërsa në botimin e parë të “From her lips” (Koleksioni i poemave me titull “Nga buzët”), të S. A. White, tek kopertina janë printuar stampimet e kuqe të buzëve të grave më në zë të kohës, 26 palë buzë.

Kur isha student unë shkrova poezinë “Puthja”. Më vonë e botova në gazetë. Më pati ardhur keq se, njëri prej shokëve që e mësoi përmendësh, ia tha vajzës që donte si të qe poezia e tij, madje sikur ia pati kushtuar enkas asaj. “Ohu, poezia është e jotja sa të jetë në fletoren tënde, pastaj është e jona.” Tashti qesh, sepse këtë ma kujton dhe filmi “Il Postino” me Pablo Nerudën, ku postjeri i fshatit i tregonte shkrimtarit se çfarë i pati shkruar fshehtas të dashurës. Një herë Pablo dalloi në letrat e dashurisë së postierit disa nga vargje e tij. “More pizeveng, po këto janë poezitë e mia”. “Të tuat i ke tek shtëpia, tani që kanë dalë në gazetë janë të miat” - ia ktheu postieri,

Buzët, (ky mjet i shenjtërisë së puthjes), që frymëzuan miliona njerëz në dalldinë e tyre të dashurisë, i kanë dhënë letërsisë dhe subjekteve të saj stilin fin, e kanë sajdisur këtë art me një dimension tepër delikat dhe të këndshëm. Kam parasysh këtu librat “Buzët e ëmbla” të Mel Smith, “Buzë që prekin të miat” e Wendy Lindstrom, “Buzë të kuqe gjak” e Anna Roselli, apo novela e Valeria Sherwod “Buzët e bukura gënjeshtare”. Mbi tërë këtë reliev subjektesh, buzësh, ndjesish, ngjarjesh joshëse dhe tunduese, përhapen tinguj e këngës së pavdekshme të William Shaw “Një këngë për buzët që s’janë më”. Selman Ruzhdie thotë: “Jam rritur duke puthur bukën dhe librat, sapo putha një dashuri, i harrova dy të parat. Kjo është magjia e buzëve.” Jam krejt i sigurt që poezitë e kësaj antologjie do ta bëjnë akoma më të shëndritshme, më vezulluese, më luminishente, më femërore, më fragile, më të ujshme dhe të tejdukshme poezinë delicate dhe të fisme të dashurisë, puthjes dhe buzëve.

“Unë jam një artist në jetë, puna ime
e artit është jeta ime” - Suzuki¹.

Ndriçimi i vlerave të veprave kulmore të letërsisë sonë shqipe (siç vepro i dhe me disa kryevepra të letërsisë botërore²) nga profesor Anton Nikë Berisha, është një kontribut i çmuar për studimet tona letrare. Kjo dëshmon punën e studiuesit të përkushtuar, i cili të thuash çdo ditë të jetës ia ‘falë’ artit – letërsisë, siç e thotë edhe ai vetë në njërin ndër librat me biseda se “Letërsia vetvetiu u bë jeta ime”³.

Dëshmi e një studimi sa serioz po aq të rëndësishëm, është edhe botimi i librit “Dy kryevepra lirike të Fishtës”, ku merren në vështrim veprat “Jerina ase Mbretnesha e Luleve” dhe “Zana e Vizitorit”. Studimi dëshmon një qasje të veçantë për dy vepra lirik të rëndësishme të Fishtës, të cilat profesor Berisha i vlerëson si kryevepra.

Në dy pjesët e studimit “Jerina ase Mbretnesha e Luleve” dhe “Zana e Vizitorit” janë ndriçuar disa nga vlerat kulmore të tekstit e të këtyre dy krijimeve të Fishtës tonë të madh.

Jerina ase Mbretnesha e Luleve - “Rreze e truve të Fishtës”

Rreth veprës lirike “Jerina ase Mbretnesha e Luleve” të Fishtës, për të cilën për herën e parë bëhet një interpretim i mirëfilltë i tekstit të saj, Anton Nikë Berisha thekson: “Është vështirë të gjendet edhe një shembull tjetër në letërsinë tonë, që pikëpamjet e veta teorike dhe estetike një shkrimtar t’i ketë zbatuar me aq saktësi dhe shkathhtësi në një vepër letrare poetike, si në “Jerina ase Mbretnesha e Luleve”, e cila “është vepra poetike më përfytyruese, më imaginatave, që ka dalë nga pena e tij”.⁴

Veprën “Jerina ase Mbretnesha e Luleve” Berisha e vështron nga disa këndvështrime, përmes së cilave ndriçohet kjo lirikë e pasur dhe me vlera, që sipas profesor Berishës është “rreze e truve të Fishtës”.

Autori e krahason Jerinën e veprës së Fishtës me Vashën e veprës së Santorit “Këngëtorja arbereshe” dhe me Hajdhi në veprës së Skiroit “Milli dhe Hadhia”; ai vlerëson me të drejtë se Jerina “është sa hyjnore po aq konkrete : “ Qi t’jët nieri e të dajë Lule”⁵.

Teksti i kësaj vepre dëshmon se bukuria e Jerinës është e pazakonshme, siç është e pasur dhe e veçantë gjuha poetike dhe të shprehurit e pasur poetik, mënyra dhe shumësia e mesazheve që dalin prej tij (tekstit):

*Si’ i cirkë voëse m’gjeth t’nji Lilit,
Kûr prej nandjet kah pranvera
T’a pershkojë nji rreze diellit:
Herë danë mal me borë ngarkue,
Herë nji fushë krejt n’Lule shtruve:
Tash ixhí ruajtun n’kutí:
Tash si zogla neper pyll:
Sidomos, por si nji diell,
Të tanë rreze e të tanë dritë,
Qi mbí shekull rrin e shndritë,
Amel amel tue shkelqá,
Kurrkund sýt aj pa t’i vrá.”⁶*

Në të katër pjesët e veprës: Prologu (Trazimet), Pjesa e parë (Zgjedhja), Pjesa e dytë (Të kunoruemt) dhe Fundi (Apotheosis), imagjinata fishtjane, ‘i bën lulet të flasin e kuvendojnë mes tyre’, po dhe me zanat dhe orët, të cilat i njohim nga mitologjia shqiptare.

Profesor Berisha thekson se hijeshia dhe bukuria në këtë melodramë nënkuptojnë dashurinë dhe lumturinë, që është baza e të shprehurit poetik të Fishtës, një gërshetim ndërmjet artit të fjalës, njëjtësim i bukurisë së gruas dhe i bukurës si veçori estetike në art. Pra, “E bukura tjetër, si strukturë gjuhësore poetike, është krijesë e mendjes dhe shpirtit të Fishtës e shprehur përmes vargjes, metrash, ritmesh e ngjyrimesh të ndryshme, përmes tablosh të rralla poetike të përfuara me përkushtimin e një krijuesi të madh”⁷, që ndërlidhet me mendimin e Fishtës: “[...] prej kângësh e vallesh s’ona popullore vëhet oroe se Shqiptari, mâ fort se dashunín, këndon hijeshín e grues, shka edhe perkon mâ se miri me temperament të nji populli kreshnik,

1 Robin Sharma, *Murgu që shiti ferrarin*. Botoi “Albas” Tiranë 2020, f. 41.

2 Shih Anton Nikë Berisha, *Mbi disa kryevepra të letërsisë botërore*. Faik Konica, Prishtinë 2022.

3 *Letërsia vetvetiu u bë jeta ime*. 32 biseda me Anton Nikë Berishën në vitet 1981 – 2019. Zgjedhi dhe përgatiti për botim Prof. ass. LABINOT BERISHA, Botoi Sh. B. “Beqir Musliu” Gjilan 2020.

4 Anton Nikë Berisha, *Dy kryevepra lirike të Fishtës*, Sh. B. “Beqir Musliu”, Gjilan 2023.

5 Anton Nikë Berisha, *Dy kryevepra lirike të Fishtës*, vep. e perm., f. 16.

6 Po aty, f. 17.

7 Po aty, f. 22.

Anton Nikë Berisha, *Dy kryevepra lirike të Fishtës*
(Rreth veprave “Jerina ase Mbretnesha e Luleve”
dhe “Zana e Vizitorit”), botoi Sh. B. “Beqir Musliu”
Gjilan 2023

LIRIKA E FISHTËS NË DRITËN E DY STUDIMEVE TË VEÇANTA

Ajete Zogaj

kshtu per subjekt të këtij poemthi u muer bindja ndaj
hieshín e grues”.⁸

Përkimet me letërsinë tonë gojore

Përkimet e tekstit poetik të “Jerinës...” me letërsinë tonë popullore, përkatësisht me poezinë tonë gojore, të cilën Fishta e çmonte tej mase “shka s’besoj se e ká ndonji kómb tjetër i Europës”, është një pjesë mjaft me interes, të cilën studiuesi Berisha e vështron me përkushtim duke pasur parasysh krijimet nga tradita: vajet, gjëmët, baladat, përrallat, urimet e mallkimet etj., po duke dëshmuar përherë origjinalitetin e vet, me ç’rast krijon ‘thesare të njëmendët’.

E bukura që në esencë shpreh botën e shqiptarit, siç ngjet në pjesën dërmuese të krijimtarisë letrare e atdhetare të Fishtës, është analizuar me shumë kujdes nga autori duke sjellë pjesë më të realizuara nga libri, edhe nga vetë origjina shqiptare e Jerinës: “Vashë bujare – edhe Shqyptare”, “*Lé në* Shqypni” dhe “Prej nji Lulje bëjtë n’Shqyni”¹⁰, duke e shprehur përmasën hyjnore të saj të lidhur me vendin e shqipeve – Shqipërinë.


Në përmbyllje të interpretimit të veprës “Jerina ase Mbretnesha e Luleve” Anton Nikë Berisha jep këtë vlerësim: “Me pak fjalë, me cilësitë dhe vlerat që përmban, “Jerina ase Mbretnesha e Luleve”, hyn në rrethin e ngushtë të veprave poetike më të rëndësishme të letërsisë sonë, ndërsa në rrafshin metrik, bashkë me “Këngëtoaren arbereshe” të Françesk Anton Santorit dhe “Mino-n” e Zef Skiroit, hyn në radhën e kryeveprave të traditës sonë letrare”¹¹.

8 Po aty, f. 19.

9 Po aty, f. 19.

10 Po aty, f. 41.

11 Po aty, f. 44.



“Zana e Vizitorit” – lirikë përfytyruese e pazakonshme

Kur është analizuar dhe interpretuar vepra e Fishtës “Lahuta e Malcís”, zakonisht janë ndriçuar kryesisht vlerat epike të tekstit. Lirizmi, ose nuk është përmendur, ose është përmendur shkarazi. Përmes studimit të këngës “Zana e Vizitorit” në mënyrë të argumentuar Berisha e përmbysë mendimin se gjithë “Lahuta e Malcís” është vepër epike e bazuar mbi ngjarje e ndodhi konkrete të sfondit historik. Sipas tij “Zana e Vizitorit” (me 1134 vargje) është dëshmi e lirizmit dhe e realitetit përfytyrues poetik të jashtëzakonshëm dhe si e tillë edhe vepra “Lahuta e Malcís” duhet të interpretohet nga ky aspekt nga se pa ndriçimin e këtij fakti “[...] çdo studim për të do të jetë i pjesshëm dhe i mangët”¹².

Duke analizuar tekstin e këngës “Zana e Vizitorit”, autori në mënyrë të veçantë vlerëson mjeshtërinë e Fishtës që t’i shprehë përmes gjuhës poetike veprimet e zanave dhe të orëve, veçmas të Zanës së Vizitorit, të Zanës së Madhe (Të Bukurës së Dheut) dhe të simotrave të saj.

Në studimin e vet profesor Berisha hedhë dritë mbi disa elemente të cilat nuk janë thënë deri më tani për këto dy krijime, sidomos të sistemit të pasur shprehës poetik, kur përdoret një simbolikë dhe metaforikë e pasur, që meritojnë shqyrtim në vete.

Shembujt që i sjell autori si konkretizim i tablove dhe i teksteve nga dalin mesazhet poetike të këngës “Zana e Vizitorit” janë ndër pjesët më të bukura, që dëshmojnë sa për një lexim të kujdesshëm, aq dhe për një vepër kulmore lirike.

Të përmend këtu pamjet poetike për shumëçka të pasur të çastit të betimit të zanave dhe të orëve se do të marrin hakun e Tringës së vrarë nga Vasil Ndreka. Për këtë veprim Zana e Vizitorit, me maturi, i frymëzon dhe i nxit trimat më të mirë të Malësisë dhe nga i gjithë vendi që të bashkuar të mbrojnë vendin, nderin e dinjitetin e shqiptarit:

*Veç ndigjoni, oj Orë e Zana,
Se me zanë due bét e mdhana:
Pasha rrezet qi lshon hana!
Pasha voesen mbí ledina!
Pasha brej, aha e çetina!
E per mriza e qepariza!
E per gurra neper curra!
E per lila e per bylbyla!
Pasha t’rijt e pasha veren!
Mos e pritsha kurr prendveren!
E as mâ Zanë mos m’thaçin mue,
Se un dér neser, pa marrë dielli,
S’e là Tringen pa e pague!”¹³*

Thënë me pak fjalë, kjo vepër e Anton Nikë Berishës është për shumëçka e rëndësishme dhe si e tillë do të jetë nxitje për studiuesit e veprës së Fishtës që t’u qasen teksteve të veprave të tij në mënyrë sa më të mirëfilltë, për arsye se vetëm me analizimin dhe interpretimin e tekstit dëshmojnë vlerat e njëmendta të një vepre.

Prishtinë, janar 22023

12 Po aty, f. 48.

13 Po aty, f. 72-73.

Dikur bënin përshtypje kërkuesit e arit në Alaskë. Tani po tërheqin vëmendje gjurmuesit e meteoroidëve. Edhe pse thuhet se të mirat nuk bjenë nga qielli, shumë nomadë i kërkojnë meteoridët në shkretëtirë, të cilat në treg kanë një çmim të leverdishëm. Për t'i dalluar nga copëza shkëmbinjësh, përdoren aparatura të specializuara, duke përfshirë dhe detektorë minakërkuesish. Kur lexoj skicat, etydet poetike të Alda Taçes alias Esmeralda Shpata, ku: "Natyra ka mprehur shqisën e saj të madhe", më kujtohen meteoridët, sikurse më shtohet kujdesi për t'mos i ngatërruar ato me copëra shkëmbinjësh, pale cila bombash. Jo çdo gjë që shëndrit është ar, sikurse jo çdo gjë që nxin është meteoroidë. (Dikur me meteorin që digjej në qielli, krahasoheshin dëshmorët e luftës. "Qyteti im më nxori jashtë. Më tërhoqi zvarrë deri te stacioni i vjetër i trenave. U mblodhën shumë njerëz, i gjithë qyteti... Një orgji e çmendur shqyente copat e mia me një mllef të patreguar ndonjëherë. E gjithë arsyeja e praptë e botës i kishte hyrë brenda ndëshkimit tim." Thua këto rreshta t'i ketë për Kadarenë, apo i shkojnë më shumë Driteroit? Është ajo vetë, që ndjehet e dëbuar në këtë kohë ikjesh.)

I tërhequr nga mënyra e të shkruarit të Aldës, prej kohësh matesha të shkruaja një ese, por, mjaftohesha me ndonjë koment, në pritje ndoshta të "hapjes së qiejve", ku dëshirat e autores të ktheheshin në "meteoroidë", se copa shkëmbinjësh në një vend malor, si yni: gjen sa të duash. Ku të qëllosh tjetrin me gurë është kthyer në hobi. "Po ky është kulmi, nuk të përgjigjet universi, edhe pse të thuhet je një mrekulli, je unike, je e papërsëritshme", ironizon ajo gjithkënd, që mbahet për unversal, me demek se ka krijuar universin e tij. Janë të rrallë ata krijues, të cilët, qysh në shfaqjen e parë, të kenë: stil, individualitet, kur, s' mjafton një jetë e tërë për të krijuar profilin tënd. (Në një takim teatror në Lezhë, shumë vite më parë, Kadri Roshi do i drejtohej një gjimnazisteje, që shkëlqeu në rol: "Po qe se ti vjen në shkollën e arteve, unë s' kam se ç' të të mësoj më për aktrim." Mu kujtuan fjalët e aktorit të madh, teksa hidhje këto rreshta për Aldën, ku profesorllëku të del tepër. Në art askush nuk mësohet, por, nuk mund t'ia dalësh mban, nëse nuk je i aftë të mësosh ato që të duhen me intelekt dhe intuitë.)

Libri i parë i Esmeralda Shpatës, botim i Onufrit, titullohet: "Tregimet e një personazhi". Edhe pse një rrëfimtari, në to nuk kemi një monolog. Edhe rrjedha e një lumi është monolog, por, sa shumë gjëra ndodhin në të. Edhe jeta e një peme është monolog, por, që nga dalja e sythave dhe rënia e qetheve historitë shtohen rrugës. Ky personazh vazhdon të rrëfejë edhe sot e kësaj dite, duke mos u humbur intersi në "përronin e ndërgjegjës", sepse ajo është e aftë të mbajë gjallë vëmendjen e lexuesit. (Sa shumë gjëra thotë ajo, edhe pse duket, sikur s' po ndodh asgjë!) "Ndonjëherë Zoti të mbyll çdo hapësirë, por si i mençur që është e bën me kast, vetëm ashtu të bën të lëvizësh."

E papritura në tregimet e Aldës nuk duhet kërkuar tek subjekti, por, tek aftësia e autores, për të hetuar brenda njeriut, doemos dhe brenda vetes, ku e jashtëzakonshmja nuk shkakton bujë dhe e zakonshmmja merr atributet e saj. Në vend të teleskopit i pëlqen të përdor mikroskopin. Kozmanautët dhe polumbarët udhëhiqen nga i njëjti qëllim: njohjen e botës. "Ca të pathënave nuk u jap dot trajtë, i shpërbëj e i fsheh nëpër mendje aq thellë, saqë po të mendoj se duhen zbardhur, dridhem. Me siguri rrethanat e pafavorshme për t'i dalë faqebardhë jetës vijnë e më takojnë kur vjen rasti i pavolitshëm." (Fantazia e Aldës përngjan me të një filmi multiplikativ, ku prej vizatimeve të ngrira ka aq shumë lëvizje.) "Jam vrojtuese e hollë, më beso.

Kur lexoj skicat, etydet poetike të Alda Taçes alias Esmeralda Shpata

ZBULIMI I VETES SI FAVOR APO SI ANDRALLË?

Nga Fatbardh Amursi (Rustemi)



Të çarat që i pashë sot në mëngjes, para se të merrja peshkun për ty, i ke krijuar vetë, mi ke krijuar mua. Unë nuk e kam ditur ndonjëherë se në ç'probleme po të futja." Të duket, sikur luan me fjalët, ndërkohë që, kap nuanca, zhbiron karaktere sa më shpejt të jetë e mundur, tërhequr nga të fshehtat, që, nga rrëfimi në rrëfim zbulohen duke u shtuar misteri, pa u errur kuptimi. Si fillim, nuk pretendon shumë, vetëm t' i shkosh pas, më tej i dorëzohesh plotësisht, natyrisht pa e përdorur femrën, sikurse spekulohet rëndomtë sot me gjuhën e trupit. "Turma mashkullore duartroket dhe fishkëllen instinktivisht. Secili është pjesë e një mase të madhe gëzimi. Bilbili bie. Juria s'duket, por ajo është. Gratë ndalojnë së treguari këmbët e tyre. Fotografët lodhin aparatet fotografike. Burrat ndalojnë së shikuari. Ata fshehin fytyrat, gratë nuk kanë kokë. Çmimi i parë pritët të shpallet pas heshtjes. Qepallat e ulura e kanë zgjedhur më të bukurën. Secili prej meshkujve i ka zgjedhur këmbët e hijshme."-shkruan ajo në tregimin

"Garë pa kokë", ku, përdorimi i femrës, për qëllime pragmatiste është kthyer në një lloj manipulimi, që duke u shtuar po legjitimohet.

S' ka gjë tjetër që të shkaktojë më shumë dramacitet nga krisjet e befta të ndërgjegjës, sikurse nuk ka gjë tjetër që t' i deformojë karakteret nga ligjet e pashkruara, sikurse e thotë dhe ajo: "Rregullat për të të mbajtur frerët i kishin ndërtuar të tjerët, unë i ndiqja me admirim, ndihesha krenare për çfarë bëja." Në një tjetër skicë: "Kam jetuar me një farë krenarie të paarsyeshme dhe në një vështirësi të parë dukem e lumtur." Nëse botës i duhet paqja, shpirti i një krijuesi nuk gjen kurrë rehat, i cili, në hartë: duhen shënuar si zona sizmike. "Derisa nëpërmjet ca të plasariturve të pashë ty, pashë veten time distrofiqe, të paushqyer, të trembur dhe të mpakur, të dhunuar dhe të torturuar nga mua vetë." Nëse e pyet se si ndodh ky dhunim i vetes, zor se ajo arrin ta shpjegojë, por dhe unë që marrë përsipër ta bëjë këtë, nuk jam qind për qind i sigurt. Një gjë dihet:

spontaniteti krijues në çaste frymëzimi, të një imaginate ekzyberante sjellë imazhe, ku arti abstrakt nuk ndjen të shterrur. (Nga pluhuri kozmik ndodh të krijohet një yll. Nga pluhuri i harresës mbulohen vlerat.) A rrezikon që, Aldës, t' i ngushtohet rrethi tematikë, të përsërisë veten gjer në krijimin e një rrethi vicioz, të mbyllet në fshikzën e mëndafshhtë, të shpenzohet si kandili që s' ka vaj, përderisa rrëfyesi që tregon mezi del nga shtëpia dhe personazhi i dytë që takon, ngujohet në provincë, si një i pashpresë? Ndoshta një arsye kjo, e shtyrjes në kohë të këtij shkrimi, ku po më pëlqente të hetoja për llogaritë e mija, duke shpresuar që përsiatjet e hedhura në ese të jenë të dobishme për Aldën dhe jo vetëm për të. Jemi në shekullin, ku me "rrymat e dobëta" po bëhen mrekullira. Turbinave u këndohej dikur.

"Nuk njoh asnjë me emrin Kren. Nuk kam bërë asnjë veprim, përpjekje apo gjest për të takuar një njeri me këtë emër. Nuk kam ëndërruar ta takoj, as ta përfytyroj sesi mund të jetë një Kren." Nuk e njeh, as që bën përpjekje ta njoh, e jo më ta përfytyroj dhe, në fund, e nxjerr nga anonimat, ku personazhi merr trajtë, fytyrë, karakter, ngaqë përshkrimi krijon një efekt të kundërt. Heroina vazhdimisht ndodhet para një të panjohuri, apo së panjohurës, sepse me ta ndan vetminë, e cila s' ka rrugëdalje në dukje, por, shtegu feks, edhe pse nuk e përdor kush si shpëtim. E gjithë hapsira, ku ndodhin historitë, që, nuk regjistrohen në kronikat e kohës janë: muret e një shtëpie, sikurse klasiçistët i vendosnin ngjarjet në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë, jo më shumë se 24 orë, më pas: një dalje në rrugë, ku me patjetër është një stol dhe, qyteti i vogël provincial ta ka caktuar hisen, sepse: "zbulimi i vetes është favor, është liri". Një shembull ideal se si ngrihesh nga vetja, pa ndihmën e rrethanave. "Kren, emri i bukur, veshi këmbësh duke adhruar veten para pasqyrës, u parfumes, gogësi tërë kënaqësi dhe, me hapa të shpejtë, e nxori veten jashtë dere...këmbët po e shpinin drejt një stoli që u lirua enkas për të... Ai vend aty ishte i përsosur. Kundërmimi i ajrit e tërhoqi vajzën që nga shtëpia dhe e solli në park, pa ndonjë qëllim. Pamja e dy njerëzve të huaj në qytet nuk i fshihet kujt, por ngjan me një kërkim pa kuptim të vetes...E nesërmja e dëboi secilin nga shtëpia e vet, e ngatërroi rrugëve, në mënyrën e saj të fshehtë. Burri shkundi supet për disa herë rresht, e shtyu përpara vetes të vetmen hapësirë ajri në atë kopsht të madh. U ul mbi stolin prej xunkthi, ngriti sytë lart si për të rrokur kuptime. "Si nuk më njeh kush, cili jam?! Si nuk u bë një veprim, përpjekje a gjest për të më gjetur mua?! Askush nuk do ta përfytyrojë sesi është një Kren, as në ëndrra. Në qoftë se dikush do ta gjente këtë, do t'ia përgatisja një sallatë me aragosta, do ta pinim dhe një shishe vere, të bardhë." Kam pikasur situatën më tipike, ku gjenden shpesh personazhët e skicave të Aldës. Ndaj kam pritur, jo pa shqetësim, mos kushedi lodhet një ditë dhe, vlerësimet paraprake bjenë. ("Zgjatja ishte ngjarja e jetës së tij, ai harroi të rritej.")



ESMERALDA SHPATA

Tregimet e një personazhi

Onufri Tregime

Në fakt, energjia për të shkruar i shtoj dhe kjo ndikonte në rrënjosjen e simpatisë. Por, a shterrej? Më duhet të pranojë se ky rrezik ekziston. (Shkuarja në Hënë nuk kthehet më në ngjarje, tani i janë qepur Marsit. Kështu duhet të ndodh me çdo krijues pas çdo suksesi të parë.) Si mund të shterr një e palodhur? Duke konsumuar të njëjtat gjetje, po ato mënyra shprehëse, të njëjtat perceptime, duke u kthyer në një lojacake, kur dhe “deus ex machina” në skenat antike u lodh një ditë, duke i mbetur muzeut. “Derisa nëpërmjet ca të plasariturve... pashë veten time distrofike, të paushqyer, të trembur dhe të mpakur, të dhunuar dhe të torturuar nga mua vetë”, a ka të ngjarë që tek ky portretizim, të hasim rrëfyesin me mision të përfunduar?

Alda nuk ka kulme, pasi të gjitha shkrimet kapin një lartësi, gjë që duhet të shtojë ambicjete për kuota të tjera. Dihet që sjelljet e sinqerta rrallë marrin shpërblim, sepse mund të ndodhë, të përballesh: “E akuzon unin tim për rrezën e njohjes dhe mosnjohjes, për amplitudën dhe frekuencën e mosveprimit, por kjo është absurde... Ky miku im anonim, mbase mund t'i ketë qëllimet konkrete si ai mund të jetë, mirëpo mua më duken absurde dhe të panjohura ashtu si identiteti i tij... Njeriu është pus, botës do t'i tregojë ujin e kulluar në sipërfaqe, vetes ia fsheh në fund të shpirtit se nga ku turbullohet.” Është po ajo dukuri që ndodh dhe me lulet, të cilat: për vete thithin gazin karbonik për të na dhënë oksigjenin, sikurse Alda pjesën e kulluar ua jep njerëzve, ndërsa vetes fundin e turbulluar. Meqë “njeriu është pus” shpresojmë që, ai apo jo, të mos jetë narcisti i mbytur në të. “Miku im anonim ma përkëdhel sedrën shumë deri në momentin që unë s'e njoh, përpjekjen e parë që bëj për të ditur më shumë rreth tij, më gjuan me gurë. Po i kërkoj një nder mendjes dhe mikut tim anonim: Ta bëjmë pushim sot!” Në momentin që kërkon ta njohë “përkëdhelësin e sedrës”, ai e gjuan me gur. Ndaj ajo, nxjerr në pah forcën e karakterit: “Megjithëse jam një masë e madhe dëshirash, nuk u iki dot përgjegjësi.” Të gjithë njerëzit e zotë janë të ndërgjegjshëm për talentin, që zotërojnë, ndaj ata dhe nga fundi i vetmisë, ku përgjithsisht i braktisin, ia dalin t'i imponohen shoqërisë, e cila, rrallë qëllon t'i marrë në mbrojtje. (Atë atmosferë që sjell ujvara, nuk e ofron shatërvani.) “Jam veshur me të bardha dhe po grindem me një grua të veshur po si unë. Ajo ka një çelës në dorë. Më tërheq për flokësh dhe më mbyll në një raft muri. Ngjan me musendrat që mbajnë erë tërfili të thatë. Rafti ku më kanë burgosur vjedh pak dritë ngjyrë vjollcë. Iu luta të më shkonte një kryq mbi trup më mirë. E pashë në sytë e saj që donte t'më vriste. E nuhata se ajo po përgatitej. Nuk më kujtohet mirë si munda të shpëtoj”, shkruan autorja, duke më kujtuar “Medean” e Euripidit: “I drejtë s'është syri i njeriut./që pa njohur mirë shpirtin e një tjetri, vetëm duke e parë/e urren këtë, ndonëse s'ka pësuar ndonjë gjë prej tij.” Urrejtja pa shkak shpesh sjellë dëme më të mëdha nga ajo e motivuara. Por, i drejti, nuk përfshihet në këtë mëkat. “Inati i njeriut qënkë më i fortë nga gjykimi i tij.”-shprehet Medea e Euripidit. Duke shkruar për Medean, ku e gjithë e zezë e hakmarrjes fshihet pas vellos së helmtë, Alda luan me imazhet: “Kur të vishem me të bardha nuk do të martohem më.” Dhe në skicën “Ëndrra ime e bardhë”: “Ëndrrat e mia, asnjëra nuk ka fizionomi të qartë, të gjitha të vogla nën mesataren e iluzionit. Të lyera me gëlqere (si për t'u ruajtur nga kompanitë e insekteve)”, edhe pse: “Një dordolec që në vend të trembi, trëmbet.” Por, përherë ka një fund dhe ty, si lexues, do të shfaqet: “Vajza e ulur përballë teje (ajo me kapele), është kuptimi yt i ri.” Përballë Aldës u përpoqa të zbuloj kuptimin e ri të skicave të saj. Shpresoj t'ia kem arritur.



KJOMË¹

Pravullohem, marr një të ngrohtë pë t'i shpëtuar hiçit. E thith avullin me hundë që të shpëtoj, iki nga dera e pasme e shtëpisë dhe ndez një zjarr të madh. Fytyra ime e sorme ka njolla të zeza, atyre nuk u iki dot. I jap vlera të ndryshme, ajo i merr dhe i ndryshon sipas kushteve. Midis asgjësë dhe njollave ndodhet një paradhomë ku unë ildis e bëj jamballë me lule të mbledhura në vile.

Mendja ime e ngushte, rënia ime mblidhet me një gjuhë dhe mbron kokën nga goditjet.

Më duket se kam rënë në dashuri. Dora ime e djathtë sendërtohet e bëhet një furçë majacuke. Ingallitet me shpirt fytyrës sime dhe i zbardh njollat e zeza. Përzihen e ngatërrohen me njëra- tjetrën aq sa nuk dallohen e bëhen të tëra njëlloj.

Rrëza e hiçit është futur në tokë dhe më nxjerr gjuhën, befas zgjat dorën dhe i jap një furçë dhe asaj.

Besimi dhe ndjenjat e mia janë të mundshme sajë furçës sime të djathtë. I lyen rrangullat e mendjes, m'i lidh lak e më kandis të ndihem e bardhë.

Furça ime prej melekuqesh të thata e degësh të holla më nxjerr një britmë të ndërprerë. Merr kovën e m'i lyen parimet e normat e sjelljes sime me bojë.

Natyrën time të gjallë e të lëvizshme ngacmuesit e jashtëm e nxitin. Lëkura ime me njolla ndihmohet nga dora e djathtë për të fshehur trazirat e brendshme.

Bota e ka humbur dritën e syve, bëhet e paaftë për të parë seç ndodh poshtë të bardhës së rreme, nën njollë, në kjomën e ëmbël.

ZOTI MBI ÇATI

Shalohet vetë centauri?!

Shikimi mbi këllqet e tij të forta është tejpërsëhkrues. Pa ndërprerje, e ndien që një muskul e tradhton kur shikon qiellin.

Shprehja e syve ngatërrohet me njeriun dhe kafshën. Në ajër ngrihet lutja. Kokën e çon mbi re dhe kërkon të shpëtojë gjysmën e trupit.

Dy gjysmat e tij më të mira lidhen me një shkrirje të padukshme në bel. Ai burrë nuk di kër të dojë më shumë; gjysmën e tij leshatore me patkonj të fortë apo gjysmën e sipërme të bardhë?

Mban gurë e bën mure, mbi çati sajón oxhaqe. Ndërtesa del pa llogari, vetëm se ka një shans, mos jetojë aq sa të bëjë emër. Kali punon për të rregulluar e përsosur qenien e tij. Njeriu kërkon vullnet dhe forcë për të plotësuar kalin. Kur gjysmat zihen krijesa qan. Lotët e kalit rrjedhin nëpërmjet syve njerëzorë.

Asnjë grua nuk ka ankesa për rolin e tij, ai s' mund të kënaqet vetëm me një rast. Nuk ka ligj që e llogarit mishin pa lëkurë. Forca dhe mendja kërkojnë shpëtim. Shtëpi, është pylli ku centaurët flenë. Nata nuk i ka me sy të mirë, krijesat shikojnë ëndrra të pavdekshme. Ecin me natyrën e tyre prej kali të punojnë për të pasur çfarë u do koka.

Bishti është tepër. Njerëzit duhet të kishin duzina bishtash, sipas natyrës së tyre kërkuese. Subjekti shpartallohet, hallkat e tij e shthurin zinxhirin. Bota jonë një Tesali.

Zoti qendron lart, mbi çatinë e secilit ka

vendosur nga një piketë. Në shtëpinë e tyre janë vendosur dy.

Qenia bëhet e përgjeshme.

Kur dashurojmë dhe lindim fëmijë lutemi. Gjysma e parë prej njeriu shkrihet në gjysmën e bukur prej kali. Pa parapërgatitje. Mbi shpirtin dhe mbi çatinë time ka qëndruar dikush. Kjo më lehtëson. Sjelljet tona të vrazhda dhe të egra do të ishin të vajtueshme në qoftë se nuk do të kishim përkujdesje.

NË CEREMONITË E ROZËS

Dëshirat e tij vetjake ato të pashfaqurat, të fshehura me kujdes mes rregullit, u shfaqen e morën formë vetëm atëherë kur ajo e pranoi. Unë isha në dasmën e tyre. Ai luante dhe e hidhte përpjetë në ajër sikur ajo të ishte një kukull nga ato me sy plastikë tmerrësisht të bukur. Unë (dua ta shpëtoj veten nga kjo histori), i pata folur gjithmonë që mos ta hidhte Rozën ashtu fluturimthi, lart, por ai nuk ma vinte veshin asnjëherë.

Kishte kohë që më fshihej. Që atëherë. Gjeta një rast kur dëgjova diçka të ulët për sjelljet, në veçanti ato që e rrethonin. Gabim bëra që futa hundët, ç'përitshmëri të tjera kisha pasur për të, gabim bëra, por tani nuk e ndreq dot më. Lëre më që nuk mbahet mend sa kohë ka kaluar që atëherë, mbase as ai s'e mban mend.

Truri i tij kishte mendime të shumta. Disa i shërbenin për të ndjekur rrjedhën e veprimeve të Rozës e për t'ju vënë pas pa e kuptuar ajo. Përndjekje quhet.

Kur ishte kohë e keqe mbyllej brenda dhe shtronte një karton të madh ngjyrë alle në të cilin bënte skica me një laps të vogël xhepi. Në çdo rast kryqi që zhvendosej nëpër vijat dhe kurbat lëvizëse brenda skemave, ishte Roza. Pasi mbaronte e mblidhte si një tub dhe e lidhte me një llastik flokësh, e vendoste në një vend të sigurt për mos ta zënë lagështia. Tani në atë anë të horizontit nuk ka as dhomë e as raft, gjithçka ka mbetur djerrë pa skica e pa gjë. Mua më është bërë zakon, i hedh sytë në atë pikë ku hamendësoj se ajo ngatër kartoni mbante të fshehtat e shpirtit dhe mendjes së tij.

Rozën e pati njohur në një lagje të bukur, ku jetonte në bollëk të plotë, jetonte në një vend të qetë gjithë shkëlqim për aq sa zgjati. Për aq sa zgjati dhe kjo histori, ajo atje s'u kthye më, kështu flitej, pasi kishte kohë që s'dukej kund.

Roza, ajo që kishte mbetur prej saj, kohët që pasuan i kaloi në lëvizje sa te një vend e në një tjetër. I ndryshoi e gjithë pikëpamja për jetën.

Në atë kohë e gjithë ajo ngatërresë dridhesh i bëri bashkë. I mbushnin me lumturi bocat e dashurisë.

Vendi ku u takuan nuk kishte ndonjë emër të përngjasueshëm, ama si relief, klimë e natyrë ishte i përshtatshëm për t'i mbajtur nën zap dallgët dhe hedhjet e zemrës. Dashuria e tyre i ngjante një kulle. Kur u takuan, një dritë vezulluese nuk iu nda faqes së malit për gati njëzet e katër orë rresht. Nuk do ta besoni, por takimi i tyre nuk ngjan me asnjë nga takimet tona ose e thënë më mirë është takim mbi takimet e tjera. U shkrinë në një masë të vetme, asnjë grimcë tjetër nuk u gjend më përreth trupave. Takimet që pasuan i rrafshuan mushkëritë dhe velëzat fare, çdo

herë mbeteshin pa frymë. Aq shumë vuajtën, u tretën derisa u mësuan me praninë trupore të njëri-tjetrit. Më vonë fituan dhe pak kontroll mbi mushkëritë, aq sa Roza një ditë ndjeu se më në fund venolat e saj u mbushën si një fshikëz e vogël me ajër. Kur këqyrnin njëri-tjetrin dhe prekeshin i tejkalonin të gjitha çiftet në orët e tyre biologjike. Mbase nga gjendja e pastër natyrore pas pllenimit lindnin kërkesa të tjera. Roza ia kishte zbrazur trurin dhe ishte ulur në vend të tij këmbëkryq. I kishte përzënë të gjitha lidhjet e tjera me botën. Si me thënë ishte zhdukur.

Kush e vrau Rozën?!

Në një ditë të ftohtë dimri, mes drurëve ndanë rrugës së ngushtë që të çon te lumi i vetëm, i cili lag atë vend të harruar, Roza ndiente një gjë të mangët së brendshmi, më shumë se e mangët ishte një masë e kalbur, që sapo hapte gojën kutërbimi të mbyste. Në qoftë se do ta shikoje si lëvizte mes degëve dhe fshihej, dikujt i fshihej, për të mos thënë vetes, do të mendoje se diçka e mirë i kishte buruar nga vende të fshehta e të panjohura.

Para disa ditësh, diku nga mesi i tetorit Rozës i kishte ikur shpirti nga trupi. Kjo është diçka më e keqe se përfytyrimi i një fryme të ajërt që kryesisht ngjitet ose fluturon. Kishte gjasa që kishte marrë rrugën buzë lumit dhe kishte ngecur si hije mes drurëve. Kishte ditë të tëra që ethet nuk po i binin dhe shfaqja kryeneçe e vdekjes, pa asnjë paralajmërim, po e mbante peng në një vend të fshehtë për syrin, për syrin vrasës. Dy muaj lënguan një trup në shtrat e një shpirt në lumë.

Dy funeralë u bënë në këtë ditë të ftohtë dimri, mes drurëve ndanë rrugës që të shpie në lumin e vetëm të këtij qyteti. Njerëzit, të gjithë të ftuarit në dasmën e tyre, varrosën trupin e Rozës, zogjtë atje mes shelgjeve shpirtin e saj.

AMAJI

Quhem AMAJI!

Ka një shtrirje të gjerë lumturia në jetën time. Gjindja është në qiellin e shtatë, gëzon jetën e përditshme e nuk i del asgjë e pakapërcyeshme dhe e vështirë. Për mua kjo i ka të gjitha shanset të ndodhë, edhe në qoftë se vjen ndonjë mundësi ta prishë, unë e kam merak vetë ta zhbëj, ashtu siç kam bërë deri tani. Kjo nuk do të thotë se s' ndihem e kërcënuar dhe nuk kërcas dhëmbët nga frika, nuk kam konflikte, por edhe në m'u tektë të dua armiq nuk kam ku t'i gjej, madje dhe po të kërkoj në të ardhmen time nuk mundem, nuk do të ketë. Në të vërtetë jo se unë kam qenë po kaq e dëlirë sa mund t'ju dukem. Gjetiu rri fshehur e vërteta. Ama, gjithçka tani është e bukur, tetori ka zbritur nga viti dhe njerëzit po mbeten gojëhapur rrugëve, të çuditur dhe, pa dyshime. Sa mirë ka punuar ora për mua.

Pamja ime e paqtë s'ju shlyhet nga sytë. Kam filluar të bëj gjysma gjërash, u kthehem gjysmave të tjera të pabëra e nuk ngurroj fare të jem Amaji. Ngurrimet e mia mbeten të hapura jo vetëm për pak, kot eci rrëzë mureve me frikë dhe turp sikur kam vjedhur. Njerëzia ka hapur zemrat dhe pret të mirat e pafundme të jetës sime, madje burrat dhe gratë dërgojnë arritjet dhe lumturitë shpirtërore në të gjithë universin.

Fqinjët, nga qytetet e tjera, nisin politikbërjen e tyre për të rritur cilësinë e standardin e lumturisë duke na u referuar neve. Ngaqë jetojmë në dritë dukemi të gjithë të bukur, jemi veshur me finesë e klas si për në skenë.

Njerëzisë i shkëlqejnë sytë nga mosnjohja e pushtetit, të gjithë jemi të ndershëm të lumtur.

E kam shumë të vështirë të trishtohem, nuk mundem për asnjë çast të mbetem e mërziut, e në ndodh dhe ata të politikës së përtejme nxitojnë për t'më lehtësuar, e hanë mërzinë time si zogjtë grurin në arë.

Unë jam e lumtur dhe quhem Amaji, kam shumë kohë që mendoj të jem më shumë se sa jam, të jem dhe dy Amaji. Natyra organizohet bashkë me prindërit e mi dhe më lindin prapë mua, më krijojnë në dhjetëra Amaji. Toka ku unë kam shkelur dhe ku rri është pjellore. Ujërat e ushqejnë. Njerëzit, dhe ata që kanë vdekur, të gjithë pa përjashtim më ushqejnë. Ata që do të lindin janë adhuresit e padukshëm e të shumëpritur të jetës sime.

Unë i kam njohur të gjitha të mirat e jetës dhe jam shumë e lumtur që nuk ka një tjetër.

Quhem Amaji dhe çdo përsiatje për të thënë të vërtetën nuk e njoh, por unë gjendem në mijëra Amaji, në miliona e miliarda Amaji.

1 Kjomë- lëngu i ëmbël që lëshon kumbulla e qershia.

Çorobojka ia ngjita unë se, me siguri, ajo kishte emër tjetër. Tjetrin e lashë pa emër. Sa e pashë, ai u mblodh kruspull sikur të donte të humbte brenda vetes. Ishte hija, ose një mënyrë e re e tij për të shprehur gjendjen në të cilën ndodhej. Qimezi, me ndonjë kaçurrel aty-këtu, trupin e ngrehur, sy të zjarrtë, pamja krenare, e kreshpëruar, si prej një inati të çuditshëm, koka e gdhendur enkas si me daltë fisnike që, hera-herës, bjerrej pikëllueshëm e që befafshfaqej kërcënueshëm, sidomos kur përvishte buzën e sipërme, me një lakim elegant e ku përvijohej shpotitëse në mënyrë të habitshme, me gjithë atë përhedhje e rrotullim elegant rreth vetes. Më tërhoqi e më mbajti pezull. Qafën e kishte të fortë, dukej, me atë qime që bënte dukje, t'pamë, pas asaj lëkure të shndritshme që s'mund të mos përfillej. Mbete i shtangur para tij dhe s'ngopesha dot duke e parë!

Kur ja tek çatisi ajo, eleganca tjetër, Çorobojka, sikur një dorë jo tokësore e solli para meje edhe atë. Ndonëse ngjyra e qimes ndryshonte, një e kuqe fund e majë flakëritëse, i jepte një paraqitje të tillë që të rrëmbente menjëherë. T'i ngulte sytë dhe nuk t'i largonte kurrë, sikur do t'i fshihte ata papritur e pa kujtuar diku brenda vetes, mirëpo, siç dukej, s'donte që ta bënte këtë. E gjithë kjo skenë m'u duk zbavitëse gjer në dalldi, sidomos përulja e saj aq e harmonizuar me gjithçka, një sjellje pa truk dhe që të bënte për vete, megjithëse, siç kuptova më pas, s'kishte fare kujdes, që edhe donte edhe s'donte, ashtu e përhuruar, pa kurrfarë ndrojtjeje, që të afrohej pa e prishur fare gjendjen e krijuar që në shikimin e parë, gjersa erdhi ky çast që i dhuroi dritë dhe prej saj më fitoi zemrën.

Ai, në fillim me delikatesë, të cilën për çudi e zotëronte admirueshëm, iu afrua, duke bërë një belbëzim që natyrisht s'merrej vesh, po që tingëllonte bukur. Pas pak ai u qeshi i tëri, u argalis përbrenda që iu shfaq në sy, pa kurrfarë maske, por me një tis mjegulle që nuk e shmangte dot nga pamja e tij, duke e fshehur synimin që megjithatë shfaqej teksa largoheshin disa re shqetësimi të përkorë. E mati tjetrën dhe iu duk se ajo e pranoi shikimin e tij dhe, ngjyra e kuqe, madhështore, herë i bëhej si e djegur, e që, po brenda atij momenti kthehej në një nur që të mbante mbërthyer, sidomos shikimi kërkues kaq shumë hamgjitës, ku bënin xixë sytë e mëdhenj përplot tundim. Ai e quajti diçka të arsyeshme t'i hej sikur donte t'i thoshte një të fshehtë, gjithnjë në një stil lozonjar e përkëdhelës, ashtu siç i kish ndodhur me të tjerat, kur bënte edhe si i cofur po ta donte puna, të shtirej pse jo si i plakur por gjithnjë pa zhubra e rrudha, duke tundur madhërisht bishtin, por që kuptohej se ruante fshehtas pyetje tronditëse, sa ajo, dora vetë, po ta dëgjonte me vëmendje do të bëhej tjetër gjë brenda atij momenti. Ai dukej krejt i gatshëm ta merrte në këmbët e përparme, ta ndukte e ta rrokulliste, duke u përpirë i gjithi në një frymëmarrje të ndezur, me frikën se mos pëshpërimat do t'i derdheshin përurshëm si një rënie nga gryka e shishes. Siç po ia shoh huqin, ka për ta gjetur kunjin...



ÇOROBOJKA

Tregim nga Xhevair Lleshi

Dhe gjithmonë po ajo e qeshur në sytë e tij prej djallushi, që dukej menjëherë se i kish rënë në kokë, përzierë me pak naze nga ato të flamosura që ta largonin me magji ndrojtjen. Këmba e përparme e ledhatoi në qafë, pastaj si të qe nginjur nga një gjendje e zbrujtur prej një furie të shkurtër, e hoqi dhe afshi i tronditur gjer në rrënjë iu bë i hatashëm, si diçka e fshehur por ama ulërinte pangopësisht e s'binte në fashë gjersa ai të shkrehej i tëri. Atij i kërkohet të qe para saj fjalëmbël, i dhembshur, i qeshur, përplot humor, që ta bënte atë të shkrihej, të tretej, aq sa t'i mbante brinjët me dorë, e tunduar gjer në fund, pa u shkrehur para kohe. Gjë që do të shkaktonte kaq shumë dhembshuri! E shikonte Kuqen elegante dhe i hipte në kokë ta bënte copa-copa, ta kollofiste, po pastaj menjëherë e mblidhte veten, donte që rrëmbimthi të flijonte diçka për të, pa e kuptuar shkaku, veç ashtu kot, vetëm që atë çast magjiplotë ta zotëronte gjer në fund. I tundte bishtin me një përkëdhelje që do ta rrafshonte këdo tjetër, do ta nënshtronte po se po, madje edhe ta bënte që ta përkëdhelte edhe ajo, me frymë, me shumë fisnikëri dhe doemos me sy të zjarrtë. Por ajo paskej qenë krejt e ftohtë, duke mbytur ndijimin që për çudi i shkonte aq shumë dhe që e tregonte tejet bindëse, përplot sharm, gjithmonë mendjeprishur. Pastaj ajo duhma e saj ishte e një lloji të veçantë, ku hunda e tij e hollë mund ta dallonte qartë si një aromë tejet ngacmuese, gjë që i zgjeronte flegelat, rrjedhjen e shpejtë të gjakut dhe, megjithatë, të ndihej më i freskët.

Ç'ishte kjo magji e fshehtë aty rrotull që e ndizte flakë si një molisje e ëmbël dashurie që s'mund të arrihej dot kurrë? Kjo pyetje ia qëndiste edhe më bukur gjendjen ku e pruri fati, (duket se ai gjithnjë ia priste rrugën asaj!) ndërsa s'i shpëtonte dot afshi ndjellës që dilte prej atij trupi. Ai qimezi, mashkull i vërtetë, i

qeshur, me sytë e mëdhenj plot dritë, me trupin e fortë gjithë muskuj, që i bënë majë lakmueshëm e që dukej sikur do të shpërthenin jashtë, mori një përkëdhelje të befasishme, ia thithi aq fort sa, pastaj iu bë se po dridhej si purtekë. Atij i dukej sesi ajo do ta përfshinte në këmbët e saj të përparme, do të dhelej pa fund, do t'i fërkohej me vështirimin gjemba-gjemba që të fuste shtatë pashë në dhë, sikur t'i pëshpëriste me zjarr ca shprehje rrëqethëse. Por nuk ndodhi një gjë e tillë. I erdhi rrotull, iu fërkua plot gafrim e mburrje, sa që atij do t'i dukej një delikatesë e përkryer, një ëndje e paparë, që më pas do t'i pëshpëriste gjëra të bukura dhe që me siguri kjo do të ndodhte përsëri e përsëri. Pati një ankth të befasishtëm... sa që nuk e mbaroi atë që i erdhi ndërmend dhe gati u mbyt. Të fillonin një bashkim, së s'bën, me përkëdheli, patjetër me përkëdheli! Ai, qimezi me nam, me një bukuri që i detyronte të gjithë të binin përmbys, pse ta çonte dëm gjithë atë parfum dehës, ta shijonte si duhej të paktën, pa le të përmendej kudo nëpër rrugë, i kafshuar, i përthithur, i ndezur e tërë erë, t'i hidhej përsipër, pa ajo le ta shtynte lehtë e duke i pëshpëritur...

Pëshpërima të nxehta natyrisht, të kreshpëruara, që digjeshin mbytur gjer në fyt e që ia shtrëngonte në grykë, e ligështuar prej keqardhjes. Ai do ta ndiente si njëfarë përçmimi për këtë dobësi të shenjtë, që ngjallte papritur përkujdesje të veçanta. Po në kohën që ai po bënte përpjekje të kota për t'ia thënë në vesh ato që i trazoheshin në kokë, mes asaj batërdie lutjesh që s'kishin fund, një dhëmb i mprehtë e bëri të ulërijë pa zë, e shkëputi prej saj me furi, u bë gati madje të angullinte nga dhimbja. Ajo u hepua paksa me një hijeshi tërbuese, përposh, si duke qeshur, e mbuluar me një duhmë përvëluese prej shqetësimit, u bë gati për një akt therorie. Ia pa inatin më tepër sesa dhembjen. Asaj po i gurgullonte e

qeshura elegante, pa u spërdredhur dhe pa u lajkatur, por me një hijeshi përplot tharm. Dukej se po i vinte keq, por që ai që e detyroi t'ia ngulte atë dhëmb të mprehtë. Atij i përcëlloi shikimi i saj, po sytë, amà, sikur i luteshin që të duronte ca...

Befas pështyma iu tha, goja i mbeti e hapur prej dhimbjes, mërisë dhe dalldisë që e kishte aq pranë dhe s'po ia gjente dot anën. I erdhi në kujtesë një trill. Një mënyrë tjetër, me një lloj trishtimi që të bënte për vete. Me siguri do të bënte efekt tek ajo nazelie që po ia hante kokën. Po, ky kish për të qenë një stil i hatashëm dhe këto lojëra instinktive ai dinte t'i bënte me sy mbyllur, pa iu shqitur asnjë çast. Do të vinte një moment, i thoshte kujtesa e tij e shkurtër, që nga kënaqësia do të bënte sikur ta kafshonte në qafë gjoja me egërsi e trimërim që, si gjithçka do tretej e do humbte kot. E ndjeu që ajo donte të ulërinte prej dëshirës, por nuk e jepte veten. Atë kohë të prerë pati një gjendje dehëse. O, ç'ditë e bukur ishte! Diell pranvere dhe frynte fllad i lehtë. Gjithçka përreth ndrinte dhe ajri i qiçërimtë bëhej më ndjellës. Ah, pëshpëriti, do t'i përmbushej më në fund dëshira e tij e mbuluar me hir, aq çuditshëm sa askush s'mund ta merrte vesh thellësinë dhe të bukurën e saj. E vendosi: do t'i pëshpëriste me drithërimë: e bukura ime si askush tjetër, e bekuara ime plot naze! S'do ta harroj kurrë këtë ditë me diell të bukur! S'ka tjetër si ty! Ajo ia preku shkarazi këmbën e parë, me kthetrat lëmuar, por si gjithnjë me një ashpërsi për t'u admiruar. I ndjeu pëshpërimat e tij edhe trimëruese, edhe lutëse, gati të bënte gjithçka. Dhe ndjeu se do të qe më mirë të përvëlohej, pastaj, pastaj ta mbyllte të ndrysur në guaskën e saj. Atëherë t'ia shihje sa i vlente lëkura!...

Ti të ndjell e të përmbush dëshirën, po edhe unë ama! Deri tani është vetëm kocka që lëpihet, me shijen e instinktit, se shuhet uria, po ja ku m'u shfaqe ti dhe unë mbeta pa gojë. Po më lë pa mend... E ndjeu edhe vet që mori një shkëlqim ngashënjyes, i kreshpëruar si prush zjarri, as parë e as dëgjuar! Kur jam para teje s'di sesi pësoj një tronditje të madhe, më bëhet si një kënaqësi e fundit që ta falin e ti s'e di ende. Ajo i pëshpëriste në gjuhën e saj (ai këtë e kuptonte, por ja që trembej!), bëri gjeste pranë tij, i dolën djersë dhe pastaj, krejt papritur iu përkëdhel gjithnjë me sy të qeshur e nuk pushonte së luturi, donte ta kafshonte sërish por e la le, i erdhi keq ndoshta, ndërsa ai, solli në kujtesë të sillej edhe si sarhosh, edhe si i bytymtë, le të dukej tuhaf e teveqel, pa ditur pse ato bëheshin prej kësaj sjelljeje dhe gjendjeje të krijuar me një keqardhje të afuar e të nënshtruar, madje me një tjetër spikatje. Po, kjo do të qe një maskë triumfuese! Me siguri që do të përfundonte bukur. Tërë këtë pamje të tij, ajo e çmoi të shëmtuar, por nga ana tjetër s'mund të mos e bënte buzën në gaz. As këtë çast ajo s'do të harronte, sido që harresa i duhej mjaft...! Mirëpo menjëherë e mblodhi veten duke u skërmitur dhe se e ndjeu që i ishte zgjuar bisha përbrenda. E dinte ç'ndodhte pas furisë së parë të këtij bukuroshi, por ja që ajo i jepte zgjidhje duke u bërë më melankolike, sikur pendohej, e ligështuar nga padurimi...

Por, dale pak, a mund të nënshtrohej ajo? Kurrë! Ta harronte! Kushdo të ishte. Le ta mallkonte ditën që u takuan...

Po duhma e saj? Çfarë mrekullie! Shqisa e tij e nuhatjes qe e përsosur. Por duhet pranuar se të dy e lakmonin njëri-tjetrin. Oh, ç'sy po e shihnin! Llavë vullkani që po rroposte gjithçka. Jam i dhënë me mish e me shpirt pas teje, të dukej se pëshpëriste ai, si për t'u shfajësuar, me pamjen gjithnjë të mjerë e të qeshur, pa e hequr shpresën, përplot ngashërim e duke mbajtur sytë ulur. Ajo nuk bëri shenjë, as edhe të shtirej për mirësjellje. Se e tillë do të quhej: *mirësjellje...* U kthye me shpinë nga ai, lëvizi këmbët. Qimeziu i ndritshëm, i përkëdhelur nga fati përfytyroi se po i përgjunjej, se po e lëpinte me një drithërimë të pa treguar dhe doemos s'mund të ndodhte që ajo të mos e ndiente, do ta fërkonte, do ta kafshonte paksa edhe me hijeshi të rrallë, që atij i përshtatej aq shumë, pastaj dalëngadalë do të zbutej (do të zbutej edhe ajo!), do lëshonte një psherëtimë të shpenguar, si bukuri e rrallë, do t'i binte ankthi, i cili do ta çlironte prej etheve, do të zgjaste këmbën e parë të stërvitur dhe do t'i lëmonte kokën, do të bënte një lëvizje të hapur dhe e tërë pamja e tij mashkullore do të merrte ngjyrë trëndafili...

Ndjeu menjëherë dhimbje në kokë, i theri fort, mbase nga një presion i brendshëm, ose prej një ndezullimi të beftë që e përvëloi! Çfarë torture! Një ngjethje si kjo s'e kish provuar kurrë, po ama qe fort e ëmbël, duke e trallisur pa anë e fund. Kështu... Po ajo me bisht të syrit e vuri re dhe s'e la t'i shpëtonte nga dora. Ngjitur e ngjitur, duke e fshehur aq mirë hallin, me maskë e pa maskë, me hirin prej mashkulli të vërtetë, si gjithmonë, përpiquej dhe nuk dilte dot nga gjendja e tij, siç merret me mend, gati doli nga vetja... Ah, të duronte dhe pak, t'i shikoja gjer në fund dhe le të mbetej aty me kokën në gjoksin e saj... E ç'më duhej më jeta? Por s'qenka e thënë! Po më duket se nuk do. Po mirë... Fundja një ditë edhe ajo do të dojë... Ja, me këto trazime ma heq petullën, madje duket se po më jep shenja që të gjej më mirë një tjetër. Le të plaste nga zilia pastaj, po ja që trembej se mos bëhej vetë për t'u ngushëlluar...

I pashë dhe s'di pse më erdhi keq për të. Çorobojka e djallit, mendova, ajo të çon në shtatë kroje dhe s'të jep ujë. Edhe e do, edhe tallet. Po, Çorobojka do ta kish emrin! I njoh mirë se ç'janë çorobojkat. Përgjërimi i ndezur dhe elegant i Qimeziut m'u mblodh si tënk në gjoks, m'u ngurtësua. Ku vajtën gjithë ato hovje, përkulje, pëshpërima, sjellje që ia shtonin vlerën forcës dhe dëshirës së papërmbajtur... Dhe më erdhi keq. Ajo, qimekuqja, madhërishtëm e me sytë për tokë, me bishtin gati zvarrë, pa i dhënë kurrfarë shenje, po largohej. Nuk e ktheu kokën pas. Ai mbeti aty si hu, nën diellin pranveror. U largova dhe unë... E ktheva kokën pas. Ai aty, i ligështuar, si leckë e hedhur. Si qyq. S'më besohej që ai të qe dashuruar dhe për këtë arsye qante aq bukur, me një fisnikëri të rrallë. Thua ta tërhiqte era e saj? Ndoshta. Po, kjo erë është ajo që i tërbon meshkujt. Tani s'ka më shije asgjë për mua, dukej se më vinte pëshpërima e tij e nxehtë...

Dhe nuk i pashë më.

në shtegëtim, muzës...

në ato hapësira ku puthja bëhet e lehtë si një kupë me dashuri ku sytë e tu reflektojnë atë ç'ka në shpirt e ngjiz dhe e hedh tutje mbi rë të gjejë prehje atje ku poetët për dhimbjen e ikjes shkarravisin vargje me rimë të çrregullt dhe dashurohen me gjakun e krishtit pas syve të një muze që ngjitet lart qiellit e pas saj mbetet shkretia

erotika e parë '23

mishërat e tua shpërhapen si hapësira në madhështinë e Saharasë mbuluar me jorgan prej fryme ardhur nga bota ku jetojmë ne nëpër rrethinat e trupit tënd gjarpëron jeta pa pengesa përditshmërie me një duhmë avulli të nxehtë si puthje djaloshare në dashuri të parë tek heshtja e vargjeve mbyll zemrën poeti me një grusht dallgësh prej rimash të mbetura pengje të frymëzimit shtrirë si trupi yt tek drita e hënës që xhelozon së larti madhështinë tënde

rregulli i jetës kur ti nuk je

ditëve shkoj revan s'di se ku mbrëmja tretet në pak vargje mbështjellë me pluhur në xhep të thellë të palltos që të mbron nga trishtimet

ditëve s'di se ku shkoj vetja tretet në mbrëmje kur di se ti frymon ende aty në atë formë çrregullsie por që mbetesh vetëm ti

mbrëmjet dhe vetja treten tashmë kur padashur vë mbi të gjitha rregullin e jetës dhe ti zhdukesh dhe në humbëtitirën e xhepit tim s'lëndohet nga gishtat e mi poezia

mbetesh vetëm ti

◆◆

u putha me dhimbjen si të ishe ti buzët qenë po ato të mishtat e nxehta si puthja e parë

u putha me dhimbjen si të qemë puthur të dy në ëndërr gjithnjë gjithnjë të pandarë

◆◆

në mishrat e buzëve të tua thellë thellë në ngrohtësinë e trupit tënd në ndërkryet e këmbëve tua në trishtimin e lotit tënd në dritën e syve tua një poezi për të ngjizur jetën

syte e mikut tim

dhe shfaqen në të errtën e natës dy sy të mëdhenj sa një botë që s'fle

shfaqen në të ftohtë pa të dridhura prej ftohtit

RREGULLI I JETËS KUR TI NUK JE

Cikël poetik nga Rei Hodo



shfaqen në të nxehtin e gurtë pa gulçim të frymëmarrjes

shfaqen aty dy sy të mëdhenj dhe s'di a fshihet një botë pas tyre por sa një botë të mëdhenj

dhe shfaqen në errësirën e natës në një poezi dy sytë e arkëmortit tim mikut tim të të gjitha kohërave

◆◆

qyteti mbyll sytë në orën e vonë

heshtohen rrugët dhe qoshet që ditën puthjesh mbajnë aromë zbrazen ëndrrat nga hapat në trotuar

zhvishen pemët në orën e vonë dhe gjethet fluturojnë lehtë si ajo pelerinë mëndafshi që zbulon hiret e tua në mbrëmjen e dashurisë

qyteti mbyll sytë jo përgjithmonë kur e ndjen se ti fshihesh në një kthinë të tij dhe prej andej ti zgjatesh deri në pragun e hënës

qyteti përgjithnjë sytë s'mbyll

heshtohen ëndrrat në garderobën e vjetër trishtohet dashuria në dehje me një kupë trishtim

qyteti s'përgjumet dhe s'përgjumesh as ti që në kthinë të tij zgjatesh dhe zbret nga hëna për të mbetur personazhi kryesor në këtë poezi

◆◆

në fronin e mbretërimit të shiut shpatullat e erës mbrojnë të ardhmen e nesërme në qytet

në dhomat e suflerëve dashuri bëjnë maskat e heshtura

spektatorët shijonin duartrokitjet

tashmë bëjnë shtrat në dashuritë e tyre skena ka mbetur e ve pa personazhet kryesore

në fronin e mbretërimit të shiut gjëmojnë gjinjtë e tu të fryrë ardhmëria në trupin tënd të lëmuar në buzë të nxehta ku ngrohen shpatullat e erës

në fronin e mbretërimit të trupit tënd bëjnë dashuri të gjitha dashuritë

maskat në heshtje mbysin gjumin e vetmisë aktorët bëjnë dashuri në shtrat me dashuritë e tyre pa skena të roleve kryesore

skena ka mbetur pa personazhe aty gjallon silueta e trupit tënd në fronin e mbretërimit të lakuriqësisë

◆◆

me dhimbjen time bëj dashuri si në dashurinë e parë

ndoshta kam harruar të dashuroj si në dashurinë e parë

me vetminë time e gjej veten në pije netë të gjata netë të ftohta si në dashurinë e parë

me detarët zgjoj mëngjeset e mia në fronin e detit buzë pushtetit të valës e me një ushtri me nimfa njëjtë si në dashurinë e parë

me poetët zgjoj mbrëmjet e vetmuara zgjoj mbrëmjet me trishtim të hidhur vargjeve si në dashurinë e parë

me dhimbjen time bëj shtrat duke dashur pafund portretin tënd duke i folur trishtimit për portretin tënd

me dhimbjen time bëj dashuri si në dashurinë e parë

KOLONËT EMI

Prozë nga Bajram Sefaj

Djaloshi i ri, shtatlartë, flokëzi, sy verdhë, vetull-hollë e lëkurëbutë, buzagaz gjithnjë, pa fije hileje e urrejtje ndaj askujt, fytyrë toke, kolon malazias, rastësisht takon gocën e re shqiptare, drenushe e ndrojtur mali, bime e re, pa e parë as vrarë syri i keq i askujt. Pa e ndërruar asnjë fjalë mes veti, meqë asnjëri nuk e kuptonte gjuhën e tjetrit, mbërthyen e lidhen fort, shikimet. Nga ndeshja retorike e heshtjes, shkrepin një vetëtimë e rrufeshme deri në kupë të qiellit. Pa asnjë fjalë goje, lidhën me forcë duart dhe, u nisën me vrap.

Si të çmendur!
Për ku nisën!
Në ç 'drejtim!
Drejt ishullit të panjohur!
U nisën për atje larg!
Të mbjellin legjendën e re!
Mbi një dashuria të ndaluar...


*

Mungesa ose "zhdukja" e tyre, u zbardh. Rrufeja plasi e zbërtheu: u mor vesh se Ajkuna, bija e konakut më të njohur në Podgur, iku! U martua me djalë e kolonit Stanishiq, kryefamiljar, instaluar si kolonë fshatin Vitomericë. Për këtë ndodhi pa presidencë, të rrallë dhe të papritur, merr vesh krejt bota! I zoti i shtëpisë së madhe shqiptare dukagjinase, po ashtu. Plaku i mençur e fisnik, Bardh Shaljami, n. Në çastin që i erdhi haberi se Ajkuna, e bija e djalit tij të madh, Hazirit, ka rënë në dashuri dhe është martua djalë të ri kolon, plaku Bardh hoqi plisin, kroji kryet, pështyu në hi e, nga çibuku prej qelbarit, po nja një metër e kusur i gjatë, thith një tym idhnak duhani, pushoi një çik, mori frymë thellë dhe, priti e tha: hair qoftë!

*

(*Gjithnjë duke u mbështetur në dritën e fortë të murin ngjyrë bardhë të romanit "Zogjtë e Qyqes" të shkrimtari kosovar, Gani Mehmetaj, kjo vepër e të cilit, u nderua me çmimin prestigjioz letrar "Kadare", si romani me i realizuar ir vitit 2020).

Gaillard, 05.02.2023



JO MË "ITALIAN JOB"

Nga Arben Dedja



Këtu mund të lexoni disa poezi të miat që **nuk** janë përmbledhur në vëllimin "The Italian Job" ("Onufri", Çmimi "At Gjergj Fishta" për poezinë 2022). Po pse nuk janë përmbledhur? Sepse tek ai libër kanë zënë vend vetëm poezi të shkruara në Itali vërtet, por në shqip. Titulli nënkuptonte një akt (të shkruash shqip në dhe të huaj) të kryer jo nën dritën e diellit, një si aferë të pisët, do të thoshim. Tani "The Italian Job" po quhet nga shtypi botëror afera e korrupsionit që ka përfshirë Parlamentin Europian, në raportet e tij me Katarin, Marokun e vende të tjera ku shkelen të drejtat e njeriut. Ndaj autori, kur ia shqipton titullin librit të vet, ndihet një çikë në siklet dhe... i habitur. *Kështu që iu kthye vesit të tij të hershëm*: përkthimit – ves adoleshence edhe ky, gati po aq i hershëm sa ai i krijimi të poezive origjinale. Vetëm se kësaj here është e kundërta: iu desh të përkthejë veten nga italishtja në shqip, situatë gjithsesi e çuditshme, por e domosdoshme. E kush tjetër do ta merrte mundimin? Ndërkaq, kur e bën këtë gjë me vargjet e tua ndihesh ku e ku më i çlirët e i relaksuar: ia lejon vetes *çdo* "deformim" të origjinalit. Dhe, sidomos, pyetja është më legjitime se kurrë: *në fund të fundit*, cili është "origjinali"?

Pleqëria

Pas darke
ngjëruam pak raki mani
me arra të forta gur.

Isha mysafiri më i lartë
ndaj për të fjetur më liruan
shtratin martesor
shtruar
nga duar të padukshme.

S'e di ku fjetën
të zotët e shtëpisë
por pati një efekt domino
dhe nëna plakë
e verbër përfundoi te pragu
me qenin.

Ora e banjës

Tartabiqe
mos hyr
në dhomën e çupës sime
që myshk kundërmon e ftua.

Na u desh me thikë
ta prisnim avullin
niseshteja e orizit nuk mjaftonte
për shkojat e lëkurës së saj.

Larg prej ziftit e shinave
akuarelë të çelët janë shpëndarë mbi qilim
pa pyetur për krehëra e karfica.

Shko
te tryeza ime
ku pena e lapsa
si korparmata hitleriane
rrinë në radhë
bukurinë e shkujdesur të botës
ende për ta shpikur.

Eros & Thanatos

Rrinte për muri i mbështetur
pranë plehrave dysheku
(flakur në gjendje aq të mirë)
që ne dalëngadalë e zvarritëm
prej anës së vet më të gjatë

vizga e kërmijve pasqyronte
hënën e plotë na rrëfente
rrugën për në kampus dhomës
sonë të ngrohtë ku mbi
dysHEME e mbështetëm na duhej
për të bërë dashuri edhe pse
ndonjëri aty paskësh vdekur.

[Me falangje të shkathta]

Me falangje të shkathta
nga jaka
një flok seç hoqe.

Thinjen e tij
prapë munda
gëzofit të zi ta pikas.

Qe m'e rëndë
se kjo pallto dimërore
qullur nga shiu
budallisht në modë.

Një burrë po pshurr...

Një burrë po pshurr pas një peme
dhe bën të fshihet tek andej kaloj.
Është pema e vetme e mëhallës.
Prapa, një radhë Bencash gri
me xhama t'errët e rathë të shkëlqyer
njëri syresh e ka rrotën të lagur
por e ka bërë me siguri një qen
jo burri i fshehur pas pemës.

Arra

Djelmosha të fortë ngulin tre shkopinj
dhe shtrijnë një çarçaf e lidhin
shkopinjsh këndin e katërt
në trungun e manit se e dinë
që do t'ia behë era e mëngjesit
kokrra mani mbi çarçaf të lëngshme
të ngjitshme të ëmbla vese
do të ngjërojnë freski e mërzitje
do t'u bien në kokë ç'i rrëmbekan
pastaj shkopinjte për të rrahur
atë plakën të pacipën veshrënduarën
arrën.

NATË

Poezi nga Giovanni Pascoli Përktheu Ilirian Dahri

Poeti italian Xhovani Paskoli (**Giovanni Pascoli**. San Mauro di Romanja 31.12.1855 - Bolonja 06.04.1912), është një prej autorëve më të rëndësishëm të letërsisë italiane dhe bashkë me Gabriele D'Annunzio është cilësuar si poeti dekadent më i madh italian. Braktis Kolegjin në Urbino për të frekuentuar Liceun Klasik në Rimini dhe falë një burse studimi fillon Universitetin në Bolonja ku ndjek edhe leksionet e Karduçit (Carducci). Fillon si mësues i greqishtes dhe latinishtes dhe më pas fillon si pedagog në Universitet. Në vitin 1891 boton përmbledhjen e tij të parë poetike *Myricae (së cilës i përkasin poezitë e përkthyer)*, në 1897 *Poemat* dhe në 1903 *Këngët e Kastelvekios*. Paraqitet si një poet i vetmuar dhe jo shumë i interesuar për poezinë europiane duke qenë në të njëjtën kohë mbështetës i figurës të njeriut të thjeshtë. Paskoli e sheh poezinë si një fole që e mbron nga bota përreth dhe kjo shfaqet edhe në poezitë e tij me motive nga fshati, ku mbretëron mjegulla dhe qetësia e shoqëruar përherë edhe me një dritë përendimi të diellit duke dhënë në të njëjtën kohë edhe shpirtin e poetit që paraqitet shpeshherë i trazuar dhe me pamje dramatike.



MBRËMJE TETORI

Ndanë udhës shihen mbi gardhe tufa të purpurta dëllinjash lojcake: arave të lëruara kthehen në grazhde lopë përtace.

Vjen udhës një i ngratë që të avashtin hap zvarrit ndër gjethe vjeshtore: arave një vajzë ia merr mes erës avazit: lule gjembore!...

DIJA

Ngjitej mendueshëm majës së vetmuar ku folenë e saj ka shqiponja dhe burimi, dhe qendra e largësisë së errësuar rri, në çaste reflektimi.

Oh! vëzhgon përreth të panjohurve hone: ku sa më larg syri i mendimit të shpjerë, më pranë avitet ajo që percepton: hije dhe mister.

LËROJNË

Në arë, ku e kuqerremtë mes rreshtit ndonjë gjethe hardhie ndrin, dhe shkurret thuaje nxjerrin tym nga mjegull e mëngjesit, lërojnë: me britma të avashta, njëri të ngadaltat lopë shtyn; tjetri mbjell, një tjetër godet me të durueshmin shat të tij brazdat; dhe ndërkaq zogut të sprovuar zemra i gëzohet, e gjithçka përgjon nga degët e zhveshura të manit;

dhe gushëkuqi: nëpër gardhe dëgjohet tringëllima e mprehtë e tij si ajo e arit.

VETËTIMA

Dhe qielli dhe toka u shfaq siç ishte: toka dihatëse, e nxirë, lëkundëse qielli i rënduar, tragjik, i mjerë; bardhore bardhore në heshtjen trazuese një shtëpi u duk u zhdruk përnjëherë: si një sy, që, i zgurdulluar, tërë tmerr; u hap u mbyll, natës së zishme.

BESIM

Kur shkëlqente e purpurta mugëtirë, dhe selvia dukej ar, ar i kulluar, nëna i tha të voglit bir: Atje lart është krejt si kopsht i zbukuruar. Fëmija fle, dhe ëndërron degët e arta, pemët e arta, pyjet e arta; ndërsa selvia në natën katran përpëlitet në erë, qan në tufan.

NATË

Ulen vashat në qerthuj gumëzhitës. dhe bishtuku kokat e verdha i praron:

kokat e verdha, sytë e zinj yjendritës nga dritarja herë pas here i çojnë:

presin ato kalorësit shtegtarë që terrin e zëshëm kaptojnë?

Flasin për dashuri, për fisnikëri, magjistarë: e duke folur në pritje të aurorës qëndrojnë.



GOGOL

Tregim nga Shpresa Qeriqi

Në orën tetë pa një çerek, kur Arbani po përgatitej për të shkuar në punë, ajo nuk i dha as përshtypjen e kryeneçes e as të hidhnakes, por, përkundrazi, iu duk shumë e butë dhe e lumtur. Në shprehjen e bukur të fytyrës së saj nuk shquhej as edhe shenja më e vogël e trishtimit. Vështrimi i dy syve të saj të mrekullueshëm në formë bajame zbehej nga ngritja e vetullave të larta dhe me maje dhe shuhej aty diku në mes të faqeve të bardha. Vetëm hunda shqoi pafajësinë e saj të zënë peng mes vrimave të vogla.

Ai ia vështroi gjatë sytë e bukur ngjyrë gështenje të papjekur, që herë mbuloheshin nga qerpikët e zinj e herë vështronin ngultas me vendosmëri, teksa në faqet e zbehta i luhej një shfaqje ngjyrash të imta si flakërimë shkëndijash. I vinte keq që punët kishin marrë atë rrugë dhe me një ofshamë të thellë largoi nga vetja mendimet e liga që i ngjizeshin nga frika e braktisjes. Pati ndjesinë dhe një shtytje të këndshme për ta puthur në zverk dhe ajo e mirëpriti ëmbëlsisht. E ndjeu se, për një çast, ishte gati ta shtrëngonte mes krahëve dhe e shtrëngoi me tërë fuqinë.

Ai e pati përshtypjen sikur ajo po e madhështonte përqaftimin egërshan duke e detyruar atë ta shtrëngonte edhe më shumë, sikur i kërkonte të zbrazte tërë forcat e këqija që ia dërrmonin qenien, megjithëse në të vërtetë përgjatë gjithë kohës, ajo po i kërkonte ta lëshonte.

Kur më në fund, duke psherëtitë, Lulja kishte liru krahët dhe trupin nga përqaftimi që ia merrte frymën, ngriti kokën me fije flokësh mbi ballë e faqe që ia fshihnin njërin sy, pastaj hodhi vështrimin për nga dritarja dhe drita e fortë e diellit ia picërroi sytë.

Pasi ai i kishte kërkuar të falur duke ia puthur gjunjët në gjunjë, Lulja i ishte betuar se pa-varësisht asaj që kishte thënë ajo në inat e sipër një natë më parë në asnjë mënyrë asnjëherë nuk kishte menduar ta braktiste dhe në asnjë mënyrë ajo nuk do ta braktiste atë. Dhe gjatë kësaj bisede të shkurtër u thanë, natyrisht, edhe plot e plot fjalë të tjera të cilat ia hoqën sikletin. Ai me mendjen e vet e gjykoi sjelljen e shkujdesur të saj dhe përfundoi se ajo nuk po tregonte asnjë shqetësim. Zërin ajo e kishte të pakët por shumë të këndshëm dhe dinte të fliste e qetë dhe me shumë ngrohtësi.

Hijeshia e plotë e shikimit dhe buzëqeshja e sajuar që ia vijëzonte fytyrën gjatë gjithë kohës sa po fliste, nuk e lejoi Arbanin që të nxirrte një përfundim të saktë, pa marrë parasysh kërcënimet që ajo i bëri një ditë më parë. Ai u mjaftua me dëshirën se gjithçka që tha ajo duhej të ishte e vërtetë dhe se nuk ishte hera e parë që ajo e kërcënonte se do ta lerë, dhe prapë e megjithatë për çdo mëngjes ai e shihte tek përgatiste mëngjesin tërë dritë në fytyrë.

Përpara se të nisej, i kishte dhënë asaj një buzëqeshje lutëse dhe ishte kthyer pas për ta puthur. Arbani kujtoi se kjo qe mënyra që ai e përdorte për ta shprehur pendimin, megjithëse këtë herë i kishte tingëlluar edhe atij vetë si aspak shprehëse dhe e pahijshme.

Asgjë nuk e dalloi atë mëngjes prej të gjithë mëngjeseve të tjera.

As ai vetë nuk parandjeu asgjë. Prandaj tek po kthehej në shtëpi ai ishte tërë shend e verë dhe kur pa shtëpinë bosh, sigurisht, atij iu desh gjatë të qëndronte i ulur në kanape me këmbë të kryqëzuara duke dëshiruar që të ishte në ëndërr.

Dhe ja që, e gjitha nuk qe një ëndërr dhe ai tashmë po ngrysej në heshtje, duke vështruar ngultas prej dritares së madhe që tashmë ngjante me një tablo të zezë të zënë peng brenda një kornize të bardhë. Ai vëzhgoi dhe kërkoi me shumë druajtje dhe frikë në kopshtin e shtëpisë një shenjë prej saj. Pastaj rrëmoi sa mundi në sirtarët e shtëpisë dhe nuk gjeti as edhe krehrin e flokëve. Natyrisht që është diçka mjaft e trishtuar dhe shqetësuese, kur një zonjë shtëpie ia mbath në mes të ditës pa lënë asgjë pas vetes.

Ajo në mëngjes i kishte folur me shumë ëmbëlsi, dhe prandaj ai as që e kishte zënë në gojë zemërimin e natës së mbrëmshme, sepse edhe ai vetë turpërohej nga vetja dhe e mbrëmshmja nuk ishte hera e parë që ai sillej kaq keq dhe lejonte që i tërë zemërimi i tij të ngjitej në lëkurën e saj të bardhë.

Mendimet iu ndezën flakë nga një shqetësim i ashpër që i shfaqej edhe mbi vetulla, sidomos, në rrudhën që i ndante ato në mes.

Një gjysmë ore më vonë, pasi një copë herë shkundi krahët dhe pasi i dha vetes një mundësi për të marrë veten duke qëndruar i shtrirë në dysheme me shpinë, ngjiti shkallët për në katin e dytë të shtëpisë, hapi derën katrore të tavanit, lëshoi shkallët e vogla prej metali dhe u ngjit në dhomën e vogël nën kulmin e shtëpisë.

Teksa përkulej për të mos i rënë me kokë tavanit të ulët, ai rrëshqiti gishtërinjtë nëpër dërrasa dhe hetoi ndërpresin për të ndezur dritën. Drita e zbehtë shpërnda grimca të verdha në dhomën e vogël dhe nuk mbushi hapësirat e saj. Kjo ia vështirësoi punën Arbanit që tani kishte filluar të rrëmonte nëpër gjërat e harruara në tavan.

I shqetësuar dhe i pushtuar nga një ndjenjë e çuditshme që ia paralizonte mendimet, sigurisht, ai ra në gjunjë për t'i dhënë kohë vetes që të pendohej, përpara se, me litarin që e hodhi në krahë si një çantë me mbajtëse rrethore të gjendej në kopsht.

A ia vlen të përshkruhen të tjera hollësi të dhimbshme?

Dielli

Sheno këtë. Ne i kemi djegur tërë fshatrat e tyre.
Sheno këtë. Ne i kemi djegur tërë fshatrat e tyre me
njerëzit brenda.
Sheno këtë. Ne i rrembyem ritet e tyre, manitë e
veshjes.

Shëno kete. Një fjalë mund të ngjajë tepkë si shtrat,
kanistër lotësh apo një X.

Në Libër thuhet. Është kohë molasjesh, gajasjesh,
shakarash, sekrete
matanë kufijsh të së folmes.

Ju ktheva mbaresave dhe pikësimit. E mbyll z. Rreth
me një të rënë, dhe kanavacën
e shqit prej murit, bërë njësh të dyve një luzmë men-
dimesh na msyn saora, gjithçka
e shkruajmë në gjeth ligustre.

Shënoje këtë. Tash kemi nisur të kemi kurme, një
këtu, një i humbur, një kohë më parë,
një ende pa mbirë.

Lermëni. Kam vdekur, jam në një roman, dikur
pata qenë poet lirik që ndillte turmat
në maja malesh. Mjaftojne 5 qindarka të dal nga
kutia, për një dollar shkembejmë mesazhe,
dhe ju pergjigjem tre pyetjeve.

Pyetja e parë. Ne hymë në pyll, ndoqëm dredhoret
dhe dolem te verber.

Pyetja e dytë. Jam si i shtëpisë në *Jugendstil*, që zuri
fill në *Darmstadt*.

Pyetja e tretë. Ai e di, per pak do t'ja prishin ëndrën
që sheh në gjuhë amtare.

Pyetja e tretë. Ai e di frymarja e tij është punë e Zotit
dhe për këtë i vjen të klithë.

Pyetja e tretë. S'flas me kërkënd ditëve të javës që
solin me *Ë*

Shenoje kete. Ka ëndje e dhimbje, ka gjurmë e shenja
Një fjalë mund ti ngjajë fikut e thiut, ikonës a vezës

por

koha është agjërime e ngashnjim, vegël, model, ka
kohe te shmangemi pa lëvizur gjymtyrë, tejzë a fytyrë
në një qetësi thuaja
shkencore, vrimë milimetrike nga derdhet drita.

Thuaj këtë. Linda në ishull rrethuar së vdekurish.
Gjuhën mësova në ishull e
kurrë me kërkënd nuk fola në ishull. Ty po të shkruaj
qe nga ky ishull. Valltarëve
ju shkruaj nga ishulli. Shkrimtarët s'kërcejnë valle në
ishull.

Thuaj këtë. Kam një fjali në gojë, një karrocë në gojë.
Një shkallare. Një llambadhe,
drit' e saj mbush zbrazetine, një zbrazëti që dritën ha.

Fjala tërbohohet fare. Vjersha titullohet Ç'kërkon
e Folura
të Thotë”
edhe pse vetes s'ja mbaj mend emrin

Një tjetër titullohet Teori e Reales, emrin e ka Le ta
Quajmë
Kështu,
i flasin Shkop i Drunjtë. Bën një po-po, një jo-jo. Bën
një e një.


Po bëj një libër në gjuhë të huaj, për violinat dhe
tymin, vijat dhe pikat.

MICHAEL PALMER

Premtimet e Qelqit

Përktheu nga anglishtja Gëzim Basha

Michael Palmer ka lindur ne New York ne 1942. Studioi Letersi Krahasese në Harvard dhe jeton në Kaliforni. Edhe pse emri i tij shpesh asociohet me drejtimin e njohur Language Poetry, Palmer heziton t'ju bashkohet matrikseve teorike fikse ngaqë kerkon perhere menyra jo orthodoxe të shprehjes poetike.



I lirë të flas shndrohem në ç'them. Fletët bëjnë këmbë,
shikojnë përqark,
ngultas lundrojnë drejt perëndimit të diellit.

Fletë të këputura kapakësh frymën e mbajnë tek tur-
e druve
cytur nga shtysa ti ngjajnë mendimit.

Fletë që s'pranojnë mellan.

Fletë që kurë si kemi parë— fillimisht me titujt Rru-
gicë e Ngushtë a Gjysëm
Fragmenti, Fushe e Amforave apo Fushe e Kulmakut,
e mer çdo rrokje në
gojë, ju ndron vendin pastaj ja kthen atij.

Lermë te shtoj edhe këtë. Neak Luong është njollë e
mjegullt. E Marte, kam ardhur

ne një korije me drure të rëndë. Jam ai vizitori që
mban fletore

Fletorja liston Fjalët e Mia të Reja dhe nje Flamur
Sipër së Bardhes.
Kerkon te thote se s'ka gjë brenda, vetëm ca gërma si
A- kundër Asaj, B, C, L dhe
N, Sam, Hans Magnus, dhe T, Sferë, të gjithë flasin në
terr, me krahët
e tyre
G per *Gramshin* apo *Gëbelsin*, kodra të kaltra, qytete,
qytete me kodra moderne a qysh nga buz' e kohës.
F për alfabet, Z për A, një H në liman, hije, rënoje e
heshtur, W a M midis yjeve.
Ç'mbetet. Shpend larash. Teserakt. X ndoshta per X.
Dhe fshatrat njihen si Këto Gërma—zagushi, vranë-
sire. Shkrimi merr jetë në muret e tyre.

Në një X			75. Një brerje, një krim, një trup që askush s'mund ta gjejë.		
për (dhe sipas) Claude Royed-Journoud			***		
1. Unë po e përshkruaj këtë si ta kisha përpara syve nuk e kam përpara syve.			76. Kur		
2. Unë them kjo është pikturë nuk është pikturë.			77. Në		
3. Unë them kjo është pikturë e diçkaje nuk është pikturë e as dicka nuk është pikturë e diçkaje.			78. Belo		
4. Unë them më kujtohet si te ishte dje mua nuk më kujtohet unë nuk e kujtoj të djeshmen.			79. Një		
5. Teksa në <i>Belo Horizonte</i> retë			80. Shi		
6. Unë them unë u linda mbi shpinën e një elefanti sajuar nga kurme vajzash beqare.			81. Ushton		
7. Aty, fletët e xhamit.			82. Një		
8. Unë them është një vajzë me një zinxhir floriri rreth belit të zhveshur.			83. Këngë		
9. Unë them kam parë një trëndafil një trëndafil të kuq në terr kjo nuk ka ndodhur.			84. Aksiale:		
10. Unë them më kapi dhimbja.			85. Hamnet		
11. Unë them kjo çështja e qendrës më intereson shumë kur qendra është qendër e një X.			86. Ti		
12. Ne themi hapësirë kjo hapsirë ku gjithçka kemi bërë është ngritja e problemit të hapsirës.			87. Mos		
13. Hapsirë a një hapsirë e mundshme ku rrugët re-flektohen ne një pasqyrë dhe një disk metalik i lëmuar hedh dritën e qiellit mbi një skenë tek një cep i sheshit të zbrazët.			88. Qaj		
14. Qielli si kuarç i verdhë ulet ngadalë.			89. Hamnet		
15. Unë po e përshkruaj si ta kisha përpara.			90. Ti		
16. Nuk është as pikturë as qiell.			91. Mos		
17. Teksa në <i>Nansensgade Claude</i> dielli vazhdon të bymehet.			92. Qaj		
18. Megjithatë na duhet të pyesim: ky diell, ai diell apo një bandë diejsh fajtorë.			93. Hamnet		
19. Unë them kjo çështja e përhapjes më intrigon veçanrisht.			94. Ti		
20. Unë them unë shoh në det qiellin ku shkruaj përditë.			95. Mos		
21. Përmbi fjalë një tryezë përmbi tryezë fletorja ndanë abazhurit.			96. U çudit		
22. Kjo shtëpi—ja përmenda gjë emrin kësaj shtëpie?			97. Hamnet		
23. A nuk jua thashë, puna ime ishte të merresha me mbjellje sysh.			98. Ti		
24. Kështu unë jam një pelikan që po vdes dhe ja mar këngës.			99. Mos		
25. E kështu pra ka kohë jam i ikur.			100. U zgjo		
***			Autobiografi		
26. Koha që i duhet blusë të përshkojë të bardhën.			Të gjitha orët janë re.		
27. E përshkruaj këtë si të ishte brenda nuk është brenda.			Pjesët ja kalojnë së tërës.		
28. Në spektrin e ngjyrave, s'ke ku hedh as mollën.			Një filozof vuan urie në dhomën me qera, teksa jashtë bie shi.		
29. Unë them jo piktura por ideja e pikturës nuk është as pikturë e as ide.			E mer vetveten thjesht si tjetër shenjë.		
30. Ne themi heshtja apo heshtja e këngës.			Trëndafilat e dimrit janë të padukshëm.		
31. Ne themi nga zëri kurmi prej gjurmës fleta e letrës.			Akull' i vonë nganjëherë këndon.		
32. Përshëndetja me dorë në erë nuk ka fare krah.			A dhe jo-A janë njëlloj.		
33. Po e përshkruaj këtë si ishte përpara meje është përpara meje.			Qeni im s'më njeh për të zot.		
34. Po e përshkruaj këtë si ishte përpara meje është përpara meje në errësirë.			Violinat, si ëndrat, ngjallin dyshime.		
35. Me errësirë kam parasysh: ai i çmonton krahët e tij / i vë në punë sipas kodit.			Unë vij prej Kolofonit, a ndoshta nga një ishull i vogël.		
36. Me errësirë kam parasysh: rrethon zhurmën / e një tjetër gjuhe.			Ngushtica ka ngrirë, njerzit po ecin—disa rrëshka-sin—mbi të.		
37. Me errësirë kam parasysh: mbërthim dhe zbërthim me mendje.			Në plazhin si kruasan, një dre i mbytur.		
38. Me errësirë kam parasysh: përpara luftës domethënë në errësirë.			Një grua me një dorë, kofsha e saj rreth qafës tënde.		
39. Bota që na jepet vetëm njëherë humbet natën.			Bota është gjithë ç'është përzënë.		
40. Krim i shkaktuar në një fill letër ose i fshehur përmes një letre.			Mollët mbi tezgë tek kthesa afër <i>Blahnof</i> -it, nga e verdha e zbehtë në të kuqe të errët.		
41. Bota që na falet vetëm një herë kapërdihet nga fleta e librit.			Kujtesa nuk flet.		
42. Trupi im si diagramë trupi trup i një tjetri.			Marrja e frymës, shoqëruar nga zhurma në vesh.		
43. Trup i tekstit bie fjala.			Poetit dhe filozofit ju mbahet goja.		
44. Kapërdirës i alfabeteve bie fjala.			Vetja ju jepet në përdorim të tjerëve.		
45. Vallëzim në terr bie fjala.			Një dhomë nga e cila përherë duket Hëna.		
46. Shtëpi prej letre meqë ra fjala nga një gramatikë e humbur.			Kafene në Leningrad: një burri i mungon ana e majtë e fytyrës.		
47. Shtëpi me katër mure pa tavan dhe dysHEME.			Zhdukja e diellit nga qielli sipër Odesës.		
48. Kllet ujë.			Pershkrim i vërtetë i atij dielli.		
49. Librat të mbyllur.			Një filozof shtrirë tek hyrja, po diskuton teorinë e ngjyrave		
50. Kore pa fund e anë.			me vetveten.		
***			teoria e vetes me vetveten, koncepti i numërit, kthimi etern, pulsi i yjve të largët		
51. Unë mund të them ka rënë dielli jashtë bën ftohtë mendimet e mia janë konfuze.			logjika e tipave, fjalitë e Buridianit, <i>lekton</i> .		
52. Macja e re në ngjyrë platini herë pas here mjaullin fort.			Përse tani ai tym prej liqenit?		
53. Dje unë fola me Domenikun rreth një projekti një projekti secret që do të mbetet i tillë.			Fjalët dhe sendet janë njëlloj.		
54. Një mollë, në të verdhë të zbehtë, ka mbetur ende në degë, kokrrat e kulumbrive në portokalli të zjarrtë, drita e ashpër e vjeshtës së vonë vjen ultaz dhe pothuajse e heq qafe fletën e letrës.			Shumë herë të bardhat korba a i kam parë.		
55. Papagajtë e egër (Krahë-Kanarine) kruhen ne pishën e Montereit.			Gjithë planet janë të pafundme, si rrjedhim.		
56. Dy vargje nga Khlebnikovi: Rusi: Unë të jap ty trurin tim divin e të bardhë. Bëhu unë. Bëhu Khlebnikov.			Ajo po pyet, A ka një hartë për ato porta?		
57. Një fragment nga Merleau-Ponty (shih më sipër 12, 13)			Ajo po pyet, të jetë kjo dalja, apo ajo tjetra nga nga perëndimi?		
58. Nga L. W., <i>Gjykime mbi Ngjyrën</i> , “Ne mund ta pikturojmë thujase-errësirën në thujase-errësirë.”			Kështu, pas lirit, engjëjt e territ po bisedojnë me engjëjt e dritës.		
59. Amerikë unë ta jap ty pjeprin e trurit tim. Mos u bëj unë. Bëhu Khlebnikovi.			Ata nuk janë engjëj.		
60. L. W., <i>Gjykime mbi Ngjyrën</i> , “Një sipërfaqe e lëmuar e bardhë mund t'i reflektojë gjërat: Por ç'ndodh nëse ne e kemi gabim dhe ajo çka duket si e pasqyruar në një sipërfaqe të këtitillë te jetë faktikisht matanë dhe ne thjesht e shohim përmes saj?”			Diçka tjetër.		
61. “ Ne flasim për një ‘pasqyrë të zezë...”					
62. Doni më shumë X -in apo qendrën apo idenë e një qendre një qendër e padukshme?					
63. Egzaktësisht mesditë, stilografi që rrjedh mellanin blu llangos dorën dhe fletën e letrës.					
64. I rraskapitur nga ëndrrat e dhunshme të një nate më parë: Një zë po më thotë, S'ja ke parë kurrë të brendshmet buallicës së ujit kur shpërthen në erë mbi pellgut e orizores? S'paske parë ndonjë tigër tek nduk me dhëmbë kufomën e djegur të një fëmije?					
65. Tek kafja aty pranë për kafen e pasdites, njoha një fytyrë të parë nga lagjia ime tek zbriste rrugës, herë mëmëriste fjalë të pakuptueshme dhe herë sokëllinte, në çdo pak metra kthehej pas dhe bënte kryqin.					
66. Ecje sikur nuk lëviz fare, zhvendosje përpara dhe prapë në një vend, banor i vetëm i rrethit.					
67. Çajnik, dhuratë nga një filozof Italian pak vite më parë, porcelan i bardhë nga më i thjeshti.					
68. S'ka kujtesë pa një fantazmë.					
69. Punë krejt në të tashmen, prani objektesh, penge-sash, kjo ditë.					
70. Kështu nata nis të zbresë, përgjatë boshtit të shkakut.					
71. Përgjat boshtit të paradoksit.					
72. Përgjatë boshtit të së sigurtës.					
73. Përgjatë boshtit të dyshimit.					
74. Përgjatë boshtit të simetrisë.					

Herë pas here një shkrimtar ma ndryshon gjithë hartën e letërsisë që unë mbaj në kokë. Më i fundit ka qenë islandezi Sjón, vepra e të cilit është tërësisht e ndryshme nga çdo letërsi tjetër që kisha lexuar dhe ndërkohë, mjaft emocionuese. Sjón u lind në vitin 1962 dhe përmbledhjen e tij të parë me poezi e botoi kur ishte vetëm pesëmbëdhjetë vjeç. Ai është një ndër themeluesit e grupit neo-surrealist *Medúsa*. Ka botuar tetë romane dhe libra me poezi, drama dhe librete. Ndërkohë shkruan tekste për këngëtares e famshme islandeze Björk dhe është nominuar për Çmimin Oscar për tekstet e tij në filmin e gjenit Lars von Trier *Dancer in the Dark*.

Unë islandezët i përfytyroj si eruditë, të veçantë, të rreptë dhe të panënshtuar. Sjón është të gjitha këto bashkë, por ai gjithashtu është kaq i gjallë, i ngazëllyer dhe surreal. Emri i tij i artit *Sjón*, është shkurtim i emrit të plotë Sigurjón Birgir Sigurðsson - Sjón, që do të thotë *vështrim*.

Tri nga romanet e tij janë përkthyer në anglisht: *Dhelpra blu*, *Nga goja e balenës dhe Muza pëshpëritëse*. Ato janë vendosur në periudha shumë të ndryshme historike. *Dhelpra blu* (botohet së shpejti nga Aleph – sh.p) është vendosur në vitet 1880. Ai ka dy personazhe kryesore - Fridrik Fridjónsson, natyralist dhe Baldur Skuggason një prift i rreptë dhe gjahtar dhelprash. Ashtu si të gjitha veprat e Sjón-it, ky roman i shkurtër përmban dy botë njëherazi, të cilat në fund të fundit janë e njëjta botë - toka e fortë (e ashpër dhe islandeze, zjarr i furishëm nën malet e ngrira dhe të stuhishme) dhe bota që ndryshon formën e magjisë dhe rrëfimit (gjithashtu islandez). Është Fridjónsson ai që deklaron në Kopenhagen, “Unë e kam parë universin! Është i përbërë nga poezia!”

Narrativa mesa duket mbahet në dy linja të veçanta, të cilat në fund bashkohen në mënyrë të përkryer. Baldur Skuggason niset për të gjuajtur dhelprën blu në mes të një stuhie. Ai është kaq kokëkrisur dhe kaq i neveritshëm, por në njëfarë mase ne thjesht e pranojmë ekzistencën e tij të sikletshme - kënaqësinë me të cilën ai gllabëron kokën e një merluci, shtresat e rrobave që vesh, qetësinë e tij kur e gjen veten të burgosur në dëborë. Ai e vret dhelprën dhe e merr me vete të futur në pallto. Dhelpra befas përmendet dhe të dy bien dakord të diskutojnë për energjinë elektrike në një shpellë - Skuggason beson se është e gabuar t'i kufizosh në tela impulset elektrike të krijuara nga Zoti.

Ai e vret përsëri dhelprën, ndërsa ajo është e hutuar. Emri i tij pasqyron emrin e saj - një dhelprë blu në islandisht quhet *Skugga-Baldur*.

Fridjónsson natyralisti është zemërbutë dhe i qytetëruar. Ai ka shpëtuar një vajzë “mongoloide” që e quan veten Abba. Në këtë kohë, këta fëmijë u mbytën gjatë lindjes - kushdo që mbijetonte shitej si skllav dhe dhunohej. Abba, nën kujdesin e Fridriksonit, bëhet natyraliste në llojin e vet, teksa mbledh florën dhe puplajën islandeze e teksa shpik hap pas hapi një gjuhë të vetën.

Nga goja e balenës është vendosur në vitin 1635. Edhe ky libër ka të bëjë




me shkencën, fenë, magjinë dhe mënyrën se si ato transformojnë njëri-tjetrin. Heroi i saj, Jónas Pálmason i dituri, ishte një njeri i vërtetë, veprat dhe fatin e ashpër të të cilit Sjón i ka studiuar thellë. Ai jetoi në një kohë kur magjia, feja dhe shkenca ishin të gjitha pjesë e njëra-tjetres; shkroi një poemë autobiografike të quajtur “Zgalemi”, dorëshkrime mbi historinë natyrore, një koment mbi *Edda-n*, legjenda, balada heretike, gjenealogji dhe arriti të shohë dhe të skicojë balenat. Kisha jepet edhe njëherë tjetër mjaft e ashpër në këtë rrëfim—nga që është dënuar për blasfemi Jonas internohet në një ishull në brigjet e Islandës, ku jetesa është *mezi* e mundur, së bashku me gruan e tij, një grua tejet e zgjuar, e dhënë e gjitha pas hetimit të shkaqeve që shkaktojnë eklipset e diellit dhe hënës.

Romani është i mbushur me vëzhgime plot vërtetësi për krijesat mitike, peshqit dhe balenat e vëzhguara saktësisht, algat e kuqe dhe gurët.

Ai vëren se “kur një gjallesë është e klasifikuar saktë, ajo vetiu zbutet”. Megjithatë, kjo vërejtje bëhet përgjatë një episodi kur ai dhe një poet tjetër po mundohen të lodhin *një kufomë* që shtyhet me këmbët e veta, duke i treguar asaj rrugën ndërsa i recitojnë vargje ekzorciste. Sjón është mjaft i zoti në përshkrimin që iu bën kufomave. Ai është po aq i mirë kur përshkruan ndjesitë që jep era e keqe, prishja e mishit ndërsa ndryshon ngjyrën.

Jonasin e shpëton përkohësisht një i huaj me varkën e vet, i cili e çon në Danimarkë për të takuar natyralistin Ole Wurm. Ndërsa atje ai gjen rast ta shfryjë mitin sipas të cilit, *tufat e narvalit* janë brirët e njëbrirëshve – duke e dëmtuar kështu tregtinë islandeze të këtyre objekteve. Përpara se të niset, atij i vjen një vizion edenik i të gjithë zogjve të ajrit, peshqve të detit, kafshëve dhe bimëve - vizion ky i tërësisë, rendit dhe plotësisë, i cili përsëritet në veprën



e Sjón-it krahas vizionit të anasjelltë, atij të shkatërrimit dhe shpërbërjes. Shkruan Jonas:

*Zogj në ajër,
gjitarë në mal,
peshq në det,
mbjellë në breg.
Guri në tokë,
njeri në mes,
përbindësja e tingujve,
të zbutur - jo më?*

Poezitë e Sjón-it janë herë lirike, herë absurde, herë komike. Libri i tij *sóngur steinasafnarans* (“kënga e koleksionistit të gurëve”) u nominua për Çmimin Kombëtar Letrar Islandez në 2007. Disa nga poezitë e tij përbëhen nga lista këngësh. “Danse grotesque”, për shembull, i kushtohet Cindy Sherman dhe rendit nëntë vende ku nëntë gra “vdiqën pak çaste më parë” - në një pastrim pylli, në një shtëpi periferike, në një kanal, në një plazh, nën një urë, në një fushë të papunuar, në dyshtemenë e dhomës së gjumit, në fund të një pellgu të butë me alga, në bodrumin më të ulët të një garazhi parkimi. Poema rendit rrobat e tyre - kadife, najlon, mëndafsh, lesh, thasë, pambuk, plastikë, “asgjë/ përveç qimeve të trupit” - dhe vazhdon me renditjen

*Dy milionë e tetëqind mijë këmbë nerva
gjashhtëqind mililitra biliare
treqind e shtatëmbëdhjetë kilogramë yndyrë
njëqind e njëzet gishta
(nëse njëra përfshin gishtin e unazës që është shqyer nga e majta dora e gruas që u vra nën urë)....*

Ai gjithashtu përshkruan dekompozimin dhe kërcimin që vjen më pas.

Ka poezi të ndryshme për gurët - kënga e një koleksionisti gurësh, një litografi e bërë nga Edvard Munch pas një vizite imagjinare tek Marie Kyri - “fotografia ka humbur - të ëndërruarit parashikon vdekjen e ëndërrimtarit”. Ekziston një “përpjekje mjaft prekëse për të ringjallur duā Khalil Eswad” i cili u vra me gurë - “guri i madh” “zbarkon në trupin e një vaje shtatëmbëdhjetëvjeçare të dashuruar”. Ekziston një poezi e çmendur që rendit trembëdhjetë njerëz dhe krijesa që janë “goditur me nga një gur në kokë”:

*Unë po këmbëj letra me anëtarë të shoqatës
së mineraleogjisë në Londër - kur lexojnë raportet e mia për gurët islandezë ata mëdyshe se vështirë të mbijetonin sikur dhe një ditë në reykjavik : iu përgjigja se jam kaq i përgjegjshëm me njerëzit e edukuar si ata të cilët duhet të ndihen mjaft të sigurt edhe këtu*

Ne jemi të mashtruar në kohën tonë nga një ngatërresë rreth fjalëve “modern” dhe “modernizëm”. Modernizmi tanimë nuk është aspak modern—na është thënë një histori rreth kësaj që thotë se, po ta kemi kuptuar Lawrence

Sterne-in dhe James Joyce-in, atëherë të gjitha mënyrat e shkrimit të letërsisë bëhen të pamundura. Ne kemi njohur postmodernizmin dhe lojërat e tij, të cilat tanimë nuk janë moderne. Ne kemi nevojë për një fjalë për modernen, e cila nuk është e njëjtë me “bashkëkohore”, por diçka që ka të bëjë me natyrën e formave letrare. Mendoj se përdorimi i shumë historive të ndërthurura nga Sjón, të vjetra dhe të reja, është një fenomen i ri modern. Në një intervistë dhënë për revistën *The Coffin Factory*, ai deklaroi se “jam pothuajse imun ndaj romanit realist. E kam të vështirë të lexoj një roman realist dhe sigurisht, jam gjithmonë shumë i lumtur kur zbuloj diku në romanin realist se romancieri i është dorëzuar një lloj elementi folklorik.”

Ai citon Borges-in, i cili thotë se “e ndjeu [se] *fiksioni* realist ishte një tradhti ndaj letërsisë në thelb të saj, sepse abuzohet ngado me tregimin dhe vetë letërsinë në përgjithësi, duke mos përdorur elementet e sublimes, fantastikes, mitikes apo folklorikes. Sepse kjo është ajo që ne po mbajmë gjallë.” Ai beson se njerëzit janë në thelb tregimtarë dhe se historitë i bëjnë njerëzit njerëzorë, më tepër sesa shkrimtarët që bëjnë tregimet.

Sjón na thotë se romani “Mjeshtri dhe Margarita” i Mihail Bulgakovit është “libri i tij i parapëlqyer i të gjitha kohërave”, sepse tregon njëkohësisht shumë histori dhe shumë lloje historish, edhe sepse merret me ide të përhershme, si natyra e së keqes dhe natyra e historisë.

Bulgakov dhe Borges janë të dy shpikës elegantë të tregimeve që e bëjnë të vjetrën të re. Unë e lidh Sjónin me një grup shkrimtarësh - kryesisht europiano-jugorë - të cilët gjithashtu tregojnë dhe ritregojnë rrëfime të vjetra. Roberto Calasso, Italo Calvino dhe Claudio Magris riformësojnë historinë dhe historinë e mendimit me përralla të ndërthurura. Mendoj se vetëm Sjón mund të kishte filluar të ritregonte epikat e vargjeve të William Morris-it, viktoriane dhe plot lulëzim, gjë që do ta kishte kënaqur Morrisin me pasionet e tij për Islandën dhe për të ritreguar përralla të vjetra. Është interesante që vështrimi prapa në kohë i Sjón-it shkon kryesisht drejt klasikëve grekë dhe romakë, më tepër ndaj tragjedyve greke dhe metamorfozave të Ovidit, edhe ndaj tregimeve dhe formave të krishtera, sesa drejt miteve të Eddas, Voluspas dhe atyre nordike.

Nga goja e balenës hapet me versionin e vet të Prologut në Parajsë të Goethes tek *Fausti*. Luciferi kthehet në shtëpi nga gjuetia dhe gjen Qiellin e Shtatë në një gjendje tmerri dhe rrëmuje. Engjëjt janë të tronditur:

Më të ndjeshmit u rrëzuan pas shtyllave dhe stolave, duke vjellë në mënyrë spazmatike, ekto plazma që buronte nga goja e tyre derdhej pa kontroll mbi dyshemetë e kaltra të Parajsës. Në themel të këtij spektakli të tmerrshëm qe tingulli i pëshpëritjes që formohej kur dëshpërimi i tejdukshëm depërtonte nëpër puplajat e fluturimit, duke bërë që shtëllungat e buta të dridheshin dhe ajri të luante mbi to me një fishkëllimë drithëruese, si një fije bari që e fryn fëmija....



Fatkeqësia që ka ndodhur është krijimi i Njeriut dhe bashkë me të “erë e keqe e gjakut dhe urinës, djersës dhe spermës, mukusit dhe yndyrës”. Luciferi refuzon të përkulet para krijesës së dobët në dorën e Krijuesit, i cili po përpigjet të thotë fjalën e tij të parë, “Unë”. E kam cituar këtë sepse është një shembull i mënyrës se si Sjón përdor një motiv të vjetër dhe e imagjnon atë përsëri. Në fund të romanit, ai përshkruan Jonasin Të Urtin duke u futur brenda “një balenë veriore; një leviat’hani të keq që rritet në thellësira deri në tetëdhjetë ose nëntëdhjetë ele, njëlloj të gjatë edhe të gjerë, dhe ushqimi i tij sipas të gjitha gjasave është terri dhe shiu, megjithëse disa thonë se ushqehet edhe nga dritat veriore.” Përsëri imazhi është shumë i vjetër dhe specifika e Sjón-it e bën atë njëherësh krejtësisht të ri, nxehtësinë, dinamikën, teksturën e brendësisë së krijesës.

Ndoshta është kjo specifikë e palëkundur, kjo saktësi e shpikjes, që e bën mjeshtërinë e Sjón-it kaq të pazakontë. Ai përshkruan një masakër të balenave *baskë* nga një turmë islandezësh. Përshkrimi i masakrës është i tmerrshëm - dhe Sjón ka thënë se ka lënë jashtë edhe disa detaje nga përshkrimi origjinal historik - por më befasues dhe i tmerrshëm, është meditimi i Jonas mbi mënyrën se si mjete të jetës sonë të përditshme shndërrohen papritur në armë:

Cili peshkatar do ta kish bluar në mendjen e vet idenë se do ishte diçka e shkëlqyer të ngulje grepa të mëdhenj e të vegjël në mishin e një njeriu? Cili farkëtar i ngriti i pari pincat e skuqura nga zjarri dhe u nxit nga shtysa e fortë për t’ia shtypur te gjoksi motrës? Si quhej zbutësi i kuajve që pati idenë e shkëlqyer të fshikullonte kamzhikun mbi kurrizin e djalit endacak, ose t’ua jepte hua kafshët e tij të pazbutura autoriteteve, për të shqyer gjymtyrët e

njerëzve të gjallë? Cili historian i natyrës sheh te uji dhe zjarri mjetet me të cilat mund të mbysë apo djegë dikë, apo te era dhe bimët mjetet për t’ia marrë jetën me etje apo helm? Kush qe ai që mendoi i pari t’i përdorte gjithë këto objekte të dobishme torture gjer në vdekje, mbi njerëzit e tjerë si ai? Dhe përse këto kthehen kaq lehtë në instrumente vdekjeprurëse në duart e njeriut?

Një herë e dëgjova Sjón-in që po fliste për disa mendime të vetat mbi fatin e Caenis/Caeneus tek romani tjetër i tij *The Whispering Muse*. Ai ndodhej në Athinë teksa po vizitonte tempullin e braktisur të Poseidonit, ku askush nuk e adhuronte më. Më pas, tregon ai, eci në majë të shkëmbit me pamje nga deti dhe befaz përfytyroi detin teksa po derdhej drejt tokës dhe pa se si do të dukej e gjitha po të pushtohej nga ajo forcë dhe fuqi e gjithpushtetshme, nga shkuma, nga uji i errët, nga pafundësia. Sjón vuri në dukje se njerëzit nuk e imagjinonin me të vërtetë se çfarë nënkuptonte përdhunimi nga Poseidoni, dhe më pas, me paturpësinë e tij të zakonshme, bëri një përshkrim që të sigurohej mirë që ne e kuptuam.

E megjithatë, në mënyrë paradoksale, ai krijon një botë në të cilën asgjë nuk qëndron e njëjtë, gjithçka është në fluks, gjërat ndryshojnë formën dhe ndryshojnë marrëdhëniet e tyre me njëra-tjetrën.

Në fund të librit *Nga goja e balenës*, Jonas mediton gjatë mbi imazhet groteske në dorëshkrimet e vjetra dhe se si këto kombinohen në forma të reja - “një centaur këtu, një plakë me këmbë zogu atje, një qen me tre koka”. Kjo e çon atë në natyrën e vetë perceptimit:

Nëse dikush shikon një lumë llave, re avulli ose përrenj të mëdhenj, ose një fushë që valëvitet nga era, syri dhe mendja nuk do të pushojnë derisa të kenë gjurmuar imazhe të njohura nëpër atë rrjedhë....

Groteskët janë njësoj si ato imazhe

kalimtare që unë vetë i kam perceptuar shpesh tek tymrat, likenet ose retë....

Oh, ato pamje!... Oh, ata mijëra përbindësia dhe absurditete të ndërthurura që më dhanë gjallëri ndërsa pengohesha rrugës nëpër ato vëllime të trasha në muzeun Wormianum... Njeriu s’e kuptonte kurrë se ku niste një krijesë dhe ku mbaronte tjetra... Këmbët e pasme të një dhie, po ta shihje më me kujdes, shndërroheshin në fillimin e një kërcelli luleje... Ama nga kërcelli nuk çelnin petale, por pupla lejleku, në majë të të cilave ulej një tufë me krahë fluturash... Madje, nuk ishte e sigurt as se trupi i dhisë qe i përbërë prej mishi, mineralesh apo vegjetalesh... Dhe nëse njeriu ishte aq i sigurt se gjysma poshtë e trupit të tij qe prej mermeri, ishte po aq i sigurt se gjaku rridhte nëpër venat e tij të ngurta dhe a ishte gjaku i kuq dhe i ngrohtë, apo i gjelbër dhe i ftohtë? Gjithçka rritet nga diçka tjetër, sikur natyra të kishte gjithmonë pishmane dhe brerje ndërgjegjeje. . .

Kjo është mënyra e vetë Sjón-it për të vazhduar, gjërat konkrete gjithmonë ndryshojnë formën, metaforat bëhen krijesa dhe objekte. Në romanin *Nga goja e balenës*, Jonas kundërshton mjeshttrin e madh Snorri Sturlusson, i cili përshkruan qëndrueshmërinë rigorozë në imazhet që përdor:

Një metaforë mendohet të jetë e konceptuar mirë nëse nocioni që është adoptuar ruhet përgjatë gjithë vargut. Por nëse një shpatë quhet gjarpër, e më vonë peshk apo shkop, . . . njerëzit e quajnë atë monstruoze dhe e quajnë atë si prishje të vargut.

Receta e Snorrit çon në një lloj madhështie solide. Por Jonas dhe Sjón dëshirojnë krejt të kundërtën:

Gjepura, them unë, le të kthehet shpata në një nepërkë dhe nepërka në salmon, dhe salmoni në thupër mështekne, dhe thupra e mështeknës në shpatë, dhe shpata në një gjuhë... Le të vrapojnë bashkë kaq shpejt sa të mos ndalen më... Shenjat e muzgut që avitet e kanë përmbysur botën nga themelet e saj... Gjithçka po del nga binarët... Qiejt përdoren për të ecur mbi ta...

Islanda është tokë e kontrasteve të ashpra, zjarrit dhe akullit. Është një vend ku njerëzit e vërtetë besojnë në mënyrë të vërtetë se bota jonë e dukshme është e ndërthurur me magji - një tokë në të cilin dihen mirë vendet ku jetojnë dhe punojnë kukudhët. Kam parë gurë të shënuar ku dihet se janë dyert për në botën tjetër. Shumëllojshmëria e madhe e figurave të Sjón-it, në të njëjtën kohë shumë të forta dhe që ndryshojnë formën dhe më pas zhduken, janë islandeze dhe përtej asaj që cilësohet si *europiane*. Ai tanimë ma ka ndryshuar mënyrën se si unë i shoh gjërat.


Përktheu: G. Ç

*) A.S. Byatt është sot një prej shkrimtarëve dhe kritikëve më të rëndësishëm në Britaninë e Madhe. Këtë ese ajo e botoi së pari tek *The New York Review of Books*; këtu botohet me disa shkurtime.

VELI KARAHODA

— ROMAN —

FUNDI I PALAVDISHËM *i* IGOR BAGRICKIT



*“Një roman klasi, me stil, ndërtim, rrëfim.
Zbërthim detajues plotëni karakteresh.
Shkurt e shqip: letërsi botërore.”*

BUZUKU